



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA ADMINISTRATIVE E APELIT

Nr. 199 Regj.Themeltar

Nr. 69 vendimi

Dt. 10.08.2020



VENDIM

NË EMËR TË REPUBLIKËS

Gjykata Administrative e Apelit me trup gjykues të përbërë nga:

Kryesuese: Alkelina Gazidedja
Anëtare : Enkelejda Metaliaj (Softa)
Anëtar : Bari Shyti

Asistuar nga sekretarja gjyqësore **Sonja Traja**, sot më dt. **10.08.2020** mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen administrative me palë:

PADITËSE: **Vjosa Bodo (Mujo)**, e bija e Malos dhe Nevries, e datëlindjes 09.01.1979, lindur në Librazhd, e banuese në Tiranë, Rruga “Margarita Tutulani”, Pallati 20, shk. 2, ap. 34.

IPADITUR: **Këshilli i Emërimeve në Drejtësi**, me adresë Rr. “Ibrahim Rrugova” ndërtesa nr. 20, 1001 Tiranë, përfaqësuar në gjykim nga Besmir Rrapaj, me autorizimin nr.179 Prot datë 30.07.2020.

PERSONA TË TRETË: **Avokati i Popullit**, me adresë Rr. “Vllazen Huta” Tiranë, në mungesë.

Presidenti i Republikës së Shqipërisë, me adresë Blv “Dëshmorët e Kombit”, Tiranë, përfaqësuar në gjykim nga Katrin Treska me autorizim datë 07.08.2020 me nr. 2742/1 prot.

Kuvendi i Shqipërisë, me adresë Blv “Dëshmorët e Kombit”, në mungesë.

OBJEKTI:

-Shfuqizimin e Vendimit nr.17, datë 17.07.2020 të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi (KED) "Për ndalimin e kandidimit të znj. Vjosa BODO, në vendin vakant për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese, shpallur nga Presidenti i Republikës me datën 07.02.2018 dhe rishpallur në datën 27.09.2019".

-Shfuqizimin e Vendimit nr.18, datë 17.07.2020 të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi (KED) "Për ndalimin e kandidimit të znj. Vjosa BODO, në vendin vakant për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese, shpallur nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë me datën 28.08.2019 dhe rishpallur në datën 21.08.2019".

-Detyrimin e Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, që të lejojë kandidimin e kandidatës Vjosa BODO (MUJO) për vendin vakant për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese, vakancë e parakohshme e shpallur nga: i- Presidenti i Republikës në datën 27.09.2019, si dhe ii- Kuvendi i Republikës së Shqipërisë në datën 28.08.2019.

-Detyrimin e Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, që të vijojë procesin e vlerësimit dhe pikëzimit të kandidaturës të znj. Vjosa BODO (MUJO), në vendin vakant për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese, sipas parashikimeve të nenit 239 e vijues të ligjit nr.115/2016.

BAZA LIGJORE:

Neni 149/d i Kushtetutës; Nenet 7/a dhe 7/b të Ligjit nr. 8577/2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë"; pika 5, gërma "c" e nenit 228, pika 3 e nenit 229, nenet 223, 224, 225, si dhe pika 3 e nenit 237 të ligjit nr. 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë"; pikat 26, 27, 28, 48, 50/b, 51, 53, 54, 93, 93, 94, 95 dhe 96 të vendimit nr. 4, datë 11.03.2019 "Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese..." të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, i ndryshuar, ligji 44/2015 K.Pr.A, ligji 49/2012.

Në përfundim të shqyrtimit gjyqësor të çështjes, Gjykata pasi mori në shqyrtim provat shkresore, dëgjoi dhe pretendimet përfundimtare të palëve, të cilat kërkuan:

Paditësja Vjosa Bodo (Mujo) kërkoi: Pranimin e padisë, shfuqizimin e vendimeve nr. 17, 18, datë 17.07.2020, të palës së paditur KED; që të lejojë kandidimin e kandidatës Vjosa BODO (MUJO) për vendin vakant për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese, vakancë e parakohshme e shpallur nga: i- Presidenti i Republikës në datën 27.09.2019, si dhe ii- Kuvendi i Republikës së Shqipërisë në datën 28.08.2019.



Pala e paditur Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, kërkoi: Rrëzimin e padisë.

Avokati i Popullit, kërkoi: Në mungesë.

Presidenti i Republikës së Shqipërisë, kërkoi: Pranimin e padisë.

Kuvendi i Shqipërisë, kërkoi: Në mungesë.

VËREN

Është pranuar dhe rezulton në gjykim se paditësja Vjosa Bodo (Mujo) ka shprehur interesin për vendin vakancë e parakohshme në Gjykatën Kushtetuese e shpallur nga Presidenti i Republikës në datë 07.02.2018 dhe rishpallur në datën 27.09.2019, për vendin vakancë e parakohshme në Gjykatën Kushtetuese e shpallur nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë në datë 28.08.2018 dhe rishpallur më datë 21.08.2019,

Për secilën kërkesë të paraqitur nga paditësja është hedhur shorti për caktimin e relatorit të çështjes sipas parashikimeve të nenit 228 të ligjit nr. 115/2016 dhe pikave 5, 27 - 37 dhe 41 të Vendimit nr. 2 datë 15.02.2019, dhe për paditësen janë përcaktuar relatorët, Saida Dollani dhe Artan Marku.

Në zbatim të pikës 22 të Vendimit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi me nr. 4 datë 11.03.2019 “Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë” paditësja është njoftuar nga i padituri me shkrim për tu paraqitur pranë Këshillit për të vijuar me përmbushjen e procedurave të verifikimit të kandidaturës.

Në datën 25.09.2019 kandidatja Vjosa Bodo (Mujo) është paraqitur pranë Këshillit të Emërimeve në Drejtësi ku është pajisur me formularët e deklaramit dhe autorizimet që duhet të plotësohen për qëllimet e vijimit të procedurës së verifikimit të kandidaturës së tij.

Në datën 30.09.2019, kandidatja Vjosa Bodo (Mujo) ka depozituar me postë dhe administruar në datë 02.10.2019 pranë Këshillit të Emërimeve në Drejtësi formularë të deklaramit dhe autorizimet përkatëse për qëllimet e vijimit të procedurës së verifikimit të kandidaturës së saj për të dy aplikimet e paraqitura prej saj.

Në datën 25.10.2019 kandidatja Vjosa Bodo (Mujo) është paraqitur pranë Këshillit të Emërimeve në Drejtësi ku është pajisur me formularët e deklaramit dhe autorizimet që duhet të plotësohen për qëllimet e vijimit të procedurës së verifikimit të kandidaturës së tij.

Në datën 30.10.2019, kandidatja Vjosa Bodo (Mujo) ka depozituar me postë dhe administruar në datë 02.11.2019 pranë Këshillit të Emërimeve në Drejtësi formularë të deklaramit dhe autorizimet përkatëse për qëllimet e vijimit të procedurës së verifikimit të kandidaturës së saj për të dy aplikimet e paraqitura prej saj.

Për verifikimin e kushteve dhe kriterëve ligjore të kandidimit, lidhur me verifikimin dhe kontrollin e pasurisë, në zbatim të shkronjës “dh” të nenit 7/a të ligjit nr. 8577/2000, të nenit 235 të ligjit nr.115/2016, si edhe në zbatim të pikës 60 të Vendimit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi nr. 4 datë 11.03.2019 “Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë” me shkresën nr. 548 prot, datë 04.10.2019, KED i ka dërguar ILDKPKI-se listën e kandidatëve dhe personave të lidhur me to që i nënshtrohen procedurës së verifikimit të kushteve dhe kriterëve të tjera ligjore të kandidimit sipas ligjit nr.8577/2000 dhe ligjit nr.115/2016.

Me shkresën nr.4186/1 prot, datë 04.10.2019, ILDKPKI ka informuar Këshillin e Emërimeve në Drejtësi se kandidati Vjosa Bodo (Mujo) e ka përmbushur detyrimin e përcaktuar nga pika 2 e nenit 235 të ligjit nr. 115/2016 për të dorëzuar të plotësuar pranë atij institucioni Deklaratën e Pasurisë dhe Interesave Private të Kandidatit për Pozicione të ndryshme në Institucionet e Sistemit të Drejtësisë.

ILDKPKI, në zbatim të nenit 235 të ligjit nr.115/2016, të ligjit nr. 9049/2003 dhe ligjit nr. 9367/2005, me shkresën, nr.116/25 prot, datë 05.11.2019 dhe nr. 116/26 prot datë 03.12.2019 ka dërguar pranë Këshillit të Emërimeve në Drejtësi rezultatet e kontrollit të ushtruar për kandidaten Vjosa Bodo (Mujo) dhe personat e lidhur me të.

I padituri, në funksion të ushtrimit të kompetencave të tij për verifikimin e plotësimit të kushteve dhe kriterëve ligjore të kandidimit, për sa i përket kontrollit të pasurisë, ka kryer veprimet verifikuese të kërimit nga subjekte publike dhe private, të të dhënave mbi pasuritë, interesat private dhe detyrimet financiare që ekzistojnë në emër dhe për llogari të kandidates Vjosa Bodo (Mujo) dhe personave të lidhur me të.

Lidhur me kushtin e kandidimit të parashikuar nga pika 4 e nenit 125 të Kushtetutës dhe shkronja “a” e pikës 2 të nenit 7/a të ligjit nr. 8577/2000, pra që kandidatët të kenë të paktën 15 vjet përvojë pune si gjyqtarë, prokurorë, avokatë, profesorë ose lektorë të së drejtës, nëpunës të nivelit të lartë në administratën publike, është shqyrtuar dokumentacioni i paraqitur nga vetë kandidatja, përfshirë jetëshkrimin, librezën e punës, si dhe shkresa e vërtetime të lëshuara nga organet kompetente të emërtesës etj., që janë të administruara në dosjen e kandidimit.





Këshilli i ka kërkuar kandidatit të paraqesë shpjegime me shkrim dhe dokumente shtesë në zbatim të nenit 237 të ligjit nr. 115/2016 si dhe në zbatim të nenit 7/a të ligjit nr. 8577/2000, i është kërkuar informacion për:

1- *Pozicionet e punës së deklaruar nga ana juaj, a mundet që të barazohen me atë në kuptim të nenit 7/a i Ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese" ?*

Kandidatja Vjosa Bodo (Mujo) ka paraqitur me shkrim shpjegime dhe dokumente shtesë pranë Këshillit me e-mailin e datës 12.11.2019.

Në përfundim të veprimeve dhe procedurave të kontrollit dhe verifikimit, në zbatim të neneve 235, 236 dhe 237 të ligjit nr.115/2016, si edhe të pikave 29, 75 dhe 87 të Vendimit nr. 4 datë 11.03.2019 *"Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë"* i ndryshuar, anëtarët e Këshillit relator të çështjeve kanë proceduar me përgatitjen e relacionit përkatës mbi gjendjen e faktit dhe të ligjit të zbatueshëm dhe e kanë dërguar çështjen për shqyrtim në mbledhjen e Këshillit.

Në zbatim të pikës 33 të Vendimit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi nr. 4 datë 11.03.2019 *"Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë"* i ndryshuar, Zv/Kryetari i KED-së ka thirrur mbledhjen e Këshillit duke njoftuar anëtarët për zhvillimin e saj në datën 17.07.2020, rendin e ditës, si edhe duke i bashkëlidhur njoftimit materialet e çështjes. Në rendin e ditës është përfshirë edhe çështja me objekt shqyrtimin e gjetjeve në procedurën e verifikimit të kandidimit të znj.Vjosa Bodo (Mujo), për vendin vakant në Gjykatën Kushtetuese të shpallur nga Kuvendi dhe Presidenti i Republikës.

Në zbatim të pikës 34 të Vendimit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi nr. 4 datë 11.03.2019 *"Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë"* i ndryshuar, dita dhe koha e zhvillimit të mbledhjes, së bashku me relacionin e përgatitur nga relatori, i është njoftuar kandidates Vjosa Bodo (Mujo) (datë 13.07.2020).

I njëjti njoftim, së bashku me dokumentacionin e përgatitur nga relatori mbi veprimet e kryera gjatë procedurës së verifikimit, si edhe materiale të çështjes, i janë dërguar edhe Avokatit të Popullit.

Për zhvillimin e mbledhjes së Këshillit në datën 17.07.2020, rendin e ditës dhe relacionin e përgatitur janë njoftuar edhe subjektet që sipas ligjit ftohen të marrin pjesë në mbledhjet e Këshillit.

Pas përfundimit të procedurës dhe shqyrtimit të kandidaturës së paditëses pala e paditur KED me vendimin nr.17, datë 17.07.2020, ka vendosur: “Ndalimin e kandidimit të zonjës Vjosa Bodo (Mujo), në vendin vakant për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese, shpallur nga Presidenti i Republikës në datën 07.02.2018 dhe rishpallur në datën 27.09.2019. Në zbatim të nenit 238 të ligjit nr. 115/2016, ky vendim i njoftohet kandidatës Vjosa Bodo (Mujo). Kandidatja Vjosa Bodo (Mujo) ka të drejtën e ankimit në Gjykatën Administrative të Apelit jo më vonë se 5 ditë nga dita e njoftimit të vendimit të arsyetuar. Ky vendim publikohet në faqen zyrtare të Gjykatës së Lartë, në pjesën e përcaktuar për Këshillin e Emërimeve në drejtësi” dhe vendimin nr. 18, datë 17.07.2020, me të cilin ka vendosur: “Ndalimin e kandidimit të zonjës Vjosa Bodo (Mujo), në vendin vakant për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese, shpallur nga Kuvendi i Republikës në datën 28.08.2018 dhe rishpallur në datën 21.08.2019. Në zbatim të nenit 238 të ligjit nr. 115/2016, ky vendim i njoftohet kandidatës Vjosa Bodo (Mujo). Kandidatja Vjosa Bodo (Mujo) ka të drejtën e ankimit në Gjykatën Administrative të Apelit jo më vonë se 5 ditë nga dita e njoftimit të vendimit të arsyetuar. Ky vendim publikohet në faqen zyrtare të Gjykatës së Lartë, në pjesën e përcaktuar për Këshillin e Emërimeve në drejtësi”, me argumentin se kandidatja nuk ka ushtruar së paku për 15 vjet veprimtari profesionale nga ato të parashikuara si kusht për lejimin e kandidimit nga pika 4 e nenit 125 të Kushtetutës dhe shkronja a e pikës 2 të nenit 7/a të ligjit nr. 8577/2000.

KED ka arsyetuar midis të tjerave se: “Në kuptim dhe zbatim të dispozitave kushtetuese dhe ligjore të lartpërmendura, nisur nga të dhënat mbi kohëzgjatjen dhe llojin e veprimtarisë profesionale të ushtruar, Këshilli konstaton se kandidatja Vjosa Bodo (Mujo) ka një përvojë pune prej 10 vjet e 5 muaj si juriste dhe si drejtore e departamentit juridik pranë SICRED sh.a.. Kjo eksperiencë konsiderohet nga Këshilli si eksperiencë pune në sektorin privat, ndërkohë që Kushtetuta dhe ligji nr. 8577/2000, parashikojnë si kusht eksperiencën e punës në administratën publike. Këshilli vlerëson se duke mos marrë në konsideratë periudhën e kohës pranë sektorit privat, si dhe atë si sekretare, kandidatja nuk plotëson kushtin e vjetërsisë në punë për të qenë kandidate për gjyqtare në Gjykatën Kushtetuese, pasi ka më pak se 15 vjet përvojë pune në pozicionet e kërkuara nga neni 125 i Kushtetutës dhe neni 7/a i ligjit nr. 8577/2000. Për këtë arsye, Këshilli nuk e sheh të nevojshme të arsyetojë nëse periudha kur kandidatja ka ushtruar për 5 vjet funksionin e specialistes pranë Ministrisë së Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Tiranë (16.04.2004 – 03.03.2009), për shkak të detyrës së kryer, hyn në kategorinë e juristes së nivelit të lartë. Nga ana tjetër, pasja e titullit “Avokat” që prej vitit 2002, nuk vlerësohet prej Këshillit si eksperiencë profesionale në kuptim të pikës 2 të nenit 7/a të ligjit nr. 8577/2000, për sa kohë që nga dokumentacioni i paraqitur dhe i administruar prej Këshillit, nuk rezulton që kandidatja të ketë ushtruar efektivisht këtë profesion. 61. Nisur nga sa analizohet dhe arsyetohet më sipër, bazuar në gjetjet dhe të dhënat e konstatuara gjatë procedurës së verifikimit që rezultojnë nga aktet dhe dokumentacioni që përmban dosja e kandidimit, në interpretim dhe zbatim të ligjit të zbatueshëm për kushtet dhe kriteret e kandidimit për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, vjen në përfundimin se duhet të vendoset ndalimi i kandidimit të kandidatës Vjosa Bodo (Mujo), në vendin vakant për gjyqtar në

Gjykatën Kushtetuese, të shpallur nga Kuvendi i Republikës në datën 28.08.2018 dhe rishpallur në datën 21.08.2019, pasi kjo kandidate nuk plotëson kriterin e përvojës në punë”.

Pala e paditur KED në zbatim të ligjit ka njoftuar palën paditëse për vendimet e marra prej saj më datë 30.07.2020 (njoftimi është kryer në rrugë elektronike në adresën e deklaruar nga vetë kandidatja). Paditësja pasi është njohur me vendimet e marra nga i padituri KED dhe duke mos qenë dakort me to, i është drejtuar me padi Gjykatës Administrative të Apelit në datë 04.08.2020.

Pretendimet e palëve

Pala paditëse kërkoi pranimin e padisë ankimore; konstatimin e pavlefshmërisë së vendimit nr.17 dhe nr.18 datë 17.07.2020 “Për ndalimin e kadidimit të znj.Vjosa Bodo (Mujo), për vendin vakant të anëtarit të Gjykatës Kushtetuese” të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, për shkak të marrjes së tyre, në shkelje të rënda të procedurës së vlerësimit; detyrimin e Këshillit të Emërimeve në Drejtësi të marrë sërish në vlerësim kandidaturën e ankueses Vjosa Bodo Mujo, duke i bërë vlerësimin e kriterëve profesionale dhe pikëzimin në përputhje me ligjin, duke pretenduar se:

1. Pala e paditur me vendimet nr. 17, 18 datë 17.07.2020 ka vendosur: Ndalimin e kandidimit të kandidates Vjosa Budo (Mujo), në vendet vakante për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese, në të 2 pozicionet e aplikuar. Këto vendime janë vendime të marra në kundërshtim të hapur me rregullat procedurale për të pasur një proces të rregullt ligjor, të bazuar në “ndershmëri dhe vlerësim objektiv”, të cilat nëse do të ishin respektuar nga ana e organit, do të kishte një vendimmarrje të ndryshme nga ajo që është marrë. Për këtë arsye, në mbështetje të kërkesave të nenit 237 dhe 238 të ligjit nr. 115/2016, parashtroj para gjykatës se shkeljet e rënda të kryera nga Këshilli rezultojnë në këto drejtime kryesore:
 - a) njoftimi rreth rezultateve konkrete të marra nga subjektet e treta;
 - b) diskutimi mbi bazë kontradiktoriteti i gjetjeve;
 - c) riezaminimi i të dhënave,
 - d) baza e vlerësimit ligjor të gjetjeve;
 - e) shkeljen e rregullave procedurale të parashikuar në nenin 223, 224 dhe 225 të Ligjit nr. 115/2016, për sa i përket formimit të trupës vlerësuese me anëtarë të paanshëm qoftë edhe në dukje;
 - f) shkeljen e rregullave procedurale në thirrjen e mbledhjes së organit kolegjal, standardet që duhet të përmbushin aktet që i nënshtrohen vlerësimit dhe vendimmarrjes së organit kolegjal, procedurat që ndjek organi kolegjal në diskutimin e çështjeve për të cilat është thirrur.
 - g) e drejta për tu dëgjuar;
 - h) e drejta për tu mbrojtur;

- i) *shmangie e paarsyeshme nga zbatimi i praktikës së deritanishme të organit, si dhe mbajtje e qëndrimeve të ndryshme për çështje të ngjashme brenda të njëjtës mbledhje plenare;*
- j) *Mungesa e standardeve në mirëpërcaktimin e kriterëve ligjore mbi bazën e të cilit duhet të kryhet procedura e vlerësimit të kandidatëve, duke respektuar parimin e trajtimit të barabartë, të drejtë dhe të ndershëm, si dhe duke garantuar ekuilibrin kushtetues dhe ligjor që duhet të ekzistojë midis sektorit publik dhe atij privat.*
- k) *Vendosja e kufizimit të së drejtës në mënyrë të paarsyetuar dhe në kundërshtim me kriteret ligjore dhe frymën e kushtetutës,*
- l) *Mungesë e arsytimit të vendimit.*



Pretendimet e paraqitura nga ankuesi në këtë gjykim, qartësisht evidentojnë se nga ana e Këshillit janë lejuar shkelje të rënda në zbatimin e ligjit, shkelje të cilat e bëjnë nul të gjithë procedurën e vlerësimit të ndjekur për vlerësimin e kandidaturës së ankueses dhe të pavlefshëm vendimmarrjen për ndalimin e saj për vendin vakant të gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese të shpallur dhe rishpallur nga Kuvendi i Shqipërisë dhe Presidenti i Republikës.

➤ ***Në lidhje me njoftimin e rezultateve të marra nga subjektet e treta;***

Këshilli nuk rezulton ta ketë njoftuar paditësen sipas kërkesave që parashikon ligji, në lidhje me të dhënat që ka marrë pranë organeve të treta. Në asnjë rast, Këshilli nuk rezulton të ketë bërë me dije se cilat janë të dhënat që kanë konfirmuar institucionet e treta, kryesisht me punësimin e saj, i cili ka përbërë edhe shkaku kryesor mbi bazën e të cilit ka vendosur ndalimin e kandidimit të saj për anëtar i Gjykatës Kushtetuese.

Nuk rezulton e provuar në asnjë komunikim elektronik apo shkresor, që Këshilli të ketë hetuar apo të ketë kërkuar informacion në lidhje me këto çështje: (i) mënyrën se si është rekrutuar në punë tek secili prej pozicioneve konkret që ka mbajtur në sektorin publik dhe atë privat; (ii) kushtet dhe kriteret që duhet të plotësojnë për kryerjen e këtyre detyrave; (iii) natyrën e çështjeve që ka ndjekur, (iv) aktet konkrete që ka hartuar apo përpiluar në këto detyra; në mënyrë që të kishte përmbushur të paktën kriterin e një hetimi të plotë dhe të gjithanshëm të çështjes.

Referuar përmbajtjes së relacionit që i është dërguar Këshillit për vlerësim në datën 17.07.2020 nuk ka asnjë lloj të dhëne në lidhje me këto çështje, duke pasur vetëm një citim të thjeshtë telegrafik të pozicioneve të punës që paditësja ka kryer, pa asnjë lloj vlerësimi paraprak apo përshkrimi konkret pune, që ka mbuluar në këto pozicione. Po në referim të përmbajtjes së relacionit që i është bërë me dije nga ana e Këshillit, nuk rezulton që të jetë evidentuar fakti se paditësja-ankuese është licencuar me titullin “Avokat” që në vitin 2001 në përputhje me parashikimet e ligjit “Për avokatinë”. Ky titull nuk i është hequr apo pezulluar që nga momenti i fitimit të tij, pavarësisht periudhës të ushtrimit aktiv të këtij profesioni nga pikëpamja e legjislacionit tatimor. Në relacion, nuk rezulton të jetë pasqyruar apo evidentuar fakti se ankuesja është rekrutuar në detyrën e specialistit juridik të shoqërisë SiCred sh.a, pikërisht për faktin se ishte e licencuar si



“Avokate” dhe se detyrat funksionale të saja në këtë detyrë, ishin të barasvlerësuar me ushtrimin e profesionit të avokatit të shoqërisë.

Gjithashtu, nuk rezulton që nga ana e Këshillit të jetë hetuar, verifikuar si dhe as të jetë pasqyruar fakti se, ankuesja e ka ushtruar rregullisht profesionin e avokatit, me detyrime financiare të paguara rregullisht, të paktën që nga viti 2012. Për këtë arsye, nisur edhe nga veprimtaria që paditësja kryente “*de facto*” si avokate e kompanisë SiCRED sh.a, pavarësisht emërtesës së përdorur në organikën e brendshme të saj si “*specialiste juriste*”, pronarët e kompanisë kanë vlerësuar në vitin 2012 krijimin e subjektin juridik SiCRED Assistance shpk (subjekt juridik i së drejtës shqiptare rregjistruar në 17-07-2012 me numër unik identifikimi NIPT L21917030K), i cili ka në objekt të veprimtarisë së tij (citon ekstrakt nga QKB seksioni objekti “.....*Shërbime konsulence dhe asistencë ligjore për zbatimin e legjislacionit në fuqi; si edhe të shërbimeve të ndërmjetësimit, dhe të ndërmjetësimit në punësim....*”, Ky subjekt juridik, është krijuar në çdo akt të tijin (*akt themelimi, statut, organigramë, udhëzues, rregullore, akte normative të brendshme, raporte këshillimore, kontrata etj..*) të gjitha nga puna dhe veprimtaria profesionale e paditëses dhe për këtë arsye, drejtimi i saj ekzekutiv që nga themelimi e aktualisht në rolin e Administratores së vetme i është besuar personit në fjalë-paditëses (*referojuni të dhënave në portalin publik të QKB, kopje të të cilit i ka dhënë që në deklarinimin e parë të kryer për këtë garim*). Në drejtim të zbërthimit të këtyre të dhënave, nuk rezulton që Këshilli të ketë hetuar, verifikuar dhe të ketë analizuar faktet dhe rrethanat e nevojshme për shqyrtimin e kësaj çështjeje, duke konkluduar qartësisht gabim, se paditësja nuk i plotëson kriteret formale për lejimin e kandidimit, edhe pse 10 vjet në sektorin privat, ka mbajtur dhe ushtruar funksionin e “*Avokatit*” të liçencuar, ose të ekuivalentuar me të. Madje Këshilli (KED) nëpërmjet e-mail fillestar me anë të të cilit kërkonte shpjegim, e ka zhveshur faktin, pasi nuk e parashtron asfare në prezantimin e tij faktin që paditësja është e dypunësuar dhe as nuk adreson pyetje apo pikëpyetje, që mund të kishte lidhur me këtë veprimtari të provuar me evidenca faktike profesionale të saj, nën drejtimin e këtij subjekti së paku që nga krijimi deri tash për plot 8 vjet. Besimi nga pronarët për pozicionin e Administratores, nuk erdhi rastësisht si vendimmarrje, por si një kriter themelor, që një shoqëri konsulence ligjore mund ta udhëheqë një jurist i spikatur dhe avokat i liçencuar.

Në asnjë paragraf apo punë hetimore paraprake, nuk rezulton që Këshilli të ketë hetuar apo të ketë kërkuar informacion rreth performancës të punës, detyrat që ka mbuluar, ecurisë në karrierën profesionale të paditëses, në mënyrë që të arrihet në konkluzionin se ky organ ka zhvilluar të paktën nga pikëpamja formale një hetim të plotë dhe të gjithanshëm. Nuk rezulton në asnjë akt paraprak të kryer e vlerësuar nga relatori i çështjes, e më tej nga Këshilli në mbledhjen e datës 17.07.2020 (për aq sa është reflektuar dhe pasqyruar në vendimet përfundimtare), se mbi cilat baza ligjore, fakte dhe rrethana konkrete ka konkluduar, se paditësja nuk përmbush kriteret formale në drejtim të vjetërsisë në punë, duke e kthyer veprimtarinë e saj hetimore administrative në një citim

të thjeshtë të vetëm një librezë pune (asaj të subjektit SiCRED sh.a. dhe jo dhe të subjektit Sicred Assistance shpk) dhe mbledhjes aritmetike të viteve, duke shkelur kështu frymën që ka përcjellë Kushtetuta, për t'i dhënë këtij Këshilli një rol të rëndësishëm dhe substancial, në procedurën e verifikimit dhe përzgjedhjes së kandidatëve për anëtar të Gjykatës Kushtetuese.

Në analizë të të gjithë dispozitave ligjore të zbatueshme në rastin objekt shqyrtimi, vlerësohet se kandidatët i depozitojnë kërkesat për vendet vakante të shpallura pranë organeve respektive të emërtesës (nenit 234 të ligjit 115/2016), të cilët më pas ja përcjellin Këshillit për të vijuar me vlerësimin e tyre në themel. Në referim të nenit 235, 236 dhe 237 të ligjit nr.115/2016, ligjvënësi qartësisht ka vlerësuar, se një verifikim paraprak formal në lidhje me tre kriteret kryesore në të cilat duhet të hetohet secili kandidat për anëtar të Gjykatës Kushtetuese, duhet tu kërkohet organeve të specializuara dhe ndihmëse në këtë proces, duke i përcaktuar ato qartësisht për secilën fushë.

Në asnjë akt të ndërmjetëm, të nxjerrë gjatë zhvillimit të procedurës hetimore administrative në verifikimin e kriterëve të tjera ligjore, kryesisht të lidhura me vjetërsinë në punë dhe përvojën profesionale, nuk rezulton që Këshilli të ketë përcaktuar dhe identifikuar qartësisht se: (i) tek cilat organe konkrete ka kryer mbledhjen e të dhënave; (ii) çfarë të dhënash janë kërkuar pranë këtyre organeve; (iii) cilat janë të dhënat që këto organe kanë dhënë apo konfirmuar; (iv) në çfarë mënyre dhe në cilin drejtim janë përpunuar këto të dhëna nga organi, (v) cilat çështje janë identifikuar si “gjetje” për të cilat është kërkuar sqarim, verifikim, hetim shtesë; (vi) si janë sqaruar dhe argumentuar të gjitha këto të dhëna, duke konkluduar, në një rezultat përfundimtar në lidhje me zgjidhjen e çështjes; në mënyrë që procesi i verifikimit të kriterit ligjor të tretë, t'i afrohet dhe përshtatet të njëjtit standard kushtetues dhe ligjor, sikundër është vlerësuar edhe për dy kriteret e tjera.

Ky konstatim është tërësisht i lidhur me pasjen e një procesi të rregullt ligjor, një procedure transparente dhe të rregullt hetimore, i cili për shkak të paqartësisë së tij mund të cenojë rëndë rezultatit e vendimmarrjes, sikundër ka ndodhur në rastin objekt shqyrtimi. Për sa kohë ligjvënësi ka përcaktuar se të tre kriteret kryesore, mbi bazën e të cilave duhet të hetohen kandidatët për anëtarë të Gjykatës Kushtetuese, janë të natyrës kumuluese, pra moskalimi apo mosplotësimi qoftë edhe i njëjës prej tyre, passjell automatikisht edhe ndalimin e kandidimit (pika 30 e Vendimit nr. 4, datë 11.03.2019, i ndryshuar). Për këtë arsye, në kushtet kur Këshilli ka qenë sipërfaqësor dhe i pa thelluar në mënyrën dhe çështjet e hetimit të kandidatit në drejtim të kriterit të vjetërsisë në punë dhe përvojës profesionale, e ka pasur tërësisht të pamundur për të nxjerrë rezultate konkrete hetimi, për sa kohë rezulton, se nuk ka kryer fare hetim derisa nuk ka përmendur asnjë argument apo të dhënë e cila mbështet vendimmarrjen e tij.

Mungesa e hetimit të thelluar, mbi çështje dhe kritere konkrete në drejtim të vjetërsisë së punës së kandidatit dhe cilësisë së tij profesionale, kanë passjellë edhe mungesën e qëndrimit konkret të relatorit të çështjes, në lidhje me vlerësimin paraprak, që duhet ti





bënte kandidaturës së ankueses, e më pas t'ja përcillte për vlerësim përfundimtar Këshillit si organi kompetent. Për këtë arsye paditësja arrin në konkluzionin, se Këshilli nuk ka plotësuar dhe as nuk ka garantuar procesin e rregullt ligjor në drejtim të respektimit të të gjitha kriterëve ligjore procedurale të verifikimit të kandidatit, duke e bërë vendimmarrjen objekt shqyrtimi, të marrë haptazi ndesh, me parashikimet e pikës 51/b të Vendimit nr. 4, datë 11.03.2019 të Këshillit, (i ndryshuar).

Në kushtet kur, ky organ nuk rezulton ta ketë informuar në lidhje e rezultatet e kërkimit pranë institucioneve të treta, si dhe në kushtet kur nuk i ka bërë evident asnjë vlerësim paraprak në lidhje me rezultatet e hetimit në drejtim të kriterit të vjetërsisë në punë dhe vlerësimin profesional, paditësja si kandidat në garë, ka qenë në pamundësi për tu mbrojtur dhe për të paraqitur dokumentacion shtesë, i cili do të zëvendësonte veprimtarinë hetimore që duhej të kryhej kryesisht nga Këshilli, por edhe do ta ndihmonte këtë të fundit, që bënte një vlerësim të plotë dhe të gjithanshëm të kandidaturës së saj duke identifikuar specifikisht se në cilat drejtime ankuesja nuk arrinte të provonte kalimin e pragut minimal të kriterit të vjetërsisë në punë dhe aftësive profesionale, në kuptim të nenit 125 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenit 7/a të Ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese", i ndryshuar, si dhe praktikës vlerësuese të këtij organi të kryer për raste të ngjashme (*referojuni, vendimeve të dhëna nga Këshilli për raste të ngjashme gjatë vitit 2019, si dhe vetë vendimeve të tjera të mbajtura për kandidatët e tjerë, po në datën 17.07.2020*).

Referuar procedurës, që ka ndjekur Këshilli gjatë verifikimit të kriterit profesional për ankuesen, rezulton e provuar, se Këshilli në asnjë rast nuk ka identifikuar, pasqyruar apo kërkuar sqarim ose shpjegime në lidhje me faktin, nëse ushtrimi i veprimtarisë profesionale në *sektorin privat*, barazohet me veprimtarinë që parashikon dhe kërkon neni 7/a i Ligjit nr. 8577/2000 i ndryshuar. Në kërkesat për sqarim, Këshilli ka kërkuar parashtrime shtesë vetëm në drejtim të faktit, nëse pozicionet e punës të deklaruara prej saj, barazohen me ato pozicione pune që parashikon neni 7/a I Ligjit nr. 8577/2000, (i ndryshuar). Në këtë drejtim, Këshilli, nuk rezulton që të ketë përmbushur detyrimet e tij ligjore për t'i bërë me dije çështjet që ai i ka konsideruar si "gjetje", në kundërshtim të plotë me sa parashikon pika 26 dhe 30 të Vendimit nr. 4, datë 11.03.2019 të Këshillit, (i ndryshuar).

Referuar përmbajtjes së vendimeve objekt shqyrtimi, Këshilli ka përdorur si argument për ndalimin e kandidimit të paditëses, një çështje për të cilën as i ka bërë me dije dhe as nuk i ka kërkuar sqarim të detajuar, në përputhje me procedurat e verifikimit, që po vetë i ka miratuar. Për sa kohë në vendimet përfundimtare objekt kundërshtimi, është përdorur si argument ndalues, vetëm fakti që veprimtaria profesionale në sektorin privat, nuk përfshihet në kriteret ligjore të parashikuara nga ligji organik për Gjykatën Kushtetuese, e cila nga aktet paraprake të verifikimit nuk është evidentuar apo deklaruar si "gjetje", si dhe çështjet, që janë evidentuar dhe deklaruar si "gjetje" nuk janë marrë fare në arsyetim,

pasi nuk janë vlerësuar si të nevojshme, përbëjnë shkelje të rënda të procedurës së vlerësimit dhe prishje të parimeve themelore për të pasur një proces të rregullt ligjor transparent, të drejtë dhe të ndershëm (neni 229/2 i ligjit nr. 115/2016).

Bazuar në sa më sipër, rezulton e paqartë se për çfarë arsyesh ka ndryshuar orientimi i vendimmarrjes së Këshillit, drejt çështjeve të cilat paraprakisht nuk rezulton të jenë evidentuar si “gjetje”, si dhe t’i jenë bërë me dije ankueses, në mënyrë që kjo e fundit të dëgjohej dhe të mbrohej para organit, qoftë edhe në mënyrë formale, përpara se ai të merrte një vendim. Në përmbajtje të relacionit të dërguar për vlerësim tek Këshilli, evidentohet lehtësisht se ushtrimi i veprimtarisë profesionale në sektorin privat, nuk evidentohet që t’i jetë bërë me dije ankueses, si “gjetje” gjatë procedurës paraprake të vlerësimit, në mënyrë që kjo e fundit të kishte mundësi për të dhënë sqarime (parimi i kontradiktoritetit), për tu dëgjuar dhe për tu mbrojtur. Pra, në kuptim të garantimit të një procesi të rregullt ligjor, me të drejtë lind pyetja se në çfarë mënyre Këshilli e ka shmangur këtë të drejtë të ankueses, duke vijuar shqyrtimin e kandidaturës së saj dhe duke dalë më një vendim përfundimtar për çështje, që palës së interesuar nuk i janë bërë kurrë me dije.

Bazuar sa më sipër, vendimet objekt shqyrtimi, rezultojnë të jenë marrë në kundërshtim flagrant me procedurën e parashikuar në nenin 48 të Vendimit nr. 4, datë 11.03.2019 të Këshillit, i ndryshuar në të cilin parashikohet se: *“Në rastin kur, pas shqyrtimit të relacionit dhe të akteve që përmban dosja e kandidatit të verifikuar, Këshilli vjen në përfundimin që ka vend për të vlerësuar edhe mundësinë e ndalimit të kandidimit, por në atë çështje nuk janë ndjekur procedurat e përcaktuara në pikat 22 deri në 27 të këtij Vendimi, shpall caktimin e një seance tjetër për shqyrtimin e çështjes. Kandidatit të verifikuar i njoftohet materiali me gjetjet dhe motivet të cilat mund të sjellin ndalimin e kandidimit. Kandidati ka të drejtën e parashtrimit me shkrim të shpjegimeve të tij dhe dokumenteve mbështetës, jo më vonë se 5 ditë nga ajo e ardhjes në dijëni të materialit të dërguar nga Këshilli”*.

➤ **Diskutimi mbi bazë kontradiktoriteti i gjetjeve dhe riekzaminimi i të dhënave;**

Rezulton e provuar se, pasi ankuesja ka paraqitur sqarime dhe prova shtesë pranë Këshillit, në lidhje me vjetërsisë në punë dhe natyrës së punës së kryer në kuptim të parashikimeve ligjore të nenit 7/a të Ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese", (i ndryshuar), relatori që ka përfunduar procesin e verifikimit të vlerësimit të kriterëve ligjore për kandidaturën e saj, nuk rezulton ta ketë njoftuar në lidhje me: (i) se sa të mjaftueshme kanë qenë shpjegimet e saj për sqarimin e çështjes; (ii) cilat prej tyre janë marrë në konsideratë; si dhe (iii) cilat shpjegime nuk plotësonin kriterin e provueshmërisë. Gjithashtu në kuadër të zhvillimit të një procesi të rregullt ligjor, nuk rezulton, që të jetë njoftuar apo t’i jenë bërë me dije nëse faktet, rrethanat dhe provat e parashtruara shtesë nga ana e saj i janë nënshtruar kontrollit, verifikimit dhe hetimit me qëllim riekzaminimin e këtyre të dhënave, si dhe arritjes së një konkluzioni përfundimtar në lidhje me to. Në relacionin e dërguar nga ana e Këshillit





nëpërmjet e-mailit të datës 13.07.2020, nuk rezulton ti jetë bërë me dije, se nga ana e këtij organi (përfaqësuar nga relatori i çështjes), është kryer ndonjë proces vlerësues dhe verifikues shtesë, pas parashtrimit të pretendimeve dhe provave të paraqitura në datën 12.11.2019. Në këtë relacion, nuk është pasqyruar asnjë qëndrim i qartë dhe shterues i relatorit të çështjes, në lidhje me rezultatet përfundimtare të hetimit, si dhe propozimit konkret për zgjidhjen e çështjes, sikundër e parashikon neni 228, pika 5/c të Ligjit 115/2016, si dhe pikave 25 26 dhe pikës 95 të Vendimit nr. 4, datë 11.03.2019 të Këshillit, i ndryshuar. Sa më sipër, aplikantja parashtron para gjykatës, se mungesa e njoftimit të të dhënave përfundimtare të hetimit paraprak në relacionin e dërguar nga Këshilli 4 (katër) ditë para zhvillimit të mbledhjes, për marrjen e një vendimi përfundimtar, ka cënuar pasjen e një procesi të rregullt ligjor, transparent dhe të drejtë. Mungesa e njoftimit të përfundimeve konkrete të hetimit nga ana e relatorit të çështjes në aktin e relacionit të njoftuar, tregon, se Këshilli nuk ka arritur në konkluzione përfundimtare në lidhje me vlerësimin e kriterëve ligjore, për sa i përket vjetërsisë në punë dhe cilësisë profesionale të ushtrimit të profesionit të juristit nga ana e aplikantes, duke e lënë nxjerrjen e këtyre përfundimeve në gjendje të lirë, nga mbledhja e organit kolegjal, në kundërshtim të hapur me sa parashikon pika 95 e Vendimit nr. 4, datë 11.03.2019 të Këshillit në të cilin pasqyrohet se: *“Nëse nga gjetjet dhe përfundimet e nxjerra nga dokumentacioni i paraqitur nga kandidati, si edhe nga gjetjet e përfundimet e nxjerra nga shqyrtimi i shkresave të dërguara nga subjektet publike dhe private, relatori vlerëson se ka të dhëna që mund të sjellin ndalimin e kandidimit, procedon me përgatitjen relacionit mbi gjendjen e faktit dhe të ligjit të zbatueshëm për sa i përket verifikimit të kushteve dhe kriterëve të tjera ligjore dhe e dërgon menjëherë çështjen për shqyrtim në mbledhjen e Këshillit”*.

Pas dhënies së sqarimeve dhe provave shtesë në datën 12.11.2019, nuk rezulton që Këshilli të ketë ngritur dyshime rreth fakteve dhe rrethanave të evidentuara nga ana e paditëses në e-mailin sqarues të datës 12.11.2019, duke prezumuar pranimin e tyre (referojuni parashikimeve të pikës 92 dhe 93 të Vendimit nr. 4, datë 11.03.2019 të Këshillit, i ndryshuar). Në relacionin përfundimtar, rezulton qartësisht e provuar, se nuk është dhënë asnjë rezultat përfundimtar i hetimit, në lidhje me kriteret ligjore që kanë lidhje me vjetërsinë në punë, si dhe vlerësimin profesional, sikundër ka referuar për kriteret e tjera (pasuria, figura, pastërtia e figurës etj), në mënyrë që të evidentohet fakti, nëse sqarimi i pikëpyetjeve të ngritura më herët nga ana e Këshillit, ishin shuar apo ishin thelluar më shumë. Ky fakt provon qartësisht se Këshilli nuk ka kryer asnjë lloj veprimi hetimor mbi bazën e kontradiktoritetit dhe ekzaminimit të të dhënave të parashtruara prej meje, duke e kthyer procesin e vlerësimit të kriterëve ligjore në një verifikim thjesht formal të gjeneraliteteve, pa asnjë lloj qëllimi për të vlerësuar realisht, nëse plotësoheshin ose jo nga ana e paditëses - ankuese me anë të këtij akti, kriteret ligjore në drejtim të vjetërsisë në punë dhe profesionalizmit. Në përfundim të çdo lloji procedure hetimore, përpara se të merret vendimi përfundimtar, çdo organ procedues ka detyrimin që të bëjë

evidente: *i)* gjetjet kryesore të hetimit, *ii)* fokusin dhe drejtimin në të cilën janë analizuar këto gjetje; *iii)* qëndrimin e subjektit të interesuar në lidhje me to nëpërmjet dhënies së parashtrimeve dhe prapësimeve, provave shkresore provuese etj, *vi)* vlerësimin, nëse këto pretendime janë pranuar ose jo nga ana e organit procedues; si dhe *v)* dhënien e konkluzioneve përfundimtare të hetimit, mbi bazën e të cilave, do të diskutohet dhe të merret vendimi nga organi kompetent. Kjo është një kërkesë, që ligji e ka parashikuar qartësisht jo vetëm në parimet e përgjithshme të hetimit administrativ, të cilat parashikohen në Kodin e Procedurave Administrative, por edhe në rregullat ligjore me të cilat funksionojnë organet kolegjiale, të cilat janë të detyrueshme për tu zbatuar, nga Këshilli në përmbushje të parashikimeve të nenit 229/1 të Ligjit nr. 115/2016.

➤ ***Baza e vlerësimit ligjor të gjetjeve***

Të dy vendimet e marra nga Këshilli në datën 17-07-2020, rezultojnë të jenë vendime të marra apriori dhe jo mbi bazën e një procedure hetimore apo verifikuese të plotë, të rregullt, me qëllim verifikimin real të kriterëve ligjore në drejtim të vjetërsisë në punë dhe performancës profesionale. Në asnjë pjesë të relacionit të çuar për diskutim në mbledhjen e Këshillit, nuk evidentohet se në cilin drejtim konsistojnë gjetjet e relatorit, dhe në çfarë drejtimi vlerësohen ato. Për rrjedhojë, paditësja e konsideron vendimmarrjen në shkelje të rëndë të procedurës për të verifikuar paqartësitë, apo për të vlerësuar përfundimisht ato rrethana dhe “*gjetje të reja*”, që kanë rezultuar pas procedurës së thelluar verifikuese të relatorit të çështjes fillimisht, dhe më pas të vetë Këshillit, në lidhje me papajtueshmëritë Kushtetuese të kandidaturës së saj, sa i përket viteve të eksperiencës në punë.

Rezultojnë e provuar se pas datës 12.11.2019, kohë në të cilën kandidatja kishte barrën e provës për të argumentuar dhe sqaruar qëndrimin e saj në lidhje me vitet e punës, nga ana e Këshillit nuk është kryer më, asnjë procedurë ligjore verifikuese apo njoftuese për mbylljen e hetimeve, duke zvarritur procedurën e vlerësimit të saj, pa asnjë arsye ligjore dhe jashtë çdo parashikimi ligjor e kushtetues për gati 11 muaj, për të mbërritur në fund, në një vendimmarrje se ankuesja nuk plotëson vjetërsinë profesionale prej 15 vitesh, pasi 10 vite pune i kishte në sektorin privat, i cili edhe pse nuk është argumentuar në mënyrë të qartë, të lë të kuptosh, se përjashtohet nga sfera prej të cilës mund të zgjidhen kandidatët për anëtarë të Gjykatës Kushtetuese.

Paditësja vlerëson të evidentojë faktin, se për kandidaturën se saj për pozicionin vakant për anëtar të Gjykatës Kushtetuese të shpallur dhe të rishpallur nga Kuvendi i Shqipërisë, janë caktuar tre relatorë të ndryshëm, të cilëve, ju janë dashur shumë kohë për të konkluduar se ajo (paditësja) nuk plotëson kushtet dhe kriteret formale ligjore për të qenë kandidat për Gjykatën Kushtetuese, se përvoja e saj profesionale prej 10 vitesh ka qenë në sektorin privat. Për këtë arsye, nuk arrin të kuptoj, se çfarë hetimi të thelluar duhet të kryente Këshilli në drejtim të evidentimit të këtij fakti, për sa kohë që, ai ka qenë në dijeni të tij, pasi paditësja-ankuese së bashku me dokumentet e tjerë provues, ka dorëzuar edhe të gjitha librezat e punës, ku pasqyrohen saktësisht vitet dhe detyrat e kryera, brenda



sektorit publik dhe atij privat, përgjatë gjithë përvojës profesionale së saj prej 17 viteve. Në këtë kuptim, procesi i vlerësimit të kandidaturës së saj, rezulton të ketë qenë hapur i paragjykuar, si nga pikëpamja e formës ashtu edhe ajo e përmbajtjes, si dhe në kundërshtim të hapur edhe më vetë parashikimet e kryera në pikën 5/1, 5/2, 30 dhe të vendimit nr. 4, datë 11.03.2019 të Këshillit, i ndryshuar, në të cilin pasqyrohet qartësisht se: *“Nëse vlerëson që kandidati nuk përmbush ndonjërin prej kushteve dhe kriterëve të tjera ligjore të kandidimit, relatori procedon me përgatitjen e relacionit përkatës mbi gjendjen e faktit dhe të ligjit të zbatueshëm dhe dërgimin menjëherë të çështjes për shqyrtim në mbledhjen e Këshillit, pa qenë i nevojshëm kryerja e procedurës së verifikimit për të gjitha kushtet dhe kriteret e tjera ligjore”*.

Këshilli, në cilësinë e organit kushtetues ka shkelur rëndë parimet bazë të një gjykimi të drejtë, të paanshëm dhe të pavarur në gjykimin dhe interpretimin kushtetues, që duhej t’i bënte çështjes objekt shqyrtimi. Relatori i çështjes rezulton të ketë dështuar, për të adresuar dhe për të argumentuar para organit vendimarrës, se përse subjekti aplikant, nuk përmbushte kërkesat formale në drejtim të vjetërsisë në punë, referuar nenit 7/a të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese", (i ndryshuar). Rezulton e provuar se relatori i çështjes në kuptim të pikës 5/2, gërma "b" të Vendimit 4, datë 11.03.2019, (i ndryshuar), ka vlerësuar veprimet paraprake të kryera nga relatori paraardhës, si dhe nuk ka vlerësuar, se në këtë çështje duhet të ishin kryer veprime të tjera shtesë në kuptim të pikës 5/1 të po këtij vendimi. Megjithatë, rezulton qartësisht e provuar se Këshilli, kur ka marrë vendimin në lidhje me këtë çështje, rezulton të ketë mbajtur në vëmendje "gjetje", të ndryshme nga ato, që i janë njoftuar kandidates ankuese, si dhe janë evidentuar si të tilla nga relatori i çështjes. Në këtë drejtim, nuk rezulton i qartë, se cilat kanë qenë rrethanat dhe faktet që kanë ngritur indicie fillestare tek organi procedues në përcaktimin e "gjetjes", por edhe më vonë tek anëtarët e Këshillit gjatë mbledhjes së datës 17.07.2020, për të orientuar "gjetjen" në një drejtim tjetër, nga ai, që ishte evidentuar gjatë veprimeve paraprake të shqyrtimit, duke lejuar mbajtjen hapur të procedurës së vlerësimit për mua ankuesen për gati 11 muaj, në kundërshtim me sa parashikojnë dispozitat ligjore të zbatueshme (pika 5/1; 5/2, 30 dhe 95 të Vendimit nr. 4, datë 11.03.2019). Rezulton e provuar, se vetëm relatorët që kanë përfunduar procedurën e vlerësimit paraprak të kësaj çështje, ju janë dashur rreth 6 muaj për të konstatuar se 10 vitet e punës së kandidatit në sektorin privat, nuk përfshihen në veprimtarinë që kërkon dhe parashikon neni 7/a i ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese", (i ndryshuar), për të cilën as nuk kanë vlerësuar, nëse duhej t’i bëhej me dije subjektit të intersuar ky fakt ose jo, si dhe nëse për zgjidhjen e drejtë të çështjes, duhet të kryenin ndonjë veprim hetimor shtesë, në mënyrë që të garantonin kryerjen e një procesi të rregullt ligjor. Për këtë arsye, kjo procedurë shqyrtimi jo vetëm që vjen në kundërshtim me parashikimet procedurale të evidentuara si më sipër, por edhe me afatet ligjore të shqyrtimit të përcaktuara qartësisht në këtë vendim, duke ngritur dyshime të arsyeshme për shkaqet e vërteta, që kanë

obliguar organin, për të vendosur ndalimin e paditëses nga kandidimi për vendet vakante për anëtar të Gjykatës Kushtetuese.

Gjithashtu, qartësisht evidentohet fakti se, Këshilli ka qenë në dijeni se ankuesja shumicën e vjetërsisë në punë e kishte në sektorin privat, fakt i cili provohej qartësisht nga formularët e plotësuar prej saj, si dhe dokumentacioni ligjor mbështetës (librezë pune, CV, shkresat konfirmuese të ardhura nga subjektet punëdhënëse për aplikantën, cituar në relacion dhe në vendim etj). Në këtë drejtim, për cilat shkaqe dhe rrethana relatorët e caktuar për shqyrtimin e kërkesave të saj, kanë vijuar me procedurën e verifikimit të kriterëve të tjera (kryesisht vjetërsisë në punë), kur puna e kryer nga ankuesja në sektorin privat mundej lehtësisht të evidentohej, se nuk përfshihej si kriter ligjor në parashikimet e nenit 7/a të ligjit nr.8577, datë 10.02.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese", (i ndryshuar), pa nevojën për të kryer veprime shtesë. Për këtë arsye, paditësja parashtroi para gjykatës se, relatorët e çështjes nuk kanë zbatuar parashikimet e pikës 30 dhe 95 të Vendimit nr. 4, datë 11.03.2019, për të çuar projekt-vendimin për ndalimin e kandidimit dhe relacionin bashkëshoqërues të tij, *menjëherë për vlerësim tek Këshilli*, por e kanë mbajtur shqyrtimin e kësaj çështje për rreth 6 muaj pa asnjë shkak të justifikueshëm ligjor (*të mbahet në vëmendje së relatorët janë caktuar në datën 15.01.2020, ndërsa situatë e vendosjes se emergjences per shkak te pandemisë ka filluar në datën 10 mars 2020*).

- Po t'i referohesh procedurës së ndjekur nga Relatori, gjatë verifikimit të këtij kriteri, rezulton e provuar se, pavarësisht faktit që ai ka miratuar të gjitha veprimet paraprake të kryera nga relatori i parë (i caktuar në Këshillin e vitit 2019), si dhe nuk ka ndërmarrë asnjë veprim tjetër hetimor shtesë, në vendimet objekt kundërshtimi (*për aq sa është mundur të pasqyrohet në pjesën arsyetuese të tyre*), rezulton se "gjetja" që ka marrë në analizë Këshilli në të dy vendimet e datës 17.07.2020 është krejt e ndryshme nga ajo, që i është komunikuar ankueses në cilësinë e subjektit të interesuar. Rezulton e provuar se "gjetja" që i është komunikuar ankueses në datën 06.11.2019, e cila nënkuptohet që është konfirmuar edhe në relacionin përfundimtar të komunimuar në datën 13.07.2020 (pasi nuk është shprehur qartësisht), ka pasur lidhje vetëm me faktin nëse "*pozicionet e punës që unë kisha ushtruar në sektorin publik dhe atë privat, mund të barazohen me ato në kuptim të nenit 7/a të Ligjit 8577/2000*". Ndërsa referuar pjesës arsyetuese të vendimeve objekt kundërshtimi, rezulton se "gjetja" e Këshillit, mbi bazën e të cilit ai ka vendosur ndalimin e kandidaturës së ankueses paditëse, ka pasur lidhje me përcaktimin e faktit nëse "*ushtrimi i veprimtarisë profesionale në sektorin privat, nuk mund të barazohet me veprimtarinë që parashikon dhe kërkon neni 7/a i ligjit nr.8577/2000 (i ndryshuar)*".

Në këto kushte, kaosi dhe paqartësia e hartimit të relacionit përfundimtar, si dhe veprimet e shqyrtimit paraprak të çështjes nga relatori përkatës, ka mundësuar faktin që Këshilli të marrë në analizë dhe vlerësim çështje {"gjetje"}, të cilat as i janë komunikuar dhe as i janë bërë ndonjëherë me dije. Madje përkundrazi, ato "gjetje" që i janë komunikuar dhe për të cilat paditësja ka mundur që të jap shpjegime, duke iu garantuar në një farë mënyrë





e drejta për tu dëgjuar dhe mbrojtur, janë anashkaluar tërësisht nga Këshilli, duke i vlerësuar si të parëndësishme dhe të panevojshme për tu marrë në shqyrtim. Vetëm konstatimi i këtyre dy fakteve të cituar, si më sipër, të cilët janë qartësisht dhe lehtësisht të evidentueshme, e bëjnë veprimtarinë e Këshillit tërësisht subjektiv, të paarsyeshëm, të pajustificuar si dhe të cënueshëm nga pikëpamja garantimit të një procesi të rregullt ligjor.

Shkeljen e rregullave procedurale të parashikuar në nenin 223, 224 dhe 225 të Ligjit nr. 115/2016, përsa i përket formimit të trupës vlerësuese me anëtarë të paanshëm qoftë edhe në dukje;

Në nenin 223 të ligjit nr. 115/2016, është parashikuar instituti i papajtueshmërisë së anëtarit të Këshillit, për të marrë pjesë në shqyrtimin e çështjeve apo diskutimet plenare të tij, në rast se midis tij apo kandidatit në garë ekzistojnë: 1) *marrëdhënie martesore ose bashkëjetese; 2) marrëdhënie gjinie të afërt, përfshirë persona të paralindur, të paslindur, vëllezër, motra, ungjër, emta, nipër, mbesa, fëmijë të vëllezërve dhe të motrave; ose 3) marrëdhënie krushqie të afërt, përfshirë vjehërr, vjehërrë, dhëndër, nuse, kunatë, thjeshtë dhe njerë.* Për të parandaluar marrjen e vendimeve në kushtet e papajtueshmërisë, ligjvënësi ka parashikuar dy mundësi: 1) *institutin e heqjes dorë nga shqyrtimi (neni 224); 2) institutin e përjashtimit dhe zëvendësimit të anëtarit (neni 225).*

Sipas akteve të bëra publike në faqen zyrtare të Gjykatës së Lartë, në rubrikën që i takon Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, znj. Fationa Memçaj, në cilësinë e anëtares së Këshillit, ka depozituar para Zv/Kryetarit të Këshillit në datën 17.07.2020, pra në të njëjtën ditë që ishte caktuar edhe zhvillimi i mbledhjes së Këshillit, kërkesën me nr.153 prot., datë 17.07.2020, me qëllim mosmarrjen pjesë në mbledhjet e ardhshme të Këshillit, në të cilat do të trajtoheshin çështje, që kishin për objekt verifikimin dhe vlerësimin e kandidatëve, si dhe procedurat konkrete të shqyrtimit të kandidimeve për pozicionet vakante të paraqitura nga Kuvendi i Shqipërisë.

Në këtë drejtim, paditësja vlerëson se proceduralisht paraqitja e heqjes dorë ditën e caktuar për mbledhjen e Këshillit është e pavlefshme. Arsyet janë, së pari, nuk arrihet të provohet momenti kur është dorëzuar kërkesa, pra ajo është dorëzuar përpara mbajtjes së mbledhjes apo pas zhvillimit të saj. së dyti, paraqitja e kërkesës është thjeshtë e karakterit formal, për të treguar se anëtari i Këshillit, qoftë edhe në dukje, po i jep mundësi palëve të përfshira në këtë procedim që të kenë proces të rregullt ligjor, apo paraqitja e saj, ka karakter tërësisht substancial dhe heqja dorë duhet të bëhet me domosdoshmëri, për shkak të garantimit të një procesi të rregullt dhe të vlefshëm ligjor.

Rezultoni e provuar, se të gjithë anëtarët e këshillit janë njoftuar në lidhje me datën dhe orën e zhvillimit të mbledhjes, të paktën 7 ditë para zhvillimit të saj, duke ju bërë me dije rendi i ditës, si dhe të gjitha aktet shoqëruese, që do të shqyrtohen gjatë mbledhjes. Në këtë kuptim, anëtarja Memçaj, kishte pasur mjaftueshmërisht kohë për të paraqitur kërkesën për heqje dorë, për më tepër, që rrethana që e ka bërë të papajtueshme, ka qenë e njohur, që në momentin kur pranë Këshillit janë regjistruar të gjithë kandidatët, që

konkuronin për vendet vakante të Gjykatës Kushtetuese, si dhe janë bërë publik në faqen zyrtare të Gjykatës së Lartë. Vlen të theksohet fakti se, afati i paraqitjes së kërkesës nga anëtarët e Këshillit për deklarimin e papajtueshmërisë, është i nevojshëm për garantimin e një procesi të rregullt ligjor në kuptim edhe të parashikimeve të nenit 225 të Ligjit nr. 115/2016 në të cilin është parashikuar se: *“Kandidatët mund të kërkojnë përjashtimin e anëtarit të Këshillit nga pjesëmarrja në verifikimin e kushteve ligjore, vlerësimin e kritereve profesionale dhe renditjen jo më vonë se 3 ditë nga data e mbledhjes së Këshillit, kur ekziston një nga shkaqet e parashikuara në nenet 133 dhe 134, të këtij ligji, dhe anëtari nuk heq dorë vetë nga shqyrtimi i çështjes...”*. Për sa më sipër, nuk rezulton e qartë se në çfarë mënyre Këshilli, ju ka garantuar kandidatëve në garë, pasjen e në procesi të rregullt ligjor, në lidhje me afatet e paraqitjes së kërkesave për heqje dorë nga gjykimi, kur për kandidatët në garë, ligji ka parashikuar se kërkesa për përjashtim të anëtarit të këshillit, duhet të paraqitet të paktën 3 ditë, para zhvillimit të mbledhjes, ndërsa për anëtarët e Këshillit heqja dorë, mund të bëhet edhe aty për aty. Andaj logjikshëm paditësja vë në dukje, se papajtueshmëria e anëtarit të organit publik, përbën shkak thelbësor për ta bërë nul, të gjithë procesin, si dhe është çështje që qëndron në thellet të kërimit, si në rastin kur kryhet me veprim aktiv të zyrtarit nëpërmjet mjetit procedural të kërkesës për heqje dorë, ashtu edhe kur ajo pretendohet nga pala nëpërmjet kërkesës për përjashtim të anëtarit të Këshillit.

- Më problematik nga pikëpamja e garantimit të një procesi të rregullt ligjor në rastin objekt shqyrtimi, është vendimi nr. 2, datë 17.07.2020 i Zëvendëskryetarit të Këshillit. Më këtë vendim, ky i fundit e ka kufizuar në mënyrë të paarsyeshme dhe në kundërshtim me sa parashikon neni 223 dhe 224 të Ligjit nr. 115/2016, i ndryshuar, pranimin e heqjes dorë të anëtares znj. Fatjona Memçaj, vetëm për subjektin në garë Ardita Buna, duke lejuar pjesëmarrjen e saj në mbledhjet dhe diskutimet për kandidatët e tjerë që garonin me këtë subjekt, për vendet vakante për anëtar të Gjykatës Kushtetuese, të shpalluara dhe të rishpallura nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë. Pra në këtë këndvështrim vlen të thesohet fakti se, në një proces garimi, ku kandidatët konkurojnë midis tyre për një ose dy pozicione, si dhe ligjvënësi ka parashikuar se është i nevojshëm pasja e të paktën tre kandidatëve për një pozicion vakant, papajtueshëria e anëtarit të Këshillit me njërin nga subjektet në garë, nuk mënjanohet vetëm me mospjesmarrjen e tij vetëm tek procedura e vlerësimit për subjektin e lidhur, por duhet të ndalohet edhe tek procedura e vlerësimit edhe për të gjithë subjektet e tjerë, që garojnë me subjektin e lidhur dhe janë konkurrentë mes tyre. Nga ana tjetër paditësja konstaton, se kërkesa e anëtares Memçaj, për të mos marrë pjesë në mbledhjen e datës 17.07.2020, në të cilën do të trajtoheshin çështjet për verifikimin dhe vlerësimin e kandidatëve, si dhe procedurat konkrete të shqyrtimit të kandidimeve, ka qenë për të gjithë kandidatët që kishin aplikuar për pozicionet vakante të paraqitura nga Kuvendi i Shqipërisë dhe jo e kufizuar vetëm tek procedurat e vlerësimit për kandidaten Ardita Buna. Ndërsa, vendimi nr.2, datë 17.07.2020 i Zëvendëskryetarit të Këshillit, rezulton të ketë miratuar heqjen dorë të anëtarit të Këshillit Memçaj, në mënyrë

APELIT
NË

të kufizuar vetëm për subjektin Ardita Buna, dhe jo për të gjithë kandidatët e tjerë në garë me të. Për këtë arsye, kufizimi i kryer në vendimin e Zv/Kryetarit vjen në kundërshtim të hapur me parashikimet e nenit 223 dhe 224 të Ligjit nr. 115/2016, duke mos e shmangur papajtueshmërinë e anëtarës së Këshillit znj. Memçaj edhe për kandidatët e tjerë që garojnë në këtë garë me subjektin A. Buna, për vendet vakante të shpallura dhe rishpallura nga Kuvendi i Shqipërisë. Po t'i referohesh parashikimeve konkrete të ligjit, papajtueshmëria e anëtarit në këtë proces, nuk fokusohet vetëm tek procedura e ndjekur vetëm për kandidatin me të cilin ke papajtueshmëri, por për të gjithë kandidatët që garojnë me të. Ky fakt është shprehur qartësisht si në nenin 223 në të cilin është pasqyruar se: "Anëtari i Këshillit të Emërimeve në Drejtësi nuk mund të marrë pjesë në verifikimin e kushteve ligjore, vlerësimin e kriterëve profesionale dhe në renditjen e kandidatëve për anëtarë të Gjykatës Kushtetuese ose të kandidatëve për Inspektor të Lartë të Drejtësisë...", ashtu edhe në nenin 224, në të cilin është pasqyruar se: "...Anëtari i Këshillit të Emërimeve në Drejtësi është i detyruar të heqë dorë nga pjesëmarrja në procesin për verifikimin e kushteve ligjore, vlerësimin e kriterëve profesionale dhe në renditjen e kandidatëve për anëtarë të Gjykatës Kushtetuese ose të kandidatëve për Inspektor të Lartë të Drejtësisë...".

Në analizë, të dispozitave të cituara si më sipër, rezulton qartësisht e provuar se ligjvënësi gjatë gjithë kohës, ka përdorur numrin shumë të fjalës "kandidat", pra termin "kandidatëve" dhe jo "kandidatit", duke konkluduar, që papajtueshmëria në të tilla procedime, nuk lidhet me vetëm kandidatin konkret me të cilin ke lidhjen e posaçme (papajtueshmërinë), por me të gjithë kandidatët e tjerë, që garojnë me këtë person, i cilësuar si i lidhur. Ky arsyetim, gjen mbështetje edhe në qëndrimin që ka mbajtur Kryetari i Këshillit në vendimin nr.1, datë 03.02.2020, me të cilin ka miratuar kërkesën e znj. Memçaj, duke e përjashtuar atë nga pjesëmarrja në diskutimin dhe miratimin e akteve nënligjore të Këshillit, për të njëjtin shkak ligjor. Nëse znj. Memçaj e kishte papajtueshmërinë vetëm në lidhje me kandidatin A. Buna, për cilin shkak, ajo duhet të përjashtohet nga mbledhjet dhe diskutimet e Këshillit që kishin karakter të përgjithshëm (normativ) dhe që nuk lidheshin drejtpërdrejtë me rastin konkret të vlerësimit të subjektit me të cilin kishte lidhje të posaçme.

Në fakt, përjashtimi nga pjesëmarrja në mbledhjen e datës 17.07.2020 të znj. Memçaj, nuk do të cenonte funksionalitetin e Këshillit, pasi në mbledhje do të merrnin pjesë 7 (shtatë) anëtarë nga 8 (tetë) që kanë marrë pjesë realisht, pra një numër mëse i mjaftueshëm për të formuar *kuorumin minimal të marrjes së vendimeve*. Gjithashtu, përjashtimi i anëtares Memçaj, në këtë procedurë, ndoshta nuk do të kishte cenuar as mënyrën e vendimmarrjes së Këshillit në lidhje me kandidaturën e paditëses, pasi shumica për ndalimin e kandidimit të saj sërish do të arrihej edhe pa votën e saj (në rastin konkret, anëtarja Memçaj, ka qenë pro, lejimit të kandidimit të paditëses), megjithatë procesi vendimmarrës me pjesëmarrjen e saj, ka cenuar rëndë procesin e rregullt ligjor për kandidatët e tjerë, që kanë qenë në garë me subjektin e lidhur me të

(znj.A Buna), në drejtim të gjykimit dhe vlerësimit nga një organ i paanshëm dhe i pacënueshëm në cilësitë dhe garancitë kushtetuese.

Sa më sipër vjen në përputhje të plotë edhe me qëndrimin konstant që ka mbajtur Gjykata Kushtetuese në vendimet e saj nr. 43, datë 04.06.1999; 48, datë 30.07.1999; nr. 21, datë 29.04.2010, nr. 49, datë 10.07.2015; nr. 70, datë 17.11.2015, në të cilat është konsoliduar qëndrimi se: *“Për Gjykatën është konsideruar gjykatë e njëanshme trupi gjykes, në përbërje të të cilit ka qenë i pranishëm qoftë edhe vetëm një gjyqtar i cili, në këndvështrimin objektiv, nuk jepte garanci për një gjykim të paanshëm. Gjykata ka theksuar se “...thjesht dhe vetëm pjesëmarrja e një apo më shumë gjyqtarëve në një procedim të mëparshëm, pavarësisht nga ndikimi i prezencës dhe i mendimit të tyre në të gjithë trupin gjykes, është një arsye e mjaftueshme dhe njëkohësisht një garanci më pak për kërkuesin, tek i cili është krijuar dyshimi i bazuar, se gjykata nuk ka qenë e paanshme në shqyrtimin e kësaj çështjeje”*. Bazuar në këto fakte, rrethana dhe argumentat ligjor përmendur edhe më lart, paditësja e konsideron procesin e vendimarrjes së Këshillit të datës 17.07.2020 për ankuesen, kandidate në garë me Znj. Ardita Buna për pozicionin e shpallur dhe rishpallur vakant nga Kuvendi i Shqipërisë, tërësisht të pavlefshëm në drejtim të garantimit të standardit kushtetues, për tu gjykuar dhe vlerësuar nga një organ, që garanton paanshmërinë qoftë edhe në dukje, pavarësisht faktit se prezenca e anëtarit të papajtuës në këtë gjykim, nuk ka ndikuar dhe nuk do të ndikonte në mënyrën e vendimarrjes. Megjithatë, deklarimi i pavlefshmërisë së vendimarrjes do t'i jepte mundësi Këshillit, që në fazën e rigjyimit, të rregullonte dhe plotësonte të gjitha shkeljet e rënda procedurale, që ka lejuar në shqyrtimin e kandidaturës sime, duke garantuar të gjitha standardet kushtetuese, për të pasur një proces të rregullt ligjor, të drejtë, transparent dhe të bazuar mbi meritë.

- ***Shkeljen e rregullave procedurale në thirrjen e mbledhjes së organit kolegjal, standardet që duhet të përmbushin aktet që i nënshtrohen vlerësimit dhe vendimarrjes së organit kolegjal, procedurat që ndjek organi kolegjal në diskutimin e çështjeve për të cilat është thirrur.***

Gjykata në shqyrtimin e drejtë të kësaj çështjeje, duhet të mbajë në vëmendje rregullat dhe parimet mbi bazën e të cilit, veprojnë organet kolegjinale, të cilat nuk mund të bien haptazi ndesh me rregullat specifike, që parashikojnë organet kolegjinale të caktuara, për shkak të veprimtarisë së tyre. Në çështjen objekt shqyrtimi, referuar respektimit të procesit të rregullt ligjor, duhet të merret në analizë dhe të vlerësohet e gjithë veprimtaria që ka kryer Këshilli nga momenti i fillimit të hetimit deri në momentin e marrjes së vendimit. Në këtë kuptim, gjykata, duhet të mbajë në konsideratë si dhe të vlerësojë se, në procesin e rregullt ligjor për vlerësimin e kandidaturës së paditëses nuk përfshihet vetëm zhvillimi formal i mbledhjes në ditën dhe orën e përcaktuar, por edhe veprimtaria dhe puna shqyrtuese paraprake, që ka kryer organi (përfaqësuar nga relatori i çështjes, anëtar me të drejtë vote në Këshill), si dhe hartimi apo draftimi i akteve që do t'i nënshtroheshin

vendimarrjes së tij (referojini nenit 228/5/c dhe 229/1 të Ligjit nr. 115/2016, i cili vetë referon tek ligji për organizimin e organeve kolegjiale).

Në momentin kur, dita e mbledhjes së Këshillit është njoftuar, së bashku me njoftimin për mbledhje, duhet të ishin njoftuar edhe projekt-vendimet përkatëse për shqyrtim në mbledhje, sikurse e parashikon neni 228, pika 5, gërma "c" e ligjit nr. 115/2016, si dhe në pikën 33, 34, 37 42, 44, 45, 46 të Vendimit nr. 4, datë 11.03.2020 të Këshillit, (i ndryshuar). Kjo nënkupton faktin se, relatori që ka bërë shqyrtimin paraprak të çështjes, ka studiuar të gjitha aktet e dosjes, ka kuptuar dhe ka evidentuar, se cilat janë çështjet që ai do të ngre në nivel diskutimi të veçantë në mbledhje, cilat janë pikat kryesore ku ai ka hasur paqartësi apo mangësi, si dhe propozimin konkret që ai ka bërë për zgjidhjen e çështjes. E gjithë kjo procedurë rezulton të mos jetë respektuar në çështjen objekt shqyrtimi. Relacioni i hartuar nga relatori për rastin konkret të paditëses, është përcjellë në adresën e-mailit të saj, pa asnjë të dhënë konkrete me anë të së cilës të identifikoheshin konkretisht problematikat që do t'i nënshtroheshin vendimarrjes, si dhe qëndrimi i propozuar nga relatori për zgjidhjen e çështjes objekt vlerësimi. Nëpërmjet këtij akti, nuk është identifikuar qartë roli që ka relatori i çështjes në këtë lloj proces verifikimi administrativ, i cili përveçse kryen shqyrtimin paraprak të çështjes, ai ka edhe rolin e oponencës, në momentin, që ja parashtron çështjen për vlerësim organit kolegjial (referojuni pikës 37 dhe 42 të Vendimit nr. 4, datë 11.03.2020 të Këshillit, (i ndryshuar)). Organi kolegjial thirret në mbledhje, vetëm pasi kanë përfunduar procedurat paragykimore të çështjes me qëllim marrjen e një vendimi për lejimin e kandidaturës apo ndalimin e saj.

Në këtë kuptim, thirrja e organit kolegjial për të marrë vendim në lidhje me një çështje të caktuar, nënkupton nga pikëpamja procedurale se relatori ka përfunduar procedurat paraprake të vlerësimit të çështjes, ka kryer hetim të plotë, të thelluar dhe të kryqëzuar të saj, ka evidentuar dhe ka parashtruar para anëtarëve të Këshillit të gjitha gjetjet e kryera prej tij, ka argumentuar se përse këto gjetje në kuptim të ligjit dhe të procedurës, duhet të diskutohen dhe të vlerësohen në mbledhje, si dhe ka propozuar konkretisht, qëndrimin e tij mbi zgjidhjen e çështjes. Për këtë arsye, sipas parashikimeve të pikës 43 të vendimit të sipërcituar, relatori është anëtar i parë, që voton në vendimarrjen e Këshillit, duke u ndjekur nga kryetari e me radhë të gjithë anëtarët.

Në vendimarrjen e organeve kolegjiale apo i trupave gjykues me shumë anëtarë, roli procedural që ka relatori i çështjes nuk është një rol thjesht formal, me qëllim përcjelljen e informacionit që parashikojnë aktet shkresore të administruara gjatë hetimit tek anëtarët e tjerë të këshillit, por është një garanci procedurale dhe ligjore, që hetimi administrativ është kryer në mënyrë të plotë dhe të gjithanshme, si dhe është garantuar respektimi i parimeve bazë të së drejtës për tu dëgjuar, të drejtës për tu mbrojtur, të drejtës për të pasur barazi armësh mbrojtjeje dhe bazë diskutimi mbi parimin e kontradiktoritetit. Në çështjen objekt shqyrtimi, rezulton e provuar, se relatori i ka i paraqitur Këshillit një relacion pa evidentuar qartësisht, se cilat janë gjetjet në këtë procedim dhe çfarë

problematikash pasqyrojnë ato, cili është qëndrimi apo opinionimi i tij ligjor në lidhje me këto gjetje, si dhe kush është propozimi konkret për zgjidhjen e çështjes. Mungesa e të gjithë këtyre elementëve në relacionin e parashtruar për vlerësim para organit kolegjal, e bën vendimarrjen e Këshillit në lidhje me vlerësimin e çështjeve paragjykimore për lejimin apo ndalimin e kandidatit për të vazhduar garën të pavlefshëm, përse i përket procedurës së ndjekur për vlerësimin e saj.

Përmbajtja e relacionit që i është propozuar Këshillit për diskutim, provon qartësisht faktin se, relatori i çështjes: (i) nuk ka qenë aspak i qartë në lidhje me rezultatet e kontrollit; (ii) nuk ka arritur të krijojë një bindje të tij në lidhje me zgjidhjen e çështjes; (iii) nuk ka kryer një hetim të plotë dhe të gjithanshëm, fakte të cilat kanë ndikuar dukshëm, se ka qenë në pamundësi për të arritur në konkluzione të qarta; (iv) t'i bëjë çështjes një vlerësim paraprak, sikurse ligji ja ka imponuar. Nëse nga ana e relatorit është vlerësuar i parëndësishëm pasqyrimi i konkluzioneve përfundimtare të hetimit, si dhe propozimi për zgjidhjen e saj, ky mosveprim i tij, ndikon tërësisht dhe thelbësisht në rezultatet e vendimmarrjes, pasi tregon haptazi se për mua paditësen – ankuese, nuk ka pasur fare procedurë paraprake vlerësimi. Për me tepër që ka rezultuar e provuar, siku ndër është cituar edhe në më sipër në këtë vendim (paragrafët 32, 33, 34, 35,) që në relacion nuk janë pasqyruar të gjitha të dhënat që kanë rezultuar nga hetimi, “gjetjet” e marra në shqyrtim nga Këshili janë të ndryshme nga “gjetjet”, që i janë komunikuar dhe për të cilët paditësja – ankuesja, ka dhënë sqarime shtesë.

Jo pa qëllim, ligji dhe aktet nënligjore të dala në bazë dhe për zbatim të tij, kanë parashikuar në mënyrë të qartë dhe të saktë se, veprimet paraprake hetimore, si dhe vlerësimi i përmbushjes së kriterëve ligjore si çështje paragjykimore, që duhet të shqyrtohen nga Këshilli, kryhen dhe mbikqyren nga gjyqtari/anëtari relator, i cili nuk përfqëson vetëm veten e tij si anëtar i organit kolegjal, por të gjithë organin kolegjal apo trupën gjyquese të ngarkuar për shqyrtimin e një çështje të caktuar. Nëse procedurat e ndjekura dhe të vlerësuara nga relatori, do të ishin kaq të parëndësishme dhe kaq të pavlera, përse ligji do të parashikonte në mënyrë të shprehur garantimin e përzgjedhjes me short të relatorit të çështjes, si dhe do detyronte organin procedues që të njoftonte paraprakisht, të gjitha aktet, që do t'i nënshtrohen për vlerësim organit kolegjal në mbledhje, e cila kryhet në dhomë këshillimi.

Në rastin objekt shqyrtimi, rezulton tërësisht e provuar, se relatori nuk ka pasur asnjë qëndrim konkret në lidhje me zgjidhjen e çështjes, nuk ka pasqyrim të rezultateve konkrete të hetimit në këtë drejtim, në mënyrë, që gjetjet të imponojnë vendimarrjen sipas projekt-vendimit. Në këtë kuptim, relatori e ka deleguar vlerësimin paraprak të çështjes tek mbledhja e Këshillit, megjithëse është ai organi paraprak, që propozon projekt-aktin së bashku me relacionin përkatës, si pjesë e pandarë e tij. Në këtë drejtim, nuk arrihet të kuptohet, se për cilin qëllim relatori i çështjes i ka komunikuar palës së interesuar 4 ditë, para zhvillimit të mbledhjes, një relacion, i cili nuk i bën me dije kësaj pale asnjë lloj përfundimi të hetimit administrativ apo propozimi konkret për zgjidhjen e

SHKËMBELIT
LINE

çështjes. Njoftimi i këtij relacioni, pa pasur në brendësi të tij rezultatet përfundimtare të hetimit, si dhe propozimin konkret për zgjidhjen e saj para këshillit, nuk ka arritur qëllimin procedural për të cilin, ligji e ka ngarkuar organin që të bëjë njoftimin e tij. Për më tepër që “gjetjet” e marra në shqyrtim në mbledhjen e datës 17.07.2020, rezultojnë të mos i jenë komunikuar ankueses, duke lejuar Këshilin që të marrë një vendim në kundërshtim të hapur me parashikimet e një dispozite urdhëruese, sikundër është pika 48 e vendimit nr. 4, datë 11.03.2019, (i ndryshuar).

Në një organ kolegjal është e vërtetë, që votimi është individual edhe secili anëtar voton sipas bindjes dhe qëndrimit të tij personal, të formësuar nga faktet, dokumentet, relacioni dhe projekt-vendimi, i cili, ka një propozim konkret. Kryerja e vlerësimit paraprak të çështjes, si dhe hartimi i relacionit përkatës me të cilin, relatori prezanton para këshillit apo trupës gjyqese qëndrimin e tij personal, i cili duhet të vlerësohet dhe shqyrtohet më tej nga organi kompetent, i jep procesit vlerë nga pikëpamja procedurale për secilin aktor dhe faktor, si dhe garanton shqyrtimin e saj në disa faza, me qëllim parandalimin e gabimeve në procedim të cilat mund të afektojnë vendimmarrjen përfundimtare. Dhënia e rezultateve konkrete, si dhe propozimi për zgjidhjen e çështjes, nuk e bën procesin ligjor të vlerësimit, defektoz dhe as nuk krijon paragjykim të panevojshme, për sa kohë vendimarrja do të realizohet pas relatimit dhe debatit në ditën e mbledhjes. Nëse anëtarët e Këshillit e marrin vendimin aty për aty vetëm, duke ju referuar debateve të anëtarëve të tij, në ditën e mbledhjes, atëherë është i panevojshëm edhe hartimi i akteve procedurale përpara thirrjes së mbledhjes dhe vendosjes së tyre në dispozicion të anëtarëve të tjerë brenda afateve ligjore, të arsyeshme dhe të përcaktuara.

Në rastin objekt shqyrtimi, arrihet në përfundimin, se Këshilli ka dështuar, që të sigurojë një procedurë normale dhe transparente për vlerësimin real të kandidaturës sime, duke refuzuar që të marrë në shqyrtim dhe vlerësim parashtrimet, që paditësja ka paraqitur gjatë procesit të verifikimit paraprak, si dhe ka fokusuar shqyrtimin dhe vlerësimin e kandidaturës së saj, në drejtim të çështjeve të cilat, as i janë njoftuar në relacionin paraprak, të paraqitur për shqyrtim në mbledhjen e datës 17.07.2020, si dhe as i janë bërë më dije gjatë fazës paraprake të veprimeve hetimore për vlerësimin e kriterëve të tjera ligjore (kryesisht ato që kanë të bëjnë ne vjetërsinë në punës). Gjithashtu, edhe relatori i çështjes, ka dështuar që të bëjë një vlerësim paraprak të të gjitha provave dhe fakteve që kanë rezultuar nga hetimi, vlerësimin e parashtrimeve të saj në lidhje me sqarimet e kërkuara, si dhe të evidentojë saktësisht, se cilat ishin rezultatet përfundimtare të hetimit, si dhe propozimin për zgjidhjen konkrete të çështjes.

Për këtë arsye, kjo procedurë ligjore e ndjekur për vlerësimin e kandidaturës së paditëses, ka cenuar rëndë standardet e gjykimit, duke ndikuar qartësisht edhe në vendimarrjen e Këshillit. Nëse, nga ana e Këshillit, do të ishte respektuar me përpikmëri dhe me rigorozitet procedura e shqyrtimit paraprak të çështjes, ky i fundit, nuk do të kishte vështirësi për të kuptuar natyrën e qëndrimeve ndryshe të parashtruara nga kërkuesja. Nëse, relatori i çështjes do të kishte të zbërthyer dhe të mirëstudiuar të gjitha faktet,

rrethanat dhe rezultatet konkrete të hetimit, si dhe do të kishte kryer një hetim të plotë dhe të gjithanshëm të rastit të udhëhequr prej tij përpara se të vinte dita e mbledhjes. Këshilli nuk do të kishte mundësi të vlerësonte një çështje {"gjetje"} tjetër, për të cilën, nuk ia kishte bërë me dije paditëses, si dhe të refuzonte të merrte në analizë e vlerësim çështje për të cilat, paditësja ankuese kishte mundur të jepja shpjegimet e saj.

Jo pa qëllim në procedurat e vendimmarrjes së organeve kolegjiale apo trupave gjyquese, procesi i vlerësimit paraprak të çështjes ka një rëndësi të madhe dhe është kusht thelbësor për vlefshmërinë e vendimmarrjes. Pra, përmbajtja e akteve të tilla si relacion, projekt-vendim, apo parashtrime, kanë rëndësi substanciale për vendimarrjen e organit kolegjial, pasi vetëm nëse këto akte pasqyrojnë me imtësi të dhëna, fakte, rezultate konkrete dhe argumente shterues, në lidhje me zgjidhjen e çështjes, organi kolegjial, bën praktikisht efektiv dhe të mundshëm nënshkrimin e vendimit ditën që është përcaktuar mbledhja (referojuni parashikimeve të pikës 45 të Vendimit nr. 4, datë 11.03.2020). Në rast se ky rregull i drejtë procedural nuk respektohet, atëherë vështirësohet dhe pamundësohet zbardhja dhe nënshkrimi i vendimit përkatës për çështjen konkrete, duke kërkuar dhe shtuar kohë tjetër, për arsyetimin e vendimit, pas datës së mbledhjes (referojuni pikës 46 të Vendimit nr. 4, datë 11.03.2020, i ndryshuar).

Qëllimi dhe fryma e ligjit në përgatitjen e draft akteve paraprake si relacion, projekt-vendim etj., me elementë të plotë dhe shterues, ka si qëllim që të minimizojë mundësinë që organi kolegjial të marrë vendimin pa shqyrtuar në parë në themel faktet dhe rrethanat e çështjes, pretendimet e palëve, rezultatet e verifikimit etj. Nëse një organ kolegjial ose trupë gjyquese merr vendimin pa provuar më parë, se ka qenë në dijeni të gjitha fakteve, rrethanave, pretendimeve, prapësimeve, rezultateve konkrete të hetimit, si dhe propozimit konkret të zgjidhjes së çështjes, do të thotë që ky vendim është i pavlefshëm. Në rastin konkret, rezulton e provuar, se Këshilli ka shkelur parimin themelor mbi marrjen e vendimit, për sa kohë nëpërmjet materialeve, të cilat kanë shoqëruar njoftimin për ditën dhe orën e mbledhjes, nuk rezulton të jetë paraqitur projekt-vendimi përkatës, i shoqëruar nga relacioni, i cili duhet të kishte në përmbajtje të tij të gjitha faktet dhe rrethanat e evidentuara gjatë procedurës hetimore paraprake, rezultatet konkrete të hetimit në drejtim të kriterit të vjetërsisë në punë dhe aftësisë profesionale, si dhe qëndrimin apo propozimin konkret për zgjidhjen e çështjes.

Evidencat që mbahen gjatë diskutimit, janë çështje, të cilat kur janë evidentuar nga anëtarët gjatë mbledhjes, pasqyrohen në vendim kur është rasti, por gjithsesi, koha brenda së cilës ndodh zbardhja e tyre, nuk mund të jetë, si parim, më e gjatë se koha, që i vihet në dispozicion me ligj kandidatit, për të shprehur me shkrim ankimin e tij ndaj vendimit të Këshillit. Për këtë arsye, në pikën 46 të Vendimit nr. 4, datë 11.03.2020, i ndryshuar, është pasqyruar qartësisht se: "*Nëse për shkak të natyrës së çështjes, arsyetimi i vendimit kërkon kohë, Këshilli mund të shpallë vetëm dispozitivin e vendimit, duke e dorëzuar atë të arsyetuar në sekretari, jo më vonë se 3 ditë nga ajo e shpalljes*". Në këtë kuptim, veprimtaria hetimore dhe vlerësuese, që bën relatori i çështjes, në ushtrim të veprimtarisë

së tij gjykuese nuk lidhet me kohën fizike të zhvillimit të mbledhjes, së thirrur zyrtarisht ditën që ajo mbahet, apo dhe me kohën që i duhet për të zbardhur vendimin, por me të gjitha veprimet dhe analizën ligjore, që ai i ka bërë çështjes, përpara se ti propozohet organit kolegjal apo trupës gjykuese, për vendimmarrje.

Për këtë arsye, ligji parashikon rregulla të qarta dhe afate prekluzive për njoftimin paraprak të mbledhjes me shkresë, si dhe bashkëlidhur saj edhe të gjithë materialet që shoqërojnë projekt-vendimin e propozuar. Ky rregull i njoftimit paraprak me një afat paraprak të mirë përcaktuar, vendoset jo vetëm që anëtarët e organit kolegjal të kenë mundësi të njihen me datën dhe orën e gjykimit, por edhe të kenë mundësi të njihen me materialet e nevojshme, me çështjet që do të diskutojnë dhe me propozimin e sugjeruar nga anëtari relator, si dhe çështjet që ky i fundit i ka kërkuar ti sqarojë kandidatit në garë. Në këtë kuptim, ligja ka dhënë zgjidhjen e barazpeshuar e të arsyeshme procedurale, për tu dhënë mundësi reale anëtarëve, që do të gjykojnë dhe vendosin mbi çështjen për të cilën janë thirrur, të kenë gjithë informacionin e nevojshëm. Por nga ana tjetër edhe kandidati, si palë e interesuar, pa pjesëmarrje fizike në mbledhje, duhet të jetë në dijeni se si organi kolegjal dhe anëtari i këtij organi, relator i çështjes, i ka ofruar garancitë kushtetuese, që e ka studiuar paraprakisht dosjen e tij, dhe është përgatitur për çështjet, që do duhet të diskutojë dhe debatojë me anëtarët e tjerë në ditën e gjykimit, për lejimin e kandidatit apo ndalimin e tij.

Nuk rezulton që në vendimin objekt kundërshtimi, të jenë evidentuar, se cilat janë veprimet konkrete që ka kryer relatori çështjes për shqyrtimin paraprak të saj, në mënyrë që të konkludohet, se sa vështirësi ka pasur ai, që në njoftimin për mbledhje nuk ka bashkëlidhur një relacion me një qëndrim konkret, të bashkëshoqëruar me projekt-aktin që mbështet sugjerimin e tij, si relator. Për më tepër, që në relacionin e paraqitur për vlerësim në mbledhje, nuk janë evidentuar fakte dhe rrethana konkrete konkrete, të cilat po të ishin hetuar, studiuar dhe vlerësuar nga ana e relatorit të çështjes, si dhe të ishin pasqyruar qartësisht, rezultatet e hetimit në drejtim të kriterit tim për vjetërsinë në punë dhe atë profesionale (*referoju paragrafëve 32, 33, 34, 35 të këtij ankimi*), Këshilli nuk do të kishte arritur të merrte vendimet që ka marrë, të cilat dukshëm janë në kundërshtim me qëndrimin, që po ky Këshill ka mbajtur për subjektet e tjerë në këtë garë (*referoju vendimit nr.16, datë 17.07.2020 të subjektit Shaqir Hasani, apo vendimit nr.19, datë 17.07.2020 të subjektit Vasil Bendo etj*)

Për sa më sipër, veprimet e kryera nga relatori i çështjes, vijnë në shkelje të rëndë të frymës së ligjit, pasi rezulton e provuar se ai ose e ka paragjykuar çështjen, ose ai nuk ka kryer një studim të thelluar të saj, në mënyrë që të paktën ai vetë të kishte të qartë zgjidhjen e saj. Ky fakt konfirmohet lehtësisht nga përmbajtja e relacionit të hartuar, mungesa e projekt-aktit të arsyetuar e propozuar, fakt që passjell edhe zbardhjen e vendimeve me 13 ditë pas marrjes së tij, pra një kohë më shumë se dyfishi i afatit ligjor që ligjvënësi, ju ka njohur subjekteve të interesuar për të ankimuar vendimin, i cili merret

në dhomë këshillimi, si dhe në kundërshtim flagrant me afatin e përcaktuar në pikën 46 të Vendimit nr. 4, datë 11.03.2020, (i ndryshuar).

Përveç pavarësisë në gjykim, një rol shumë të rëndësishëm në kryerjen dhe ndjekjen e procedurës së verifikimit të kandidatëve për anëtarë të Gjykatës Kushtetuese, luan edhe përgjegjshmëria në ushtrimin e detyrës. Në këtë kuptim, me përgjegjshmëri të relatorit dhe anëtarit të Këshillit, kuptohet vlerësimi i aftësisë dhe sjelljes së tij në administrimin e procesit të vlerësimit të kandidatit për anëtar të Gjykatës Kushtetuese dhe mënyrës se si ai udhëheq gjykimin në pozicionin e relatorit apo anëtarit të Këshillit. Veprimtaria e anëtarit të Këshillit, në kryerje të detyrës së tij për të gjykuar çështjen, që i është paraqitur, sidomos në rolin e relatorit, nuk duhet të perceptohet thjesht si një *shërbim* për Këshillin në kuptimin e parë e të thjeshtë të kësaj fjale. Nën këtë cilësi, rezulton tërësisht e provuar se relatori i çështjes, nuk ka mundur që t'i garantojë paditëses-ankuese, shqyrtimin dhe vlerësimin e çështjes në pëputhje me parashikimet ligjore për një proces të rregullt ligjor, në mënyrë të drejtë, të barabartë dhe në përputhje me të gjitha garancie, që nje ligji, për tu dëgjuar dhe për tu mbrojtur në këtë gjykim. Duke analizuar mënyrën, si më sipër ka vepruar Këshilli, lehtësisht kuptohet se as në formë, por as dhe në substancë ky organ kolegjal, nuk ka realizuar standardin e realizimit të një procesi të rregullt e transparent, sipas rregullave të mirë përcaktuara procedurale, për të pasur vendime të drejta dhe pa cenuar afatet ligjore të përcaktuara.

➤ ***E drejta për tu dëgjuar dhe për tu mbrojtur***

Referuar akteve procedurale bashkëlidhur këtij ankimi, nuk rezulton që sqarimet e dhëna nga ana e paditëses të jenë analizuar dhe vlerësuar paraprakisht në relacionin e shqyrtimit, si dhe nuk rezulton të jenë evidentuar, se në cilat pika relatori i çështjes nuk është dakortësuar me to, në mënyrë, që paditësja të kishte mundësi për tu mbrojtur përpara se Këshilli të merrte një vendim. Për këtë arsye, edhe pse i është dhënë mundësia që të paraqes parashtrime, nuk rezulton që ato të jenë lexuar apo të jenë dëgjuar nga organi procedues, duke refuzuar qartësisht në vendimin e zbardhur që të merren në vlerësim.

Referuar përmbajtjes së vendimeve objekt shqyrtimi, konstatohet qartësisht se, në mbledhjen e datës 17.07.2020, Këshilli ka marrë në shqyrtim çështje, të cilat asnjëherë, nuk i janë bërë me dije, si dhe ka refuzuar që të marrë në vlerësim çështjet, që i janë adresuar në e-mail të datës 12-11-2019, si shpjegim në lidhje me “gjetjet” e vlerësimit paraprak. Në këtë mënyrë, ankueses i është mohuar e drejta, për të dhënë shpjegime në lidhje me çështjen objekt vlerësimi, nuk i është garantuar e drejta për tu dëgjuar dhe mbrojtur, përpara se Këshilli të merrte vendimet, objekt kundërshtimi. Vendimet objekt kundërshtimi, rezultojnë të jenë marrë në kundërshtim të hapur me parashikimet e pikës 48 të vendimit nr. 4, datë 11.03.2019, (i ndryshuar), duke evidentuar në këtë mënyrë, shkelje të rënda procedurale nga ana e Këshillit të cilat, kanë ndikuar në rezultatin e vendimarrjes.

EMANUELO
KUNDËR
ITALISË

Këshilli, edhe pse prezumohet se i ka marrë të mirëqëna pretendimet e paditëses në lidhje me detyrat dhe fushat që ka mbuluar (*për sa kohë nuk rezulton t'i ketë kundërshtuar ato*), ka refuzuar që t'i marrë në analizë të thelluar në kundërshtim me sa parashikon kushtetuta dhe ligji, duke konkluduar apriori, se eksperiencat e punës, nuk mund të merren në shqyrtim, për sa kohë ushtrimi i veprimtarisë profesionale në sektorin privat, nuk përfshihet brenda veprimtarisë që parashikon neni 7/a i Ligjit 8577, datë 10.02.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese", (i ndryshuar). Në këtë këndvështrim, procesi i hetimit, vlerësimit, kontrollit dhe kryqëzimit të të dhënave të mbledhura, për të pasur një vendimmarrje thellësisht dhe thelbësisht të mbështetur në fakte, rrethana dhe prova, sipas një procedure dhe standardi të mirërregulluar ligjor, rezulton të ketë munguar, në çështjen objekt shqyrtimi, gjë e cila e bën vendimmarrjen e Këshillit tërësisht të pavlefshme, të paragjykuar dhe aspak objektive.

Referuar akteve shkresore, mbi bazën e të cilit mbështetet ky ankim, rezulton tërësisht e provuar se Këshilli nuk i ka garantuar zbatimin e primeve të një procesi të rregullt ligjor. me të drejtë lind pyetja se a mund të konsiderohet se ankuesja është njoftuar korrektësisht sipas ligjit, në kushtet kur nuk i është bërë e qartë se: (i) cilat kanë qenë faktet dhe rrethanat që ka evidentuar, hetuar dhe pranuar Këshilli në lidhje me përcaktimin e kriterëve të vjetërsisë sime në punë dhe përvojës profesionale; (ii) cilat kanë qenë rezultatet konkrete dhe përfundimtare të këtij hetimi në lidhje me këtë çështje; (iii) cili ka qenë vlerësimi paraprak, që i ka bërë relatori këtyre fakteve, rrethanave, rezultateve konkrete të hetimit; si dhe (iv) qëndrimi që do të mbajë relatori i çështjes në prezantimin dhe oponencën, që do t'i bëjë para Këshillit çështjes së saj. Relacioni i hartuar dhe i propozuar nga ana e relatorit të çështjes, nuk mbart asnjë qëndrim konkret mohues apo pranues në lidhje me aplikimin tim, duke mos përmbushur standardin, që kërkon ligji, që të ketë ky akt.

Nuk rezulton që ky akt, të ketë të pasqyruar propozimin e zgjidhjes së çështjes, i cili duhet të materializohet në projekt-vendimin që i paraqitet Këshillit për vendimmarrje. Asnjë doktrinë shkencore ligjore dhe asnjë disiplinë që rregullon proceduralisht mbledhjet e njoftuara të një organi kolegjal, nuk mund të mbështesë jo vetëm formalisht, por as thelbësisht veprimet procedurale të ndjekura nga relatori i çështjes dhe më tej Këshilli, për vlerësimin e kandidaturës së ankueses. Në kushtet kur Këshilli ka qenë në dijeni rreth përmbajtjes së relacionit, që i është përcjellë ankueses, lind pyetja se në cilën formë ky Këshill ka vlerësuar dhe ka marrë në konsideratë faktin, se ankuesja është njoftuar në lidhje me rezultatet e hetimit, në çfarë mënyre dhe forme ky Këshill, ka garantuar se relacioni i përcjellë për vlerësim nga relatori, ka marrë në shqyrtim e vlerësim pretendimet e pasqyruara nga ankuesja, si dhe ka transpozuar të drejtën e saj për t'u dëgjuar dhe mbrojtur substancialisht, (*shih vendimet nr. 5, datë 17.02.2003 dhe nr. 33, datë 24.11.2003 të Gjykatës Kushtetuese*) në çfarë mënyre ky Këshill, ka garantuar pasjen e një procesi ligjor që respekton dhe garanton barazinë e armëve dhe kontradiktoritetin (*shih vendimet e GJEDNJ-së në çështjet Emmanuello kundër Italisë; Vidal kundër*

Belgjikës; Caka kundër Shqipërisë, datë 08.03. 2010). Vetëm pasqyrimi, i një pjese të komunikimit të saj realizuar me e-mail, sipas kërkesës së relatorit në relacion, nuk vërteton aspak, se në këtë proces është zbatuar dhe është garantuar e drejta e ankueses për t'u dëgjuar dhe për t'u mbrojtur. Nga përmbajtja e relacionit, në asnjë pjesë të tij nuk del se në çfarë mënyre dhe me çfarë analize ligjore, janë pranuar apo rrëzuar argumentat e saj,, si kanë ndikuar ato në lidhje me vijimësinë e hetimit apo vlerësimin; sa kohë e çmoi të nevojshme dhe të domosdoshme relatori i çështjes, për të kërkuar sqarime shtesë me shkrim ose prova të tjera, në mënyrë që ankuesja të paktën të jetë lexuar formalisht gjatë procedurës paragjykimore.

Mungesa tërësisht e vlerësimit nga vetë relatori në shuarjen e dyshimeve apo shtesën e dyshimeve të bazuara, transmetuar me pyetjen e adresuar, krijojnë bindjen, se paditësja nuk është dëgjuar në këtë procedurë vlerësimi, e aq më pak janë vlerësuar apo peshuar nga pikëpamja ligjore argumentet e dhënë prej saj, si dhe janë verifikuar apo ekzaminuar provat shoqëruese të tyre. Në mënyrë të përmbledhur, përsëritja e këtyre fakteve në një akt të quajtur relacion, nuk plotëson standardin kushtetues dhe ligjor, që kërkon një procedurë e tillë hetimi administrativ e vlerësimi, që ankuesja të jetë garantuar, se është dëgjuar nga organi procedues në këtë procedurë vlerësimi. Në mënyrën, se si është ndërtuar dhe hartuar relacioni i njoftuar, derisa nuk ka asnjë rezervë të shfaqur me një qëndrim të qartë, me deduktim perceptohet, që rezervat e relatorit tashmë nuk ekzistojnë.

Për më tepër, që po t'i referohesh paragrafit 59 të vendimit nr. 17, datë 17.07.2020 dhe paragrafit 60 të vendimit nr. 18, datë 17.07.2020, Këshilli jo vetëm që ka refuzuar të marrë në analizë pretendimet e dhëna nga kërkuuesja, por ai ka kryer edhe një vlerësim të gabuar të fakteve dhe rrethanave të çështjes, duke konkluduar se paditësja nuk e ka ushtruar aktivisht profesionin e avokatit të paktën për 10 vite, që ka ushtruar aktivitet në sektorin privat.

Nuk rezulton, që Këshilli të ketë hetuar dhe të ketë evidentuar faktin, se ankuesja e ka ushtruar edhe me status fiskal aktiv, profesionin e avokatit që nga Korriku i vitit 2012, periudhë për të cilën ka paguar edhe detyrimet tatimore. Këshilli, as nuk ka hetuar dhe as nuk ka vlerësuar faktin, se arsyeja për të cilën, paditësja është rekrutuar në punë pranë shoqërisë SiCRED sh.a., ka qenë fakti që ajo gëzonte licencën e avokatit dhe detyra funksionale e saj pranë kësaj shoqërie ka qenë konsulenca juridike e shoqërisë, si dhe mbrojta e saj tek të tretët, duke përfshirë ndjekur dhe këshilluar procedurat konkrete pranë administratës publike, procedurat gjyqësore ku shoqëria ka qenë palë, ndjekjen e procedurave konkrete tregtare dhe financiare të këtij subjekti me persona të tjerë tregtarë dhe ekonomikë. Pra, qartësisht veprimtaria e saj pranë shoqërisë SiCRED sh.a., në të gjitha pozicionet dhe funksionet që ka mbajtur, ka qenë e barazuar dhe ekuivalentuar me ushtrimin faktik të profesionit të "Avokatit", të cilat nuk do të kishte mundur t'i kryente, nëse nuk do të ishte e licencuar sipas ligjit. Ky ka qenë edhe fakti se përse paditësja këtë cilësi, ka mundur të avancojë në karrierë dhe të jetë subjekt, që administron, mbikëqyr dhe kontrollon veprimtarinë ligjore të tre subjekteve juridike të pavarura, ku njëra prej të

cilave ka specifikisht, si objekt të veprimtarisë së saj këshillimin ligjor, e në fokus më specifik çështjet e punës, ndërmjetësimit në punësim dhe në shërbime mjekësore, dhe ka që prej krijimit Administrator të vetëm paditësen ankuese në këtë proces. Ndërkohë, që dy subjektet e tjera juridike aty, ku ankuesja në këtë proces mban pozicionin e Drejtorit Juridik (subjekti SICRED sh.a. shoqëri sigurimi jete) dhe subjekti tjetër (Credins Invest sh.a. shoqëri administrimi fondesh pensioni privat dhe investimi), ku mban pozicionin e Kryetarit të Këshillit të Administrimit, që prej transformimit në formën që ka sot prej Nëntorit të vitit 2011, duke i dhënë mundësinë të shpërfaq e të kryej publikisht e në mënyrë të matshme, të dallueshme, e të vlerësueshme punën e juristit edhe avokatit edhe përpara gjykatës për secilin subjekt të sipërcituar, e gjithashtu i kanë dhënë mundësinë të jetë e të kryej edhe detyrën e juristit dhe avokatit edhe nga zyra me aktet publike të ndërtuara që mbajnë firmën e e të cilat janë unike për nga lloji i tyre në të gjithë Republikën e Shqipërisë.

Në këtë kuptim, mungesa e hetimit të drejtë dhe të plotë të kandidaturës nga ana e relatorit të çështjes, si dhe vullnetit të Këshillit për t'i konstatuar këto mangësi të hetimit, si dhe për të mundësuar korrektimin e tyre, ka sjellë paragjykimin e kandidaturës së paditëses, duke u marrë vendimi i ndalimit të kandidaturës, edhe pse Këshilli nuk ka mundur dot, që të evidentojë në mënyrë të saktë dhe të plotë të paktën faktet dhe rrethanat, që duhet t'i ishin nënshtruar procedurës së vlerësimit paraprak. Për këtë arsye edhe arsyetimi i shumicës për ndalimin e kandidimit të saj është reduktuar vetëm në dy fjali të cilat kanë konsistuar në: 1) vitet më të shumta të punës ankuesja i ka pasur në veprimtarinë e ushtruar në Sektorin privat, i cili nuk përfshihet në veprimtarinë e parashikuar nga neni 7/a të Ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese", i ndryshuar; 2) edhe pse ankuesja është licencuar si "Avokate" në vitin 2002, nuk rezulton ta ketë ushtruar profesionin e avokatit për 15 vjet, sikundër e parashikon neni 125, pika 4 e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

Bazuar sa më sipër, paditësja i kërkon Gjykatës së Apelit Administrativ, që të konstatojë shkeljet e kryera nga Këshilli, shkelje të cilat kanë cenuar rëndë procesin e rregullt ligjor dhe i kanë cenuar të drejtën për tu dëgjuar, për tu mbrojtur, për tu trajtuar në mënyrë të barabartë dhe të drejtë nga një organ kushtetues. Në rast se do t'i ishte dhënë mundësia për tu dëgjuar dhe mbrojtur përpara Këshillit, edhe rezultati i vendimmarrjes, mund të ishte krejtësisht i ndryshëm nga ai marrë, gjithmonë nëse kjo çështje nuk ka qenë e paragjykuar nga shumica e anëtarëve të Këshillit.

➤ ***Procesi i hetimit administrativ të ndjekur nga këshilli, i marrjes së vendimit dhe i zbardhjes së tij, është i paragjykuar dhe në shkelje të afateve ligjore të përcaktuara***

Cenimi i procedurës renditur, si më sipër, si dhe ndalimi i të drejtës së ankueses për të vijuar garën, konfirmon faktin se Këshilli, ka paragjykuar kandidaturën e paditëses, duke mbajtur formalisht në këmbë një proces hetimor administrativ, tej çdo afati të arsyeshëm. Rezulton tërësisht e konfirmuar, se veprimi i fundit procedural, që i është bërë kandidaturës së paditëses ka qenë data 12.11.2019, kohë në të cilën aplikantja ka

plotësuar parashtrësën me shkrim pranë Këshillit, sipas kërkesës së këtij të fundit. Pas kësaj date, nuk rezulton që Këshilli të ketë kryer më ndonjë veprim procedural deri në datën 13.07.2020, kohë në të cilën i është përcjellë relacionin përfundimtar, i cili do të shqyrtohej nga Këshilli, në mbledhjen e datës 17.07.2020. Nëse Këshilli e ka pasur të qartë, që aplikuesja nuk plotësonte kriteret formale për kandidim, edhe pasi kishte dhënë shpjegime shtesë, në lidhje me këtë pretendim, për cilin shkak dhe rrethanë, Këshilli e ka mbajtur të hapur procedurën e shqyrtimit administrativ, për një periudhë prej rreth 9 muaj, pas dhënies së këtyre sqarimeve. Për çfarë shkak ligjor, përveç paragjykimit, mund të mbahet hapur një procedurë hetimore në vlerësimin e kriterëve paraprake ligjore të kandidatit, që kanë të bëjnë me vjetërsinë në punë, kur veprimet hetimore në drejtim të verifikimit të këtij kriteri janë përmbyllur brenda 3 muajve nga dorëzimi i kërkesës. Pra lind pyetja se në çfarë drejtimi, mund të justifikohen veprimet e relatorit të çështjes, i cili i ka propozuar një akt paraprak mbledhjes së këshillit, relacion që nuk përmban asnjë të dhënë thelbësore në lidhje me procedurën hetimore gati një-vjeçare të kryer në drejtim të vlerësimit të kriterit të vjetërsisë në punë, si dhe nuk rezulton të ketë hartuar apo draftuar një projekt-vendim, me të cilin është propozuar zgjidhja konkrete e çështjes. Në këtë kuptim, vetëm formalizimi i solemnitetit të mbledhjes, pa pasur në themel të saj vlerësimin e kërkesës së kandidatës, si dhe argumentimin nëse kjo kandidatë i plotësonte ose jo kriteret ligjore në drejtim të vjetërsisë në punë dhe të qënurit "*jurist i spikatur*" e bën të gjithë këtë procedurë të pavlefshme dhe haptazi të paragjykuar. Tejkalimi i çdo lloj afati të arsyeshëm në vlerësimin e çështjeve paragjykimore, do të ishte e justifikuar vetëm nëse do të kishim në ditën e njoftimit për mbledhje të Këshillit, një projekt-vendim të arsyetuar dhe relacionin bashkëshoqërues të tij, tek i cili do të evidentohej një analizë e thellë dhe e gjithanshme e çështjes, si dhe një qëndrim konkret, i propozuar për zgjidhjen e çështjes, tërësisht i mbështetur në ligj dhe në prova. Citimi në relacion i shkresave të ardhura nga institucionet e treta, një përmbledhje e përciptë e parashtrimeve të aplikantit, si dhe mungesa thellësisht e qëndrimit të relatorit të çështjes në lidhje me faktet, rrethanat, provat, pretendimet dhe parashtrimet e paraqitura, tregojnë qartazi, që në këtë rast, nuk është bërë as hetim i thelluar dhe aq më pak vlerësim substancial i kërkesës dhe vlerësimit të kandidatit. Për këtë arsye, qartësisht arrihet në përfundimin se në mënyrën, se si ka vepruar Këshilli në verifikimin, hetimin dhe vlerësimin e kriterëve ligjore të ankueses, procesi i vlerësimit është i paragjykuar dhe tërësisht formal, duke synuar thjesht marrjen e një vendimi përfundimtar. Mungesa e arsytimit të vendimit të organit kolegjal brenda një afati të arsyeshëm, tregon qartazi se organi kolegjal, ka qenë i paqartë në lidhje me vendimarrjen e tij, duke përbërë një precedent të rrezikshëm, pasi kundërshton në mënyrë të hapur logjikën e ligjvënësit, se përse arsyetimi i vendimeve për organet kolegjiale, të cilat thirren me njoftim paraprak, duhet të bëhet paraprakisht dhe sipas një afati të caktuar ligjor prekluziv. Në rastin objekt shqyrtimi, rezulton tërësisht e provuar se zbardhja e vendimit është bërë 13 ditë pas marrjes së vendimit dhe për të arsye, gjykata duhet të hetojë shkaqet, që kanë sjellë vonimin e zbardhjes së vendimit.

Për këtë arsye, nga ana e paditëses vlerësohet se vendimi i marrë nga Këshilli, në datën 17.07.2020 krijon bindje të arsyeshme, se ky organ ka pasur paqartësi në mënyrën e vendimarrjes, e cila është rrjedhojë e një procesi të parregullt ligjor. Nëpërmjet këtij vendimi, Këshilli, ka sanksionuar se tejzgjatja e veprimeve verifikuese paraprahe dhe përfundimi i tij, nuk janë aq të rëndësishme, sa të kryhen brenda një afati të arsyeshëm dhe në përputhje me rregullat ligjore të përcaktuara (referoju pikës 46 të Vendimit nr. 4, datë 11.03.2019).

➤ **Trajtimin e barabartë para ligjit dhe standarde të dyfishta.**

Në vendimin e marrë objekt shqyrtimi, Këshilli, dukshëm ka cenuar standardet e trajtimit të barabartë të shtetasve para ligjit, si dhe ka cenuar balancën kushtetuese që duhet të ekzistojë midis të zgjedhurit për të punuar në sektorin publik dhe atë privat, duke diskriminuar në mënyrë të hapur të gjithë ata subjekte, që ushtrojnë profesionin e tyre në sektorin privat. Gjithashtu, Këshilli, nuk ka mundur dot të qartësojë dhe të analizojë kuptimin kushtetues të termit “*nëpunës i nivelit të lartë në administratën publike*” si dhe “*jurist i spikatur*”. Këshilli, në rastin e ankueses dukshëm ka cenuar praktikën e ndjekur tashmë prej tij në vlerësimin e kandidaturave për anëtarë të Gjykatës Kushtetuese, duke krijuar haptazi trajtim me standard të dyfishtë në raste të ngjashme, si dhe paragjykim të vlerësimit të kandidatëve.

Në çështje të ngjashme, që kanë pasur në themel të tyre vlerësimin e kriterëve formale të vjetërsisë në punë si dhe analizimin e termit “*nëpunës i nivelit të lartë në administratën publike*”, Këshilli, ka mbajtur qëndrim në lidhje me këto çështje konkretisht në vendimet e tij të marra gjatë vitit 2019. Po t’i referohesh vendimit nr.102, datë 30.07.2019, (përkatësisht pika, 75, 76, 77), vendimit nr.61, datë 24.07.2019 (përkatësisht pika 59), vendimit nr.101, datë 30.07.2019 (përkatësisht pika 46, 47), vendimit nr.54, datë 24.07.2019 (përkatësisht pika 58, 59), rezulton qartësisht e provuar se, i njëjti organ ka mbajtur qëndrim krejtësisht të ndryshëm nga ai, që ka mbajtur për ankuesen në këtë gjykim, pa pasqyruar, asnjë argument shtesë se përse Këshilli, po devijon nga praktika e vendosur prej tij brenda një harku kohor kaq të shkurtër (një viti). Në këtë drejtim, Këshilli, në cilësinë e organit kushtetues, rezulton të ketë shkelur rëndë themelin e parimeve, që po vetë ai ka njohur në pajtueshmëri me normën kushtetuese, përse i përket eksperiencës profesionale dhe vitet e punës për të qenë “*jurist i spikatur*” apo “*nëpunës i nivelit të lartë të administratës publike*”.

Në krahasim të këtyre dy parimeve, që janë zbërthyer, analizuar dhe interpretuar me vendimarrjet e Këshillit, përpara se ankuesja të aplikonte, për vendet vakante për anëtar të Gjykatës Kushtetuese, ajo pretendon se ndodhet përballë faktit, se e njëjta trupë gjykuese, madje me të njëjtët relatorë propozues, kanë mbajtur një qëndrim të ndryshëm, për të njëjtën eksperiencë profesionale sa i takon nivelit të strukturës organike specialist/nivel ekzekutues sipas organigramës së administratës publike. Këshilli, nuk ka mbajtur në vëmendje dhe as ka marrë fare në analizë faktin se, aktet që rregullojnë dhe normojnë organizimin strukturor të administratës publike, mund të përdoren dhe të

referohen edhe nga sektori privat. Vetëm fakti i ushtrimit të veprimtarisë në sektorin privat, nuk i përjashton subjektet, që operojnë në sferën e këtij të fundit, që ta rregullojnë organizimin e tyre strukturor, njëlloj si dhe sektori publik. Madje përkundrazi, duke qënë një model i suksesshëm dhe i mirëstrukturuar, sektori privat, ka filluar që organizimin e brendshëm strukturor të kompanive, ta përshtasë dhe ta modelojë sipas strukturimit të administratës publike, për aq sa ata vlerësojnë dhe e mendojnë të përshtashme, sipas natyrës së veprimtarisë kryesore që mbulojnë. Për këtë arsye, Kushtetuta dhe parimet themelore të shtetit, nuk lejojnë që të ketë një disbalancim të paarsyeshëm midis sektorit privat dhe atij publik. Për këtë arsye, qëndrimi i mbajtur nga shumica e anëtarëve, rezulton të ketë mbajtur haptazi dhe pa asnjë shkak ligjor të justifikuar, një standard të dyfishtë vlerësimi ligjor e kushtetues, duke cenuar dukshëm dhe haptazi të drejtën e shtetasve për të pasur trajtim të barabartë, dinjitoz e mbi baza reale garimi. Është e paqartë për ankuesen, standardi i dyfishtë i mbajtur nga vetë Këshilli, lidhur me njohjen dhe klasifikimin e eksperiencës dhe përvojës në sektorin privat, si të pajtueshme me standardin kushtetues edhe pse ajo përvojë dhe eksperiencë vjen nga sektori privat, i referohet vendimit të KED nr.19 datë 17.07.2020, pika 43 (c) faqe 9. Ndërkohë, që për paditësen ky standard ishte i pazbatueshëm sipas Kushtetutës, dhe në këto kushte edhe pse ky qëndrim është i vetë KED dhe i të njëjtit relator propozues, mbetet tërësisht i pakuptimtë dhe dyshues për ankuesen, se përse, për emrin e saj nominal e njëjta trupë mban një tjetër qëndrim.

Veprimtaria e këshillimit ligjor në çështjet e punës, sigurisë dhe shëndetit në punë, ndërmjetësimi për punë, apo për shërbim shëndetësor nuk janë të parëndësishme, madje, nëse i referohesh Kushtetutës (neni 49, 59), si akti më i rëndësishëm gjendet e pasqyruar dhe rregulluar në kuptimin primar rëndësia e këtyre parimeve në mënyrë të drejtëpërdrejtë. Nën këto kushte paditësja e gjen tërësisht të pavend dhe të pambështetur mosnjohjen e viteve të saj të punës në sektorin privat, si avokate e licencuar, në drejtim të udhëheqjes së një shoqërie (*të parit subjekt privat të rregjistruar në RSH për çështjet e këshillimit ligjor për sigurinë dhe shëndetin në punë në kuadër të ligjit 10237/2010*), që ofron sipas ligjit këshillim ligjor, punë që e ka kryer dhe e kryen, që prej vitit 2012 në këtë disiplinë të së drejtës. Fakti, që është administrator pranë këtij subjekti nuk zhvleftëson faktin tjetër, që është avokat i licencuar dhe objekti i aktivitetit dhe aftësitë e saj profesionale të konfirmuara nga licenca e avokatisë, janë kritere komplemetare, që plotësojnë më së miri njëra-tjetrën, në këtë aktivitet të lejuar me ligj. Nga ana tjetër fakti, që ka qenë dhe është e dypunësuar, nuk ka asnjë pengesë ligjore, madje është tregues i administrimit të mirë të veprimtarive dhe përgjegjësive të detyrave që kryen me përkushtim e gjithaq edhe i burimeve njerëzore që monitoron. Nga ana tjetër paditësja adreson, po me të njëjtën logjikë, se edhe vitet e saj në sektorin privat pranë shoqërisë së sigurimit të jetës, si në rolin e juristit dhe në atë të drejtorit ligjor, nuk mund të zbehin apo rrëzojnë, sipas kuptimit origjinar Kushtetues, vitet e saj në këtë disiplinë, si jurist i spikatur apo dhe avokat, sa kohë që ka mbrojtur, çështje në të gjitha shkallët e gjykimit të

subjektit, ku kontribuon prej 10 vitesh. Industria e sigurimit të jetës, megjithëse shkencë e re edhe në botë, sot dominon doktrinën juridike me risitë në konceptet juridike, që ka sjellë, falë zhvillimit të kësaj industrie tërësisht private, por me interes publik, referuar ligjit vetëm sipas rregullave kërkesë ofertë e mbikëqyrur. Në këtë kuptim paditësja paraqet para gjykatës këto konstatime, lidhur me qasjen, që ka veprimtaria e juristit, pranë shoqërisë së sigurimit të jetës, si një disiplinë e veçantë e së drejtës civile, nën këndvështrimin kushtetues. Është fakt, që sipas ligjit tonë të zbatueshëm aktual në fuqi shoqëritë e sigurimit, shoqëritë e administrimit të fondeve të pensioneve private, janë subjekte juridike me interes publik [ligji 52/2014, ligji 10091/2009 (i ndryshuar)]. Këtë klasifikim, ua ka dhënë ligji në fuqi, të cilin ligjvënësi shqiptar, kuptohet e ka transpozuar në tërësi nga *acquis communautaire*. Është po ashtu fakt, që *interesi publik* i këtyre subjekteve nuk gjendet tek të tjera aktivitete tregtare, të cilat lejohen të operojnë në Shqipëri, kjo jo për faktin, se ato janë më pak të rëndësishme për ekonominë në treguesit e vlerave, që ato prodhojnë e përkëmbejnë, por për faktin, se shërbimet me karakter financiar, sikundër klasifikohet aktiviteti i shoqërive të sigurimit të jetës, të pensioneve private dhe fondeve private, është shumë i rëndësishëm për publikun, për numrin e madh të klientëve, të cilëve u shërben ky aktivitet, por edhe për rëndësinë që vetë legjislacioni dhe industria në këtë disiplinë i ka dhënë standardit, që në këto aktivitete të evitohet çdo risk ligjor, apo financiar, që mund të vijë nga pakujdesia apo veprime të qëllimshme, që krijojnë kaos në tregun financiar, frikë, pasiguri, uljen e besimit dhe transparencës tek publiku, klient i edukuar me këto shërbime. Këto aktivitete me natyrë financiare, janë të mirë strukturuara dhe shumëfish të kontrolluara në të gjitha aspektet e veprimtarisë e jo vetëm veprimtarisë, por edhe stafit të rekrutuar, që punon në këto struktura. Kërkesat e ligjit, që në këtë industri, janë të lejuar të punojnë juristë, matematicienë, ekonomistë, të cilët kontrollohen për figurën morale e profesionale, aktivitetet që kanë kryer më herët gjatë jetës së tyre, përfshirë këtu krahas të tjerave edhe deklarimin nëse kanë qenë pjesë e subjekteve private, që kanë falimentuar, apo kanë kryer aktivitet në natyrë të jashtëligjshme, tregon rëndësinë e veçantë, që ka vendosur ligji dhe në kontrollin e disafishtë, për punonjësit që punojnë në strukturat administrative të këtyre subjekteve, për të pasur punonjës me integritet dhe pastërti akviteti, jashtë influencave të aktiviteteve të jashtëligjshme të lëvizjes së parasë. Për sa më sipër, paditësja paraqet të paligjshëm, kufizimin e deformimin e nocionit kushtetues, se juristët që punojnë në këtë industri, nuk janë të ekuivalentuar me terminologjinë e përdorur nga Kushtetuta, si juristë të nivelit të lartë në administratën publike, e juristë të spikatur në një disiplinë të caktuar të së drejtës. Eksperiencia e punës, qoftë edhe në detyrën e juristit në administratën e një subjekti juridik me interes publik, është e barazuar në frymë dhe në qëllim, (në kuptimin që paditësja i jep), me frymën që ka paraparë dhe afirmuar kushtetuta e RSH. Kufizimi i juristit të spikatur, vetëm tek administrata publike, sipas arsyetimit të KED dhe se këtë qasje Kushtetuta e parasheh, vetëm tek administrata publike apo tek institucione të pavarura publike me një status të caktuar kushtetues, dhe

jo tek të tjera institucione me interes publik, bën që paditësja të gjykoj apo çmoj se, është tërësisht e gabuar dhe jo kushtetuese. Po ky lexim haptazi i gabuar i ligjit, ndëmtun në kuptimin që i jepet këtij definicioni të interpretuar kështu, pasi në këtë mënyrë nuk sigurohet përfaqësim në atë gjykatë, të juristëve realisht të spikatur në fusha dhe drejtime të tjera të së drejtës. (Për qartësim shterues, subjektet private, si shoqëritë e sigurimit apo shoqëritë e administrimit të fondeve të pensionit apo investimeve, janë subjekte juridike, të cilat ligji i ka vendosur në rangun e parë për interesin publik që bartin. Ky interes shfaqet në disa aspekte: a- në aspektin se këto institucione me natyrë financiare, rregullohen dhe monitorohen me kujdes, pasi bartin interes publik, për aktivitetin që ushtrojnë, tregun që zhvillojnë të aseteve me natyrë të lartë likuide, por edhe të risqeve për garanci dhe transparencë publike ndaj klientit dhe shtetit të vendit ku operojnë. Në këtë kuptim, përse veprimtaria e tyre në aspektin publik, për KED është më pak e vlerësueshme, se çdo veprimtari tjetër që shfaq çdo institucion tjetër me natyrë publike, qoftë ky i përmendur edhe posaçërisht në Kushtetutë. Lind pyetja se a është e krahasueshme detyra e juristit të spikatur në institucione kushtetuese në këndvështrimin kushtetues me atë të juristit, i cili punon në një institucion publik privat. Patjetër, që janë të krahasueshme dhe të matshme produktet që shpërfaqin juristët në të dy sektorët e krahasuar. Në këtë kuptim origjinal është e mundur, që të bëhet edhe analiza edhe vlerësimi i spiktajes së tyre, sa kohë që veprimtaria e tyre është e matshme dhe ka drejtpërdrejt, një impakt publik).

➤ ***Vendosja e kufizimit të së drejtës në mënyrë të paarsyetuar dhe në kundërshtim me kriteret ligjore dhe frymën e kushtetutës***

Në të gjitha vendimet e sipërcituara, që janë bërë publike, Këshilli, ka vlerësuar se termi kushtetues “*jurist i spikatur*”, ka qenë qartësisht i identifikuar në deklaratimet apriori të kandidatëve, pa qenë fare e nevojshme, sqarimi prej tyre, i kuptimit të normës kushtetuese dhe ligjore. Referuar praktikës konstante, që ka mbajtur Këshilli në vlerësimin e disa kandidatëve të kualifikuar, se përmbushin kriteret formale të vjetërsisë në punës, nuk rezulton të jetë qartësuar dhe konsoliduar, se mbi cilat baza ligjore dhe argumentuese, është arritur në konkluzionin se cilësinë e “*juristit të spikatur*” dhe kategorinë si “*nëpunës i lartë në administratës publike*” e kanë vetëm kategori të tilla punonjësish si: a) *specialist në Gjykatën Kushtetuese*, b) *Ndihmës Ligjor në Gjykatën Kushtetuese*; c) *Drejtor i Drejtorisë së Përgjithshme në Gjykatën Kushtetuese*, ç) *ndihmës-komisioner pranë Avokatit të Popullit*, d) *Sekretar i Përgjithshëm në Administratën Publike*, dh) *Drejtori i Drejtorisë së Përgjithshme e të tjera të ekuivalentuar me këto*, janë të vetmet pozicione pune të ekuivalentuara për nga vlera me termin e përdorur nga kushtetututa dhe ligji “*jurist i spikatur*” dhe “*nëpunës i nivelit të lartë të administratës publike*”.

Në lidhje me këtë çështje, duhet të mbahet në konsideratë fakti, se në asnjë rast Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, nuk ka bërë një listim literal të këtyre pozicioneve, si dhe as vetë ligji organik. Ndaj është shumë e rëndësishme për një proces

te rregullt ligjor, që të qartësohet dhe të argumentohet, se mbi cilin argument apo bazueshmëri juridike dhe kushtetuese, KED ka përcaktuar cilësimin e këtyre kategorive pune, si punë profesionale, që kryhen nga juristë të spikatur. Në ndryshim nga procedurat e ndjekura më parë, në çështjen objekt shqyrtimi, aplikanti, ka bërë një parashtrim të gjatë e shterues, se mbi bazën e cilave parimeve, fakteve, rrethanave dhe provave konkrete ka mbështetur kërkesën e tij, për të garuar për një nga vendet vakante për anëtar të Gjykatës Kushtetuese, duke synuar që gjatë procesit të vlerësimit të thirrje nga organi, për tu dëgjuar në lidhje me shpjegimet e tij, të ballafaqohet në lidhje me argumentet pro dhe kundër, të debatonte dhe të argumentonte sipas ligjit në mënyrë të drejtë dhe të paanshme, si dhe të provonte me dokumente shkresorë dhe me fuqi të plotë provuese, se plotësonte të gjitha kriteret profesionale në lidhje me vjetërsinë në profesion, për tu konsideruar në nivel të pranueshëm kushtetues si *“jurist i spikatur”* dhe me një përvojë profesionale prej 15 vjetësh.

Këshilli, nuk rezulton të ketë arritur sqarimin, plotësimin dhe argumentimin e detyrimeve të tij ligjore dhe kushtetuese për kryerjen e procesit të vlerësimit paraprak të aplikantit që ka shprehur interes për një vend vakant në Gjykatën Kushtetuese. Ky organ rezulton se nuk ka bërë asnjë analizë thelbësore, se cila është metodologjia dhe baza e të dhënave, që ka përdorur për të konkluduar se subjekti aplikant, është i pa pranueshëm për pozicionin për të cilin ka aplikuar. Këshilli, në mënyrë të hapur ka cenuar parimet kushtetuese dhe ligjore, mbi të cilat është ngritur ky proces, duke diskriminuar dhe duke paragjykuar, të gjithë juristët që vijnë nga sektori privat, të cilët, sipas vlerësimit të këtij organi kushtetues, kurrësi nuk mund të barazohen apo të ekuivalentohen si *“juristë të spikatur”* apo si *“juristë të nivelit të lartë”*.

Në mënyrën sesi Këshilli, ka analizuar dhe ka argumentuar çështjen objekt shqyrtimi, ka paragjykuar haptazi, se asnjë jurist, i cili ka punuar në sektorin privat, si drejtues kompanie apo në pozicione të tjera, nuk e bëjnë të spikatur, as për shkak të natyrës së veprimtarisë, që ai ka kryer apo ka mbuluar. Me vendimin vendimin objekt shqyrtimi, Këshilli, ka sanksionuar qëndrimin, se kandidatët që vijnë me përvojë profesionale nga sektori privat, nuk mund të garojnë për një pozicion të lartë publik, për shkak se puna e kryer prej tyre në sektorin privat për të njëjtën kategori pune (psh, specialist, drejtor, këshilltar ligjor) nuk barazohet dhe nuk ekuivalentohet me punën, që kryhet në institucione të tilla si Gjykata Kushtetuese, Avokati i Popullit, ose në nivele të larta të administratës publike (*organe qendrore të pushtetit ekzekutiv*). Në këtë kuptim, Këshilli, ka nënvlerësuar në mënyrë të paarsyeshme zhvillimin profesional në sektorin privat në krahasim me sektorin publik, si dhe ka nënvlerësuar pozicione të caktuara pune në administratën publike, duke bërë një vlerësim sipërfaqësor të kategorisë së punës për efekt të pagës, por jo një vlerësim substancial të veprimtarisë profesionale, që kryejnë dhe mbulojnë këto kategori pune.

Ky qëndrim i Këshillit, jo vetëm që nuk ka përmbushur standardet dhe qëllimin për të cilin u parashikua kryerja e një procesi të tillë, por ka krijuar një precedent të rrezikshëm,

duke paragjykuar procesin në mënyrë të hapur, si dhe ka shkurajuar juristët, që vijnë nga jashtë sistemit gjyqësor, qoftë, edhe si juristë të spikatur në disiplina të caktuara të së drejtës, për të garuar në mënyrë të drejtë, të barabartë dhe dinjitoze me qëllim marrjen e detyrës së gjyqtarit kushtetues. Në rastin objekt shqyrtimi, Këshilli ka treguar qartë, se nuk ka përmbushur kushtet dhe kriteret ligjore për të gjykuar drejtë çështjen që i ishte adresuar për vlerësim, në përputhje me rregullat proceduralë të gjykimit, pa paragjykime dhe brenda frymës së përcaktuar në ligjin kushtetues. Këshilli, nuk rezulton që të ketë sqaruar dhe të ketë konkluduar përfundimisht, se cilat janë standardet kushtetuese në drejtim të kriterëve dhe cilësive, që duhet të përmbushin subjektet që duan të kandidojnë për anëtar të Gjykatës Kushtetuese, me qëllim që të garantojë se procesi publik i përzgjedhjes së kandidatëve është real, garues dhe aspak formal.

Këshilli, në cilësinë e organit vlerësues, kishte për detyrë që t'i tregonte aplikantes në vlerësimin paragjykimor të çështjes (nëpërmjet relcionit), se ligji dhe kushtetuta kanë parashikuar kufizime strikte, duke dhënë sqarime shteruese, se në cilin drejtim të kriterëve ligjore të vjetërsisë në punë qëndrojnë këto kufizime. Në këtë kuptim, në relacionin e dërguar për njoftim aplikantes, Këshilli, duhet të kishte pasqyruar qartësisht se, ndalohet kandidimi i juristëve që vijnë nga radhët jashtë gjyqësorit, që nuk kanë ushtruar detyrën e Sekretarit të Përgjithshëm të Kryeministrisë, Ministrive, Drejtore Departamenti apo Drejtorie të Përgjithshme sipas ligjit për administratën publike (*si ligji i kohës në të cilën është krijuar kjo eksperiencë dhe jo një ligji të ndryshuar më vonë, i cili i jep efekt prapaveprues, vlerësimi të kategorisë apo cilësisë jurist i spikatur*) apo pozicione të barazuara sipas ligjit me to, si këshilltarë, specialistë apo kategori të caktuara të institucioneve kushtetuese, të cilët ligjërisht, janë barazuar me statusin e nëpunësit civil.

Këshilli, ka dështuar që të argumentojë fakin, se barazimi i pozicioneve të punës prokuror, gjyqtar dhe avokat, nuk është vetëm në drejtim e barazimit të tyre për efekt të shërbimit publik dhe rolit që ata kanë, por edhe të faktit, se subjektet që i ushtrojnë këto pozicione pune, fitojnë një status të caktuar. Për tu emëruar gjyqtar dhe prokuror, Kushtetuta ka parashikuar ndjekjen e Shkollës së Magjistraturës nëpërmjet një procesi garimi mbi baza meritokracie dhe transparence, ndërsa për të fituar statusin "Avokat", pasi kryen Shkollën një vjecare të Avokatisë, i nënshtroresh një testimi korrekt dhe mbi baza meritokracie, ku vetëm, pasi ke kaluar një nivel të caktuar pikësh, merr titullin "Avokat". Në këtë drejtim, kur Këshilli, ka marrë në shqyrtim kërkesën e aplikates-ankuese, duhet të kishte hetuar se cilat ishin arsyet, që ajo nuk ka ushtruar aktivisht avokatinë (*në kuptim të ushtrimit të funksionit edhe nga pikëpamja e legjislacionit financiar*) edhe pse e kishte fituar statusin dhe titullin "avokat" që në vitin 2002, titull, i cili as i është hequr dhe as i është kufizuar në kuadrin e një ecurie disiplinore apo penale. Përse nuk është thelluar këshilli në konstatimin e thjeshtë dhe absolut, se për sa kohë je punonjës i administratës publike, nuk ka hapësirë ligjore të kesh pajtueshmëri në kryerjen e avokatisë me nipt aktiv. Nga ana tjetër vetë Këshilli, ka dështuar të cilësojë funksionin

dhe detyrën që ankuesja, si e dypunësuar, ka kryer pranë subjektit që drejton si Administrator i vetëm, që prej themelimit Sicred ASSISTANCE shpk (*shoqëri këshillimi ligjor, me status aktiv, që prej 17 Korrik 2012*). Detyrat e funksionet në drejtimin e kësaj shoqërie, por edhe në frymën e objektit të veprimtarisë, që ky subjekt ka të sanksionuar, nuk mund të ç'bëjnë eksperiencën e saj, së paku 8 vjeçare si avokat, që drejton këshillim ligjor të fokusuar në çështjet e punës, sigurisë në punë, duke dhënë këshillimin ligjor me shkrim sipas ligjit në fuqi. Pra përsëri lind pyetja se cilat janë arsyet, që kjo sferë dhe disiplinë e posaçme e avokatisë dhe këshillimit, sipas ligjit, bazuar në gjykimin e shëndoshë të Këshillit, zbehin vlerën dhe kualitetet e aplikantes, si avokate, megjithëse e vetme në këtë fushë, dhe e barazojnë eksperiencën e saj në këtë drejtim me numrin zero vite eksperience si avokat. Paditësja pretendon se ndoshta çështjet e punës, sigurisë në punë, shëndetit në punë dhe në mjediset e punës, ndërmjetësimit për punësim mes punëdhënësit dhe punëmarrësit për të gjetur punë të denjë, të paguar mbi baza të barabarta dhe të merituar apo ndërmjetësimit në shërbime shëndetësore, nuk janë sfera, aq të afirmuara nga Kushtetuta, saqë eksperiencat në këto drejtime, janë të pa nevojshme për një kandidat për anëtar në Gjykatën Kushtetuese.

Në drejtim të sa më sipër, nëse ligjvënësi e ka barazuar në nivel kushtetues prokurorin, gjyqtarin dhe avokatin, si aktorë kryesor në dhënien e drejtësisë, si dhe ka parashikuar qartësisht se prokurorët dhe gjyqtarët mund të ushtrojnë veprimtari të tjera shtetërore, konkretisht të komandohen pranë administratës së Ministrisë së Drejtësisë, organeve drejtuese të drejtësisë KLGJ-së; KLP-së, ILD-së, apo edhe në Gjykatën e Lartë dhe Gjykatën Kushtetuese, përvojë e cila edhe pse, nuk është në funksionin e gjyqtarit dhe prokurorit, ju njihet, si eksperiencë pune si gjyqtarë dhe prokurorë (*referoju nenit 53 të Ligjit 96/2016 i ndryshuar*), ndërsa për avokatët që e kanë fituar këtë titull dhe status, që vendosin të ushtrojnë profesionin e tyre pranë pozicioneve të ndryshme në administratën publike ose atë private, të ekuivalentuara me të, nuk ju njihet vjetërsia e punës, si vjetërsi shërbimi si avokat, vetëm për shkak të pagimit të detyrimeve tatimore. Këshilli, duhet të kishte mbajtur në vëmendje faktin se, pagimi i detyrimeve tatimore në kuadrin e cilësimit të avokatit, si subjekt tregtar dhe tatimor, nuk ndikon dhe cenon titullin dhe statusin e fituar prej tij, përse i përket përvojës profesionale dhe aftësisë së ushtrimit të saj. Për këtë arsye, ligji "Për avokatinë" ka pasqyruar qartë, se cilat janë rastet kur hiqet e drejta e ushtrimit të profesionit të avokatit, apo rastet e kufizimit të tij.

Barra për të arsyetuar dhe dëshmuar qartësisht çfarë ligja parashikon dhe se si interpretohet ai, i takon organit procedues, që në rastin konkret është Këshilli. Për këtë arsye, ky i fundit, përfaqësuar nga relatori i çështjes, kishte detyrimin, që t'i njoftonte aplikantes qëndrimin e organit në lidhje me vlerësimin paraprak rreth përmbushjes ose jo të kriterëve ligjore që kishin të bënin me vjetërsinë në punë. Vetëm në këtë mënyrë, aplikantja do të kishte mundësi reale për të debatuar dhe kundërshtuar këto gjetje, si dhe do t'i garantohej e drejta e mbrojtjes dhe e drejta për tu dëgjuar përpara organi kolegjal, përpara se ky i fundit të merrte një vendim përfundimtar. Për këtë arsye, Këshilli, nuk ka

respektuar parimet e procesit të rregullt ligjor, duke parashtruar për vendimarrje çështje, të cilat nuk i janë bërë me dije aplikantit, në mënyrë që ajo të kishte mundësi të mbrohej, sipas ligjit.

➤ **Mungesa e arsytimit të vendimit**

Vendimi objekt ankimi nuk plotëson asnjë standard kushtetues për të pasur një vendim të arsyetuar, i cili t'i ketë dhënë përgjigje të plotë dhe shteruese të gjitha pretendimeve, që pala ka ngritur para tij. Referuar arsytimit të vendimeve objekt shqyrtimi, nuk rezulton që Këshilli (shumica vendimarrëse) të ketë bërë një analizë të thelluar dhe të ketë arsyetuar në lidhje me kriterin e vjetërsisë në punës, duke e kthyer procedurën e vlerësimit të kandidatit në një proces të thjeshtë aritmetik (mbledhje të viteve të punës) apo evidentim faktik (se 10 vitet e punës së ankueses janë në sektorin privat), duke shmangur në këtë mënyrë, detyrimin e saj kushtetues dhe ligjor për të verifikuar, hetuar dhe më pas arsyetuar vendimarrjen.

Në referim të përmbajtjes, së vendimeve objekt shqyrtimi, rezulton se pakica ka qenë ajo që ka përmbushur detyrimin kushtetues dhe ligjor, duke dhënë argumente shterues ligjor, *se pse ka mbajtur një qëndrim të kundërt nga shumica*, e cila nuk rezulton të ketë dhënë asnjë lloj argumentimi, se pse ka konkluduar në rezultatin e ndalimit të kandidaturës. Në këtë kuptim, është mendimi i pakicës, ai që jep deduktime, se cilat janë arsytet që e kanë detyruar shumicën për të pasur një opinion të kundërt, mendim i cili mbulon arsyetimin e vendimarrjes në dy drejtime: a) *atë material; si dhe b) procedurale*. Njëra nga anëtarët në pakicë, ka dhënë argumentat e saj në lidhje me themelin e vendimarrjes së çështjes (*anëtarja Memçaj*), ndërsa anëtarja tjetër në pakicë (*anëtarja Dollani*) ka argumentuar nga pikëpamja procedurale, se në këtë fazë të procedurës së vlerësimit organi, duhet të vlerësojë vetëm faktin, nëse kandidati e ka vjetërsinë në punë prej 15 vitesh, sa e kërkon ligji, apo jo. Për sa i përket, cilësisë së tij profesionale, ky është një kriter i cili duhet të vlerësohet nga Këshilli, në fazën e vlerësimit të profesionalizmit, pikëzimit dhe renditjes së kandidatëve.

Në analizë të sa më sipër, sipas doktrinës juridike, si dhe kërkesave themelore për të pasur një proces të rregullt ligjor, organi është i detyruar, që të arsyetojë apo argumentojë vendimarrjen duke mbajtur në vëmendje edhe natyrën e çështjeve, që ai synon të rregullojë ((*shih vendimet e GJEDNJ-së në çështjen Marini kundër Shqipërisë, datë 18 dhjetor 2007, § 105; dhe në çështjen Van de Hurk kundër Holandës, 19 prill 1994, § 61*). Vetëm, duke pasur një arsyetim të vendimit, organi procedurës (Këshilli) të mund të garantojë, se ka kryer një veprimtari hetimore të plotë, të rregullt, ka dëgjuar palët e interesuara, ka lejuar debatimin e çështjes mbi bazë kontradiktoriteti, si dhe më pas ka mundur të arrijë në një vendimarrje përfundimtare. Në rast se, vendimarrja, e një organi kolegjal është me shumicë dhe pakicë, argumentimi i mendimit të shumicës është më i rëndësishëm, në kuadrin e procesit të rregullt ligjor, sesa argumentimi i mendimit të pakicës, pasi vendimarrja e shumicës është ajo që sjell pasoja të drejtpërdrejta juridike për subjektin e interesuar. Për këtë arsye, në asnjë rast argumentimi i mendimit të

pakicës, nuk mund të zëvendësojë mendimin e arsyetuar të shumicës, pra argumentet e dhëna nga pakica, të përkthehen, si rrëzim i këtyre argumenteve nga shumica (*metoda e deduktimit*).

Për sa më sipër, në vendimet objekt shqyrtimi në këtë gjykim, rezulton qartësisht dhe lehtësisht e verifikueshme, se anëtarët në shumicë të Këshillit, nuk kanë dhënë asnjë lloj argumenti ligjor, se përse ushtrimi i veprimtarisë profesionale në *sektorin privat*, nuk plotëson kushtet dhe kriteret ligjore të parashikura në nenin 7/a të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese", (i ndryshuar). Këshilli, (shumica e anëtarëve), ka anashkaluar në mënyrë të paarsyeshme dhe aspak të justifikueshme faktin, që është një organ kushtetues dhe si i tillë, ai ka jo vetëm të drejtë, por detyrim, që të bëjë një interpretim të drejtpërdrejtë dhe original të dispozitave kushtetuese, që rregullojnë mosmarrëveshjen objekt shqyrtimi, duke dhënë një argumentim të plotë, të shëndoshë e logjik (shih vendimin nr. 20, datë 13.04.2012).

Në këtë mënyrë, kjo shumicë e anëtarëve të Këshillit, përpara se të evidentonte faktin se ushtrimi i veprimtarisë profesionale në sektorin privat, nuk përfshihet në atë veprimtari që parashikon neni 7/a i ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese", (i ndryshuar), duhet të kishte zbërthyer parashikimet e nenit 125 pika 4 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe çdo parim tjetër të rëndësishëm të saj, mbi bazën e të cilit është miratuar ligji specifik i zbatueshëm, i cili nuk mund të krijojë në asnjë rast konflikt ose kundërshti me dispozitat kushtetuese, që janë në nivelin më të lartë të hierarkisë së akteve.

Në kushtet kur, vendimarrja në lidhje me lejimin apo ndalimin e kandidatëve për të vijuar garën për vendet vakante për anëtarë të Gjykatës Kushtetuese, është një veprimtari e rëndësishme hetimore administrative, e rregulluar me procedura, afate të përcaktuara, por që ka edhe një natyrë dinamike në lidhje me hetimin dhe procedurat që duhen ndjekur për secilin rast (kandidat), argumentimi i vendimit nga ana e Këshillit, qoftë edhe në nivelet më minimale që parashikon dhe garanton standardi kushtetues për këtë çështje, është kriter thelbësor, që vendimi përfundimtar të jetë i vlefshëm në kuptim të parashikimeve të nenit 100 të K.Pr.Administrative, nenit 238/2 të Ligjit nr. 115/2016, (i ndryshuar), pikës 53 dhe 54 të Vendimit nr. 4, datë 11.03.2019 të Këshillit, i ndryshuar, si dhe praktikës së pasur të Gjykatës Kushtetuese në drejtim të arsytimit të vendimeve gjyqësore (shih vendimet 25, datë 10.06.2011; nr. 38, datë 30.12.2010; nr. 23, datë 23.07.2009; nr. 7, datë 09.03.2009; nr. 11, datë 02.04.2008; të Gjykatës Kushtetuese).

Edhe më e rëndësishme bëhet kërkesa, për të pasur një vendim të argumentuar mirë, kur flasim për një procedurë hetimore vlerësimi të rregulluar në mënyrë të drejtpërdrejtë nga Kushtetuta, që ka një rëndësi të veçantë publike. Jo pa qëllim për pasjen e një procedure të rregullt dhe të drejtë ligjore, ligjvënësi ka përfshirë në këtë proces edhe aktorë të tjerë të rëndësishëm në nivel kushtetues, si Avokati i Popullit, përfaqësues të organeve të emërtesës, si Presidenti i Republikës, Kuvendi i Shqipërisë, të cilat duhet ta motivonin organin (Këshillin) për të kryer një arsytim të plotë e shterues të këtyre vendimeve, pasi

nëpërmjet argumentimit të mirë të tyre, mundësohet edhe realizimi i vëzhgimi publik të administrimit të drejtësisë (*shih vendimin Sarban kundër Moldavisë, prg. 98, datë 4 tetor 2005*). Për këtë arsye, vendimet e dhëna nga Këshilli, jo vetëm që duhet të përmbushin të standardin dysHEME kushtetues, për të pasur një proces të rregullt ligjor (shih vendimin nr. 55, datë 18.12.2012, nr. 8, datë 16.03.2011; nr. 23, datë 04.11.2008; nr. 11, datë 02.04.2008 dhe nr. 7, datë 09.03.2009 të Gjykatës Kushtetuese), por këto vendime duhet të pasqyrojnë një nivel, sa më të lartë profesional e doktrinar, sidomos në fillim të aplikimit të standardeve të reja kushtetuese, që duhet të ndiqen për përzgjedhjen e kandidatëve të Gjykatës Kushtetuese, pas miratimit të Reformës në Drejtësi të vitit 2016, si dhe rekomandimeve konkrete, që dha Komisioni i Venecias në raportin e tij përfundimtar në muajin Tetor të vitit 2019.

Referuar vendimeve objekt shqyrtimi, rezultojnë tërësisht i paqartë nga pikëpamja procedurale dhe ajo materiale, qëndrimi i mbajtur nga Këshilli dhe argumentimi shterues i tij, se cilat janë çështjet konkrete që duhet të hetohen, verifikohen dhe vlerësohen nga Këshilli gjatë procedurës paraprake të vlerësimit, në kuptim të parashikimeve të nenit 237 të ligjit nr.115/2016, (i ndryshuar), si dhe kufijtë e shqyrtimit të këtyre çështjeve. Vendimet për lejimin e kandidimit, ndalimin e kandidimit dhe vijimin e procedurës së verifikimit, për kushtet dhe kriteret e tjera ligjore të kandidimit (pika 50 e Vendimit nr. 4, datë 11.03.2019), përbëjnë çështje paragjykimore dhe, si të tilla ato, nuk mund të afektohen apo të ngatërrohen me çështje të cilat, duhet të vlerësohen nga Këshilli në një fazë tjetër të vlerësimit, për të cilat ndiqen rregulla, kritere dhe procedura të ndryshme vlerësimi (neni 239 dhe 240 të Ligjit 115/2016, i ndryshuar).

Në lidhje me këto çështje, ka një argumentim ligjor, vetëm në mendimin e pakicës së anëtarës/relatore znj. Saida Dollani, por nuk ka asnjë paragraf apo analizë të shprehur, për këtë çështje nga ana e anëtarëve të shumicës, duke e lënë këtë kërkim me natyrë procedurale pa asnjë lloj argumentimi. Sqarimi i kësaj çështje nga ana e Këshillit, ka një rëndësi jo vetëm në kuptim të qartësisë dhe saktësisë të procedurave, që duhet të ndiqen nga Këshilli në mënyrën e hetimit, mbledhjes së të dhënave dhe argumentimit të tyre, për të pasur një proces të rregullt ligjor, por edhe për të mos lejuar që anëtarët e Këshillit, kur marrin vendime të tilla të gjenden para papajtueshmërisë, për vijim e shqyrtimit të çështjeve për vlerësimin e kriterëve profesionale dhe pikëzimin e kandidatëve, nëse gjykata, vlerëson se vendimet e çështjeve paragjykimore janë marrë në shkelje të rëndë të procedurave të vlerësimit dhe hetimit. Për këtë arsye, mungesa e sqarimit dhe argumentimit të këtyre, çështjeve në vendimin e dhëna nga shumica, e bën vendimarrjen dhe të gjithë procedurën e ndjekur për marrjen e saj, të pavlefshme për shkak të paqartësisë.

Gjithashtu, mungesa e koherencës dhe përputhjes, së argumenteve që janë pranuar nga shumica, si dhe janë rrëzuar nga pakica, apo e kundërta, tregojnë qartësisht, se i gjithë procesi vendimmarrës së këtij Këshilli ka qenë kaotik dhe jo i bazuar mbi një rend të qartë argumentesh “pro” dhe “kundër”. Pra, rezultojnë se pakica ka dhënë argumente për të

AGJË APFIK

cilat shumica nuk ka pasur anjë lloj komenti apo vlerësimi, ashtu sikurse rezulton edhe e kundërta, që shumica ka dhënë argumente për çështje, të cilat nuk rezultojnë të jenë prekur fare nga pakica. Për këtë arsye, të dy vendimet objekt shqyrtimi janë të pavlefshëm, pasi shumica e anëtarëve të Këshillit, nuk kanë mundur dot, që të japin një arsyetim minimal në nivel të standardeve kushtetuese për interpretimin e dispozitave me karakter material dhe atyre procedural, se pse duhej ndaluar kandidatura e paditëses për vendin vakant të Gjykatës Kushtetuese. Për këtë arsye, ankuesja i është drejtuar gjykatës, për të qartësuar marrjen e këtyre vendimeve, pasi pas leximit të arsyetimit të vendimit jam edhe më paqartë, se nga sa ka qenë për mënyrën, faktet dhe rrethanat, që janë relatuar për çështjen e saj para Këshillit në mbledhjen e datës 17.07.2020. Për këtë arsye, paditësja i është drejtuar në datën 25.07.2020 Këshillit, për t'i vënë në dispozicion procesverbalin e mbledhjes dhe minutat e diskutimit për çështjen e saj, për të vlerësuar nëse arsyetimi i vendimit është reflektim i diskutimeve të kryera, apo ky arsyetim është bërë mbi çështje të cilat nuk janë debatuar, apo janë debatuar në mënyrë kaotike nga anëtarët e këshillit. Kjo kërkesë, është refuzuar nga Këshillit dhe për këtë arsye i kërkon Gjykatës, që të ndërhyjë për sigurimin e kësaj prove, e cila është e rëndësishme për zgjidhjen e drejtë të çështjes.

Nuk rezulton, të ketë një analizë të thelluar dhe profesionale të kuptimit mbi përvojën profesionale të juristit të spikatur, metodologjisë që përdoret për të arritur në këtë konkluzion, si dhe mbi cilat baza ligjore konkrete është mbështetur Këshilli, për të arritur në definimin objektiv të këtij termi. Përshkrimi i hollësishëm i metodologjisë dhe analizës ligjore, për të mbërritur në qartësimin e këtij nocioni kushtetues, në zberthim dhe brenda frymës që përcjell kushtetuta, është detyrim ligjor primar i Këshillit, si organi ligjor kompetent i përzgjedhur dhe i ngarkuar për të ndjekur procesin ligjor publik, të rekrutimit të kandidatëve për anëtar të Gjykatës Kushtetuese.

Nuk rezulton, që në arsyetimin e vendimit të dhënë për paditësen ankuese, Këshilli të ketë qartësuar dhe arsyetuar, se cila ka qenë metodologjia, që është përdorur për të matur cilësinë "*i spikatur*" të një juristi, i cili ka qenë kandidat për anëtar i Gjykatës Kushtetuese në gjykime të mëparshme. Kjo analizë e krahasuar është tërësisht e nevojshme, pasi vetëm në këtë mënyrë organi do të mund të qartësojë publikisht se vendimarrja e tij, është bërë mbi baza të shëndosha gjykimi dhe jo mbi arsye të tjera, që nuk njihen dhe as mbështeten nga ligji. Në asnjë paragraf të arsyetimit të këtij vendimi, nuk rezulton që të sqarohet se pse "*juristi i spikatur*" mund të cilësohet vetëm subjekti, i cili ka vlerësuar, që të bëjë karrierë brenda administratës publike, duke zgjedhur të ushtrojë një funksion publik si gjyqtar, prokuror apo avokat me licencë aktive, ose në çdo lloj pozicioni në organet kushtetuese të rregulluara me një ligj të veçantë.

Për cilën arsye ligjore dhe normë kushtetuese, asnjë subjekt tjetër, që edhe pse ka evidenca, që ka punuar përditë me ligjin, duke krijuar një mori aktesh nënligjore në një disiplinë të caktuar të së drejtës, nuk mund të klasifikohet si jurist i nivelit të lartë, vetëm sepse vjen nga një sektor privat, apo nuk është pjesë e administratës publike të

institucioneve të pavarura si mënyrë e zgjedhjes së tij, jo e cilësive që ai mbart. Përse sektori privat me imputin, që i jep publikut në të drejtat dhe marrëdhëniet që ai krijon, dhe zbaton qenka i privuar, i pa aftë, i pa eksperiencë për të qenë kandidat potencial, për anëtar në Gjykatën Kushtetuese. Fryma e ligjit kushtetues, në përmbajtjen e saj nuk transmeton të tillë konotacion, pasi nëse profili i avokatit në rolin e ekuivalentuar kushtetues është barazuar tërësisht me prokurorin apo gjyqtarin, atëherë edhe figura procedurale në proces gjyqësor, edhe roli i përfaqësuesit jurist i subjektit tregtar/apo i një organi shtetëror në të njëjtin proces gjyqësor, nuk është e dizbalancuar, ai ka të njëjtin shkallë rëndësie, si dhe figurat e tjera procedurale, në procesin gjyqësor. Prandaj paditësja çmon që fryma e zberthimit dhe e analizës së kuptimit origjinar të kushtetutës në të dy vendimet, objekt ankimi, është domosdoshmëri që gjykata, sipas ligjit duhet të urdhërojë të kryhet.

Gjithashtu, organi kushtetues, nuk ka arritur dot të sqarojë dhe të argumentojë se në çfarë raporti qëndron termi “*jurist i spikatur*” me “*përvojën profesionale prej 15 vitesh*” si gjyqtarë, prokuror, avokat, profesor ose lektor i së drejtës, në një fushë të caktuar të së drejtës, në mënyrë, që të qartësohet nëse këto dy kushte janë komplementare (konkurrense) me njëra tjetrën, apo janë kumuluese. Pra, për të qenë kandidat për anëtar i Gjykatës Kushtetuese në drejtim të kriterëve ligjore, mjafton të provosh vetëm faktin se je “*jurist i spikatur*”, se ke kryer veprimtari profesionale në harkun kohor prej 15 vitesh, të një kategorie të caktuar si gjyqtar, prokuror, avokat apo jurist i nivelit të lartë të administratës publike, pa pasur nevojën për të qenë i spikatur, apo duhet domosdoshmërisht të provosh se gjatë 15 viteve punë profesionale, duhet të dallosh si “*jurist i spikatur*”. Në lidhje me këto çështje, nuk rezulton të kemi një interpretim shterues dhe origjinal të këtij organi, as në vendimet objekt shqyrtimi gjyqësor, dhe as në vendimet e mëparshme të tij, që përbëjnë edhe praktikën e deritanshme të këtij organi, në procesin e vlerësimit të kandidatëve për anëtarë të Gjykatës Kushtetuese. Në këtë drejtim, vendimmarrja e Këshillit jo vetëm që nuk rezulton të jetë e argumentuar dhe e justifikuar, por kjo vendimmarrje, rezulton të cenojë dhe të prekë në mënyrë tërësisht të pajustificuar parime dhe balanca të tjera kushtetuese, që kanë lidhje me parimin e barazisë para ligjit, zgjedhjes së zhvillimit të profesionit, avancimit në karrierë, të drejtës për të pasur garë të drejtë e të ndershme, e ngritur vetëm mbi bazën e meritokracisë dhe aftësisë dhe jo mbi preferencave dhe paragjykime personale apo grupore.

Pala e paditur Këshilli i Emërimeve në Drejtësi kërkoi rrëzimin e padisë duke prapësuar se:

- Me anë të padisë, pala paditëse/ankuese Vjosa Bodo parashtron se janë kryer shkelje të hapura të rregullave procedurale, pasi:
 - a) Nuk është njoftuar rreth rezultateve konkrete nga subjektet e treta
 - b) Diskutimi mbi bazë kontradiktoriteti i gjetjeve

- c) Riekszaminim i të dhënave
- d) Baza e vlerësimit ligjor të gjetjeve
- e) Shkeljen e rregullave procedural të parashikuar në nenin 223, 224, 225 të ligjit nr.115/2016, përsa i përket formimit të trupës vlerësuese me anëtarë të paanshëm qoftë edhe në dukje
- f) Shkeljen e rregullave procedural në thirrjen e mbledhjes së organit kolegjal, standardet që duhet të përmbushin aktet që i nënshtrohen vlerësimit dhe vendimarrjes së organit kolegjal, procedura që ndjek organi kolegjal në diskutimin e çështjeve për të cilat është thirrur.
- g) E drejta për tu dëgjuar
- h) E drejta për tu mbrojtur
- i) Shmangien e paarsyeshme nga zbatimi i praktikës së deritanishme të organit, si dhe mbajtjen e qëndrimeve të ndryshme për çështje të ngjashme brenda të njëjtës mbledhje plenare.
- j) Mungesa e standardeve në mirëpërcaktimin e kriterëve ligjore mbi bazën e të cilit duhet të kryhet procedura e vlerësimit të kandidatëve, duke respektuar parimin e trajtimit të barabartë, të drejtë dhe të ndershëm, si dhe duke garantuar ekuilibrin kushtetues dhe ligjor që duhet të ekzistojë midis sektorit publik dhe atij privat.
- k) Vendosja e kufizimit të së drejtës në mënyrë të paarsyetur dhe në kundërshtim me kriteret ligjore dhe frymën e kushtetutës.
- l) Mungesa e arsytimit të vendimit.

Referuar pretendimeve, në tërësi të palës paditëse, të parashtuara më sipër, pala e paditur çmon se sa më sipër kanë të bëjnë me themelin e çështjes, pra me element të cilët janë totalisht diskrecion i Këshilli Emërimeve në Drejtësi.

- Mbi bazën e përcaktimeve të ligjit nr. 115/2016 “Për Organet e Qeverisjes së Sistemit të Drejtësisë”, është miratuar edhe akti normativ vendimi nr.4 datë 11.03.2019 “Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”, në të cilin janë parashikuar një sërë të drejtash dhe garancish për kandidatët në kuadër të transparencës dhe përzgjedhjes së kandidatëve më të mirë të mundshëm për gjyqtar të Gjykatës Kushtetuese. Në asnjë moment, qoftë relatori i çështjes apo anëtarët e Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, nuk kanë vepruar në kundërshtim me ligjin, apo të kenë qenë të njëanshëm dhe kjo ka çuar në cenimin e të drejtës së palës paditëse, si dhe çdo veprim që kanë kryer ka qenë në përputhje të plotë me qëllimin që u ka vendosur ligji, si dhe duhet theksuar se ka qenë një nga organet kushtetuese më transparente dhe më bashkëpunuese.
- Pala paditëse pretendon shfuqizimin e vendimeve nr. 17 datë 17.07.2020, nr. 18 datë 17.07.2020, të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi “Për ndalimin e kandidimit të kandidatës Vjosa Bodo (Muja), në vendin vakant për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese, të shpallur nga Kuvendi dhe nga Presidenti i Republikës”, por në asnjë moment nuk arsyeton konkretisht se cilat norma juridike të së drejtës pozitive janë shkelur nga ana e

Këshillit të Emërimeve në Drejtësi. Kjo mosmarreveshje dhe ky gjykim ka për objekt vetëm çështje të së drejtës procedurale të respektuar ose jo nga ana e Këshillit të Emërimeve në Drejtësi.

Të pretendosh një shkelje apo një mënyrë të ndryshme të interpretimit të ligjit nuk do të thotë apriori apo edhe nëpërmjet interpretimeve të ndryshme, se ka shkelje procedurale dhe akoma më keq shkelje të rënda procedurale. Duke i'u referuar nenit 238 të ligjit nr. 115/2016 "*Për Organet e Qeverisjes së Sistemit të Drejtësisë*", ndaj vendimeve të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, mund të bëhet padi vetëm për shkelje të rënda procedurale, kupton qartë se shkelja e kryer nga organi publik, duhet të jetë në atë shkallë sa i gjithë procesi të zhbëhet. Pra, nuk mund të pretendosh se është interpretuar ndryshe ligji dhe të jesh përpara shkeljeve të rënda.

Gjithsesi, në kushtet kur paditësja kërkon shfuqizimin e aktit administrativ, vendimeve nr.17 dhe nr.18 datë 17.07.2020 "*Për ndalimin e kandidimit të zonjës Vjosa Bodo (Mujo) në vendin vakant për Gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese, shpallur nga Presidenti i Republikës dhe Kuvendi i Republikës*", pala e paditur vlerëson se për t'i dhënë një kuptim se cilat janë shkeljet e rënda që bëjnë procesin të pavlefshëm me pasojë shfuqizimin e tij, duhet të mbështetesh në dispozitat e Kodit të Procedurave Administrative në përgjithësi dhe në veçanti në nenin 109 të tij, nga interpretimi literal i dispozitës së sipërcituar, rezulton se që të kërkohet shfuqizimin e aktit administrativ, duhet të plotësohet të paktën njëri nga elementët e parashikuar nga nenin 109 i K.Pr.Administrative për ta bërë aktin të paligjshëm dhe që paditësit t'i cenohen interesat e ligjshme të pretenduara:

Së pari, duhet që organi publik që e ka nxjerrë aktin administrativ ka vepruar në mungesë të kompetencës. Këshilli i Emërimeve në Drejtësi e ka kompetencë funksionale vlerësimin e kandidaturave për anëtar të Gjykatës Kushtetuese sipas neni 125 dhe 149/d të Kushtetutës dhe sipas nenit 217 dhe vijues të ligjit nr.115/2016 "*Për Organet e Qeverisjes së Sistemit të Drejtësisë*".

Së dyti, është rezultat i shkeljes të dispozitave lidhur me procedurën administrative. Ashtu sikurse është parashtruar edhe në pjesën përshkruese të kësaj Parashtrëse, nga ana e Këshillit të Emërimeve në Drejtësi procedura është respektuar në mënyrë rigoroze. Madje, kjo pranohet edhe nga pala paditëse, në shpjegimet e saja.

Së treti, është në kundërshtim me dispozitat që rregullojnë formën apo elementet e detyrueshme të aktit administrativ. Për këtë moment, pala paditëse është e qartë dhe nuk ka kundërshtime për mungesë të elementëve të aktit administrativ, pasi nga ana e Këshillit të Emërimeve në Drejtësi janë respektuar në mënyrë rigoroze kërkesat e neneve 98, 99 dhe 100 të K.Pr.Administrative.

Së katërti, është nxjerrë në mungesë të autorizimit nga një ligj, sipas pikës 2, të nenit 4, të këtij Kodi. Ashtu sikurse është shpjeguar më sipër Kushtetuta dhe ligji kanë ngarkuar dhe autorizuar KED, për verifikimin dhe vlerësimin e kandidatëve duke respektuar kërkesat e pikës 2 të nenit 4 të K.Pr.Administrative.

Së pesti, është në kundërshtim me ligjin material. Edhe lidhur me këtë kriter ligjor, nga ana e Këshillit të Emërimeve në Drejtësi është respektuar në mënyrë rigoroze për shkak se ligji material i ka përcaktuar qartë kushtet dhe kriteret që duhen plotësuar nga ana e paditësit, me pasoja për vazhdimin e më tejshëm të procedurës së vlerësimit dhe pikëzimit.

Së gjashti, është rezultat i diskrecionit të ushtruar në mënyrë jo të ligjshme. Edhe për këtë rast nga ana e Këshillit të Emërimeve në Drejtësi nuk është ushtruar asnjëherë diskrecion përtej asaj që ka parashikuar nga pika 4 e nenit 125 të Kushtetutës, shkronja "a" e pikës 2 të nenit 7/a të ligjit nr. 8577/2000 dhe nenit 217 dhe vijues të ligjit nr.115/2016 "*Për Organet e Qeverisjes së Sistemit të Drejtësisë*".

Së shtati, nuk është në përputhje me parimin e proporcionalitetit. Këshilli i Emërimeve në Drejtësi nuk ka marrë asnjë vendim i cili vjen në kundërshtim me ligjin dhe që vendimmarrja nuk është në përputhje me gjendjen që e ka diktuar atë. Akti administrativ objekt gjykim është pasojë e mosplotësimit të kushteve dhe kriterëve të parashikuar nga pika 4 e nenit 125 të Kushtetutës, shkronja "a" e pikës 2 të nenit 7/a të ligjit nr. 8577/2000 dhe si pasojë e të cilit kanë dalë vendimet nr.17 dhe nr.18 datë 17.07.2020 "*Për ndalimin e kandidimit të zonjës Vjosa Bodo (Mujo) në vendin vakant për Gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese, shpallur nga Presidenti i Republikës dhe Kuvendi i Republikës*".

- Lidhur me pretendimin e palës paditëse se i është mohuar e drejta për të dëgjuar dhe për tu mbrojtur, pasi në përfundimet e relacion nuk ka asnjë qëndrim të qartë dhe shterues në lidhje me rezultatin e përfundimeve të hetimit, pala e paditur sqaron se në relacion pasqyrohet në mënyrë kronologjike e gjithë procedura e ndjekur nga ana e relatorit apo Këshillit. Ky relacion i palës së paditur nuk përmban asgjë të re dhe të ndryshme nga ajo që pala paditëse është në dijeni, pasi ka dhënë shpjegimet përkatëse.

Relacioni, nuk përmban gjetje apo probleme për të cilat pala paditëse nuk është në dijeni, por përkundrazi në relacion është trajtuar çështja në mënyrë korrekte dhe transparente. Ky relacion është një veprimtari rutin që ndjek këshilli me qëllim njohjen e kandidatëve me gjendjen e faktit dhe ligjit dhe nuk ka të bëjë me faktin dhe qëllimin e njoftimit për efekt mbrojtjeje nga ana e kandidatëve apo të presë prapësime, pasi procedura është mbyllur dhe Këshilli është në fazë e vendimmarrjes për lejim ose jo të kandidimit.

Vlen të theksohet se ky relacion nuk përmban në asnjë moment konkluzione apo vlerësime të shprehura ose jo nga ana e relatorit, por siç u citua edhe më lartë pasqyrohet në mënyrë kronologjike e gjithë procedura e ndjekur për secilin kandidat. Ky relacion ka efekte vetëm njohje dhe nuk ka të bëjmë me procedurën dhe vendimmarrjen.

Pretendimi i paditëses se nuk i është njohur mundësia për tu dëgjuar dhe për tu mbrojtur në lidhje me gjetjet, nuk qëndron pasi, ashtu sikundër pranon dhe vetë pala paditëse është njoftuar në lidhje me gjetjen dhe ka dhënë shpjegimet përkatëse, të cilat janë marrë dhe vlerësuar nga KED në mbledhjen e datës 17.07.2020 kur janë marrë dhe vendimet objekt shqyrtimi.

Po t'i referohesh vendimeve objekt gjykimi nga pika 38 e tij dhe deri në pikën 61 është arsyetuar dhe sqaruar në mënyrë shteruese vendimmarrja e këshillit për ndalimin e kandidimit të palës paditëse, si dhe iu ka dhënë përgjigje edhe pretendimeve që janë ngritur në këtë padi nga palë paditëse, duke arsyetuar qartë faktet, rrethanat dhe provat. Nuk mund të pretendohet se ka shkelje të rënda procedurale për mosarsyetim, vetëm se arsyetimi ezaures i Këshillit të Emërimeve në Drejtësi në vendimin objekt gjykimi është i kundërt me interesat apo pritshmëritë e palës paditëse.

Është diskrecion i Këshillit interpretimi i fakteve, rrethanave, pretendimeve dhe provave, si dhe vlerën që ajo u jep atyre në raport me njëra tjetrën. Kjo e sqaruar më së miri në vendimin objekt gjykimi në pikën 38 - 61 të tij, duke sqaruar në mënyrë shteruese këto pretendime.

- Lidhur me kërkimin e tretë dhe të katërt të palës paditëse për lejimin e kandidimit nga gjykata dhe vlerësimin e saj, pala e paditur vlerëson atë si një kërkim tërësisht i pabazuar në ligj.

Nuk mund t'i kërkosh gjykatës të të lejoj për të vijuar me procesin e vlerësimit, pasi është atribut kushtetues dhe është një tagër eksplicit i Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, (kjo pikë nuk do të ezaurohet pasi vetë gjykata administrative e apelit është njohëse shumë e mirë e ligjit). Gjithësesi kjo pikë nuk duhet marrë në shqyrtim nga gjykata, pasi nuk ka të bëjë me shkeljet e rënda procedurale që janë objekt shqyrtimi prej saj, në kuptim të nenit 238 të ligjit nr.115/2016 "Për Organet e Qeverisjes së Sistemit të Drejtësisë".

- Duke ju referuar përmbajtjes së nenit 238 të ligjit nr.115/2016 "Për Organet e Qeverisjes së Sistemit të Drejtësisë", ku parashikohet se paditë kundër vendimit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi për ndalimin e kandidimit bëhen në Gjykatën Administrative të Apelit, por edhe kjo e kufizuar vetëm për pretendime për shkelje të rënda procedurale, arrihet në përfundimin dhe prapësimin thelbësor se ky Këshill, palë e paditur në këtë gjykim, nuk ka kryer shkelje procedurale, aq më tepër "të rënda" sikurse e kërkon ligji, të cilat i kanë cenuar interesat e ligjshme palës paditëse. Përkundrazi, pala e paditur pretendon se në procedurën e verifikimit të kandidaturës së paditësit, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi ka vepruar rigorozisht në përputhje me pikën 4 të nenit 125 të Kushtetutës dhe shkronja "a" të pikës 2 të nenit 7/a të ligjit nr. 8577/2000 dhe nenet 217 dhe vijues të ligjit nr.115/2016 "Për Organet e Qeverisjes së Sistemit të Drejtësisë", si edhe në përputhje me K.Pr.Administrative.

Personi i tretë Avokati i Popullit dhe Kuvendi i Shqipërisë edhe pse janë njoftuar nga gjykata nuk u paraqitën në seancë gjyqësore duke e lënë në mungesë.

Personi i tretë Presidenti i Republikës së Shqipërisë kërkoi pranimin e padisë duke parashtruar se:

- Presidenti i Republikës, si publikisht ashtu edhe përgjatë mbledhjeve të KED-së përmes përfaqësuesve të tij, ka theksuar qëndrimin se, jemi përballë situatës faktike të shqyrtimit të tre vakancave të parakohshme (2 të Presidentit dhe 1 të Kuvendit), kur Gjykata Kushtetuese ende nuk është funksionale për tashmë mbi 2 vjet, çështja e ripërtëritjes së saj është jetike.
- Këtë qëndrim ka mbajtur edhe me Opinionin e fundit për Shqipërinë Komisioni i Venecias i cili është shprehur se *“Është me rëndësi etike për Shqipërinë që sa më të shpejt kemi Gjykatën Kushtetuese, aq më tepër kur duhet të shqyrtohen çështje tepër komplekse që kanë të bëjnë me kushtetutshmërinë e çështjeve me interes publik (...)”*. Nën dritën e këtyre rekomandimeve, Presidenti i Republikës ka shprehur në vijimësi mbështetje për KED-së në veprimtarinë e tij të shqyrtimit, vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidatëve që kanë shprehur interes për vendet vakante në Gjykatën Kushtetuese.
- Kjo me qëllimin e vetëm që Këshilli të shqyrtonte sa më shpejt kandidaturat. Është për t'u vlerësuar që në këto 2 vakanca të shpallura të parakohshme, me mandat të shkurtër, ka patur kërkesa dhe interes të shprehur nga disa kandidatë. Presidenti i Republikës, ishte në pritje të përcjelljes së listave për të ushtruar të drejtën e tij të emërimit të anëtarit të rradhës së Gjykatës Kushtetuese.
- Moslejimi kandidimit të asnjë prej kandidatëve që kanë shprehur interesin për dy vakancat e parakohshme, është parë me tepër shqetësim, sidomos pas njohjes me vendimet përkatëse të zbardhura, tek të cilët nuk është gjetur e reflektuar, një proces i mirëfilltë të vlerësimit të kandidaturave, dhe arsyetimi e analiza ligjore e plotë mbi gjetjet e evidentuara. Në këto vendime mungon arsyetimi shterues i thelluar.
- KED në vendimet e tij më shumë citon fakte dhe shpjegimet, se sa një analizë të thelluar të gjetjeve në krahasim me bazen kushtetuese dhe ligjore.
- Neni 149/d i Kushtetutës përcakton se, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi kryen verifikimin e kushteve ligjore dhe vlerësimin e kritereve profesionale e morale të kandidatëve për anëtarë të Gjykatës Kushtetuese. Këshilli i Emërimeve në Drejtësi shqyrton dhe rendit kandidatët sipas meritës profesionale”. Ndaj dhe verifikimi i kushteve ligjore duhet nënshtrohet një procesi të mirëfilltë shqyrtimi nga KED, që nuk mund të ketë vetëm rolin e certifikuesit apo relatorit vetëm të gjetjeve të organeve të tjera prej të cilave merr e mbledh informacion për një kandidat. Pra KED mund të kishte bërë një vlerësim të thelluar të kushteve dhe kritereve të emërimit.
- Nëse nuk ka vendosur ende një standard për mënyrën e procedimit, KED, ka të gjithë mundësitë që të përcaktojë standarde të tilla që do të udhëheqin mënyrën e shqyrtimit të përmbushjes së secilit proces nëpërmjet vendosjes së këtyre standardeve, brenda kornizës kushtetuese dhe ligjore, edhe personat që vlerësojnë të shprehin interesin e tyre për një vakancë, do jenë më të qartë për kriteret që duhet të përmbushin e që do të merren në shqyrtim, ashtu dhe për procedurën të cilës do të duhet ta i nënshtrohen.

- Nevoja e interpretimit që mund të bëjë vetë KED, del qartë në rastin e shqyrtimit të kandidaturës së paditësit për dy vakancat në proces, edhe nga konsultimi i mendimeve të pakicës që ka patur për paditësin katër votime kundër kandidat. Pra vetë anëtarët e KED, nuk janë të qartë për procedurën që duhet të ndjekin dhe mbi mënyrën se kur një kriter quhet i përmbushur ose jo.
- KED duhet të ketë mundësinë të vlerësojë përvojën e secilit kandidat, përmes një interpretimi të normës kushtetuese dhe ligjore për rastet kur një kriter mund të vlerësohet i përmbushur nga kandidati, të përcaktojë një metodologji për të kryer vlerësimin e përmbushjes së kushteve ashtu si dhe të përcaktojë një metodologji edhe për të marrë në shqyrtim të thelluar e të dalë me një përfundim të saj, mbi të dhënat që mbledh nga institucionet e tjera, dhe jo vetëm administrojë ato në dosjen e kandidatit. Në 2 vjet, KED nuk ka arritur të krijojë një standard unik të vlerësimit të kandidatëve. KED ka pranuar apriori dokumentet e institucioneve të treta, ndërkohë ka raste që ka kërkuar edhe mendimin e ekspertëve të pavarur.
- Ndërsa kandidati në proces shqyrtimi, nuk ka patur mundësi të kundërshtojë gjetjet, duke u përballur me raportet e përgatitura nga institucionet e treta dhe pa patur mundësi për t'i përcjellë këtyre institucioneve sqarime dhe të kërkojë rishikimin gjetjeve. Sqarimet subjektet mund t'ia përcjellin vetëm KED, që në këtë rast duhet të bëjë vetëm shqyrtimin dhe vlerësimin.
- Ndaj duhet unifikuar praktika për verifikimet që KED bën dhe qëndrimin që ky organ duhet të mbaje, si i vetmi autoritet që Kushtetuta njeh për verifikimin dhe vlerësimin e kandidatëve.
- Kjo është e domosdoshme në kushtet kur aktualisht, nuk kemi gjykatë Kushtetuese aktuale që të bënte një interpretim përfundimtar.

Vlerësimi i kolegjit administrativ

Kolegji Administrativ pasi shqyrtoi çështjen, dëgjoji palët, analizoi rrethanat, faktet dhe ligjin çmon se padia duhet të rrëzohet me arsyetimin si më poshtë vijon:

Së pari: gjykata vlerëson të evidentojë kompetencën e saj për shqyrtimin e ankimit objekt i këtij gjykimi. Në referim të nenit 7/a, nenit 10/2/b të Ligjit Nr. 49/2012, në lidhje me nenin 238 të Ligjit nr.115/2016, “Për organet e qeverisjes të sistemit të drejtësisë”, kjo gjykatë ka kompetencën lëndore dhe funksionale për gjykimin e kësaj çështjeje.

Neni 7/a dhe 10/2/b i ligjit nr.49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative” parashikojnë:

Neni 7

Kompetenca lëndore

Gjykatat administrative janë kompetente për:

a) mosmarrëveshjet që lindin nga aktet administrative individuale, aktet nënligjore normative dhe kontratat administrative publike, të nxjerra gjatë ushtrimit të veprimtarisë administrative nga organi publik;

Neni 10

2. Gjykata Administrative e Apelit shqyrton:

a) ankimet kundër vendimeve të gjykatës administrative të shkallës së parë;

b) në shkallë të parë, mosmarrëveshjet me objekt aktet nënligjore normative, si dhe raste të tjera të parashikuara me ligj.

Neni 238 i Ligjit Nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes të sistemit të drejtësisë”, parashikon:

“Ankimet kundër vendimit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi për ndalimin e kandidimit vetëm për shkelje të rënda procedurale bëhen në Gjykatën Administrative të Apelit jo më vonë se 5 ditë nga dita e njoftimit të vendimit të kundërshtuar. Gjykata Administrative e Apelit vendos brenda 7 ditëve nga dita e dorëzimit të ankimit. Vendimi i saj është përfundimtar dhe i formës së prerë”.

Objekt gjykimi janë vendimet nr. 17, datë 17.07.2020, nr. 18, datë 17.07.2020 të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, për ndalimin e kandidimit të kandidatës Vjosa Bodo (Mujo), në vendin vakant për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese, të shpallura nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë dhe Presidenti i Republikës së Shqipërisë, për të cilat në bazë të nenit 238 të ligjit nr. 115/2016 kompetente për gjykimin e tyre është Gjykata Administrative e Apelit.

Së dyti: Në lidhje me afatin e kundërshtimit të vendimeve objekt shqyrtimi gjyqësor, Gjykata Administrative e Apelit vlerëson se paditësja është brenda afatit ligjor të parashikuar nga neni 238 i ligjit 115/2016 sipas të cilit: “Ankimet kundër vendimit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi për ndalimin e kandidimit vetëm për shkelje të rënda procedurale bëhen në Gjykatën Administrative të Apelit jo më vonë se 5 ditë nga dita e njoftimit të vendimit të kundërshtuar”.

Në rastin konkret, Vendimet Nr. 17, 18, datë 17.07.2020 të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi rezultojnë t’i jenë komunikuar paditëses, Vjosa Bodo (Mujo), më datë 30.07.2020 në rrugë elektronike në adresën e deklaruar nga vetë kandidatja, ndërsa padia rezultojnë të jetë dorëzuar dorazi në datë 04.08.2020, pranë sekretarisë së Gjykatës Administrative të Apelit, pra brenda afatit ligjor 5-ditor.

Së treti: në lidhje me personat e tretë në gjykim, ligji nr. 115/2016 ka parashikuar në nenin 223 në zbatim të parimit të transparencës se:

“1. Mbledhjet e Këshillit të Emërimeve në Drejtësi janë të mbyllura. Avokati i Popullit merr pjesë në mbledhjet dhe veprimtarinë e Këshillit.

2. Përfaqësues të autorizuar të Presidentit të Republikës, Kryetarit të Kuvendit dhe 2 anëtarë të komisionit të përhershëm përgjegjës për çështjet ligjore në Kuvend, njëri prej të cilëve i përket opozitës, ftohen të marrin pjesë në mbledhjet e Këshillit”.

Në këtë kuadër pala paditëse ka kërkuar thirrjen me cilësinë e persona të tretë të këtyre organeve në këtë gjykim.

Së katërti: Lidhur me pretendimet e ngritura në padinë e palës paditëse, Gjykata Administrative e Apelit çmon të ndalet në radhë të parë në natyrën e këtij gjykimi dhe hapësirën që ligji i ka lënë gjykatës në këto lloj gjykimesh.

Në pikën 4 dhe 5 të nenit 125 të Kushtetutës, parashikohet se:

“4. Gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese duhet të kenë arsim të lartë juridik, të paktën 15 vjet përvojë pune si gjyqtarë, prokurorë, avokatë, profesorë ose lektorë të së drejtës, nëpunës të nivelit të lartë në administratën publike, me një veprimtari të spikatur në fushën e së drejtës kushtetuese, të drejtave të njeriut ose në sfera të tjera të së drejtës.

5. Gjyqtari nuk duhet të ketë mbajtur funksione politike në administratën publike ose pozicione drejtuese në një parti politike gjatë 10 vjetëve të fundit përpara kandidimit. Kritere të tjera, si dhe procedura për emërimin dhe zgjedhjen e gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese rregullohen me ligj.”

Në pikën 1 dhe 2 të nenit 7/a të Ligjit nr. 8577/2000 parashikohet se:

“1. Gjyqtari i Gjykatës Kushtetuese mund të zgjidhet shtetasi shqiptar që përmbush këto kushte:

- a) të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- b) të ketë mbaruar arsimin e lartë juridik, Diplomë e Nivelit të Dytë;
- c) të mos ketë ushtruar funksione politike në administratën publike dhe të mos ketë mbajtur pozicione drejtuese në parti politike gjatë 10 viteve të fundit nga data e kandidimit;
- ç) të mos jetë në procedim penal dhe të mos jetë dënuar me burgim për kryerjen e një vepre penale;
- d) të mos jetë larguar nga detyra për shkaqe disiplinore dhe të mos ketë masë disiplinore në fuqi;
- dh) të ketë kaluar me sukses procesin e kontrollit dhe verifikimit të pasurisë së tij personale dhe të familjarëve të tij, sipas ligjit.

2. Kandidati që përmbush kushtet e parashikuara në pikën 1 të këtij neni, duhet të plotësojë edhe këto kritere:

- a) **të ketë përvojë pune jo më pak se 15 vjet si gjyqtar, prokuror, avokat, profesor ose lektor i së drejtës, jurist i nivelit të lartë në administratën publike;**
- b) **të ketë një veprimtari të njohur në fushën e të drejtës kushtetuese, të drejtave të njeriut ose sfera të tjera të së drejtës;**
- c) **të jetë vlerësuar për aftësitë profesionale dhe integritetin etik e moral.”**



Me hyrjen në fuqi të Ligjit nr.115/2016, "Për organet e qeverisjes të sistemit të drejtësisë", është parashikuar procedura e zgjedhjes së anëtarëve të Gjykatës Kushtetuese. Në këtë kuadër paditësja ka paraqitur kandidaturën për të qenë pjesë e saj nga radhët jo magjistrat. Ky ligj dhe aktet nënligjore kanë parashikuar procedurën që duhet të ndiqet për tu bërë anëtar i Gjykatës Kushtetuese, kushtet që duhet të plotësojë kandidati, organin që vendos për ndalimin, si dhe gjykatën ku mund të paraqitet ankimi.

Neni 234 parashikon:

- 1. Presidenti i Republikës i dërgon Këshillit të Emërimeve në Drejtësi listën e plotë të kandidatëve që kanë shprehur interes për vendet vakante në Gjykatën Kushtetuese, të cilat plotësohen nga Presidenti i Republikës, së bashku me dokumentacionin e paraqitur nga kandidatët, menjëherë pas publikimit të listës së kandidatëve në faqen zyrtare të Presidentit.*
- 2. Kryetari i Kuvendit i dërgon Këshillit të Emërimeve në Drejtësi listën e plotë të kandidatëve që kanë shprehur interes për vendet vakante në Gjykatën Kushtetuese, të cilat plotësohen nga Kuvendi, së bashku me dokumentacionin e paraqitur nga kandidatët, menjëherë pas publikimit të listës së kandidatëve në faqen zyrtare të Kuvendit.*

Neni 235 parashikon:

- 1. Menjëherë pas dërgimit të listave me emrat e kandidatëve ose të paraqitjes së shprehjes së interesit nga kandidatët, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi i pajis kandidatët me formularët për deklarinimin e pasurive dhe të interesave financiarë.*
- 2. Jo më vonë se 15 ditë nga marrja e formularëve për deklarinimin e pasurive dhe të interesave financiarë, kandidatët i dorëzojnë ato të plotësuara pranë Inspektoratit të Lartë për Deklarimin dhe Kontrollin e Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, i cili kryen kontrollin e saktësisë dhe të vërtetësisë së deklarinimit brenda 30 ditëve nga paraqitja e tij.*
- 3. Inspektorati i Lartë për Deklarimin dhe Kontrollin e Pasurive dhe Konfliktit të Interesave i dërgon menjëherë Këshillit rezultatet e kontrollit.*
- 4. Me përfundimin e procedurës së deklarinimit dhe kontrollit të pasurisë, Këshilli shpall në faqen zyrtare të Gjykatës së Lartë, si dhe u komunikon individualisht kandidatëve rezultatin e verifikimit, duke urdhëruar lejimin ose ndalimin e kandidimit. Urdhri për ndalimin e kandidimit është gjithnjë i arsyetuar***

Neni 237

Deklarimi dhe kontrolli i kushteve të tjera ligjore

- 1. Jo më vonë se 35 ditë nga mbërritja e listave të kandidatëve dhe dokumenteve që i shoqëron ato, Këshilli për Emërimet në Drejtësi kryen verifikimin e kushteve ligjore të parashikuara në ligjin për Gjykatën Kushtetuese dhe në nenin 234, pika 1, të këtij ligji.*

2. Për këtë qëllim Këshilli dërgon kërkesa me shkrim në adresë të subjekteve publike dhe private, sipas nevojës.

3. Me përfundimin e procedurës së verifikimit, Këshilli shpall në faqen zyrtare të Gjykatës së Lartë, si dhe u komunikon individualisht kandidatëve rezultatin e verifikimit të kushteve ligjore, duke urdhëruar lejimin ose ndalimin e kandidimit.

Neni 238 parashikon:

Ankimet kundër vendimeve për ndalimin e kandidimit

1. Ankimet kundër vendimit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi për ndalimin e kandidimit vetëm për shkelje të rënda procedurale bëhen në Gjykatën Administrative të Apelit jo më vonë se 5 ditë nga dita e njoftimit të vendimit të kundërshtuar.

2. Gjykata Administrative e Apelit vendos brenda 7 ditëve nga dita e dorëzimit të ankimit. Vendimi i saj është përfundimtar dhe i formës së prerë.

3. Ankimi nuk pezullon zhvillimin e procedurës së vlerësimit dhe të verifikimit paraprak të kryer nga Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, sipas nenit 240 të këtij ligji.

Në bazë të pikës 2 të nenit 229 i padituri KED ka nxjerrë vendimin nr. 4, datë 11.03.2019 “Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektoratit të Lartë të Drejtësisë”, mbi të cilin është bazuar në veprimtarinë e tij administrative në shqyrtimin e aplikimeve të paditëses Vjosa Bodo (Mujo), për pasojë edhe ky vendim është pjesë e akteve nënligjore mbi të cilat ky kolegji bazohet në shqyrtimin e çështjes objekt gjykimi.

Paditësja Vjosa Bodo (Mujo), është një ndër personat që ka shprehur interes për të kandiduar për plotësimin e vendeve vakant në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë (për dy vakanca), procedura e kandidimit të të cilit rezulton të jetë ndërprerë me aktet objekt gjykimi, për të njëjtin shkak, për mosplotësimin e kriterit të 15 vjet veprimtari profesionale nga ato të parashikuara si kusht për lejimin e kandidimit nga pika 4 e nenit 125 të Kushtetutës dhe shkronja ‘a’ e pikës 2 të nenit 7/a të ligjit nr. 8577/2000.

Pra duke iu referuar këtyre dispozitave Gjykata konstaton veçantitë e këtyre lloj gjykimesh dhe konkretisht:

Së pari: Në gjykatë paditësja mund të ngrëjë padi vetëm për çështje që kanë të bëjnë me pavlefshmërinë absolute të aktit administrativ, bile jo për çdo shkak që sjellë pavlefshmërinë absolute, por vetëm me shkakun e parashikuar nga neni 108/1/a pika “ii” të K.Pr.Administrative, pra vetëm për shkelje të rënda të procedurës së organit vendimarrës dhe për asnjë shkak tjetër të pavlefshmërisë absolute.

Së dyti: Ligji nr.115/2016, “Për organet e qeverisjes të sistemit të drejtësisë”, i ka kufizuar hapësirën e gjyqimit gjykatës, vetëm për një nga rastet e pavlefshmërisë absolute duke i hequr asaj mundësinë të marrë në shqyrtim çështje të tjera që paditësja mund të ketë pretendim, për pavlefshmërinë absolute. Po kështu ky ligj i ka hequr mundësinë gjykatës të marrë në shqyrtim çështje që kanë të bëjnë me pavlefshmërinë relative të aktit.

Në këto kushte ky kolegji nuk merr në shqyrtim faktin nëse paditësja e plotëson apo jo këtë kusht pasi vlerësimi i provave është në rastin konkret të ligjit nr. 115/2016, diskrecion i organit KED dhe konkluzionet që ai tërheq mbi bazë të analizës së provave nuk përbën objekt shqyrtimi për shkak të ndalimit dhe kufizimeve të nenit 238 të ligjit nr. 115/2016. Pala paditëse ka pretenduar se procedura e ndjekur deri në marrjen e vendimit është me të meta të tilla sa e bëjnë procesin absolutisht të pavlefshëm. Në këtë kuadër ligjor ky kolegji merr në analizë pretendimet e paditëses për ekzitsencën ose jo të shkeljeve të rënda të procedurës në rastin e shqyrtimit të kërkesave të shprehjes së interesit prej saj në dy vakanca për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese, nga i padituri KED.

Nga aktet e administruara në gjykim, shpjegimet e palëve në proces rezultoi e provuar se është pranuar dhe rezulton në gjykim se paditësja Vjosa Bodo (Mujo) ka shprehur interesin për vendin vakancë e parakohshme në Gjykatën Kushtetuese e shpallur nga Presidenti i Republikës në datë 07.02.2018 dhe rishpallur në datën 27.09.2019, për vendin vakancë e parakohshme në Gjykatën Kushtetuese e shpallur nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë në datë 28.08.2018 dhe rishpallur më datë 21.08.2019,

Për secilën kërkesë të paraqitur nga paditësja është hedhur shorti për caktimin e relatorit të çështjes sipas parashikimeve të nenit 228 të ligjit nr. 115/2016 dhe pikave 5, 27 - 37 dhe 41 të Vendimit nr. 2 datë 15.02.2019, dhe për paditësen janë përcaktuar relatorët, Saida Dollani dhe Arta Marku.

Në zbatim të pikës 22 të Vendimit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi me nr. 4 datë 11.03.2019 “Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë” paditësja është njoftuar nga i padituri me shkrim për tu paraqitur pranë Këshillit për të vijuar me përmbushjen e procedurave të verifikimit të kandidaturës (njoftimi me shkrim është kryer në rrugë elektronike në adresën e deklaruar nga vetë kandidatja).

Në datën 25.09.2019 kandidatja Vjosa Bodo (Mujo) është paraqitur pranë Këshillit të Emërimeve në Drejtësi ku është pajisur me formularët e deklarimit dhe autorizimet që duhet të plotësohen për qëllimet e vijimit të procedurës së verifikimit të kandidaturës së tij.



Në datën 30.09.2019, kandidatja Vjosa Bodo (Mujo) ka depozituar me postë dhe administruar në datë 02.10.2019 pranë Këshillit të Emërimeve në Drejtësi formularë të deklarimit dhe autorizimet përkatëse për qëllimet e vijimit të procedurës së verifikimit të kandidaturës së saj për të dy aplikimet e paraqitura prej saj.

Në datën 25.10.2019 kandidatja Vjosa Bodo (Mujo) është paraqitur pranë Këshillit të Emërimeve në Drejtësi ku është pajisur me formularët e deklarimit dhe autorizimet që duhet të plotësohen për qëllimet e vijimit të procedurës së verifikimit të kandidaturës së tij.

Në datën 30.10.2019, kandidatja Vjosa Bodo (Mujo) ka depozituar me postë dhe administruar në datë 02.11.2019 pranë Këshillit të Emërimeve në Drejtësi formularë të deklarimit dhe autorizimet përkatëse për qëllimet e vijimit të procedurës së verifikimit të kandidaturës së saj për të dy aplikimet e paraqitura prej saj.

Për verifikimin e kushteve dhe kriterëve ligjore të kandidimit, lidhur me verifikimin dhe kontrollin e pasurisë, në zbatim të shkronjës “dh” të nenit 7/a të ligjit nr. 8577/2000, të nenit 235 të ligjit nr. 115/2016, si edhe në zbatim të pikës 60 të Vendimit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi nr. 4 datë 11.03.2019 “Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë” me shkresën nr. 548 prot, datë 04.10.2019, KED i ka dërguar ILDKPKI-se listën e kandidatëve dhe personave të lidhur me to që i nënshtrohen procedurës së verifikimit të kushteve dhe kriterëve të tjera ligjore të kandidimit sipas ligjit nr.8577/2000 dhe ligjit nr.115/2016.

Me shkresën nr.4186/1 prot, datë 04.10.2019, ILDKPKI ka informuar Këshillin e Emërimeve në Drejtësi se kandidati Vjosa Bodo (Mujo) e ka përmbushur detyrimin e përcaktuar nga pika 2 e nenit 235 të ligjit nr. 115/2016 për të dorëzuar të plotësuar pranë atij institucioni Deklaratën e Pasurisë dhe Interesave Private të Kandidatit për Pozicione të ndryshme në Institucionet e Sistemit të Drejtësisë.

ILDKPKI, në zbatim të nenit 235 të ligjit nr.115/2016, të ligjit nr. 9049/2003 dhe ligjit nr. 9367/2005, me shkresën, nr.116/25 prot, datë 05.11.2019, ka dërguar pranë Këshillit të Emërimeve në Drejtësi rezultatet e kontrollit të ushtruar për kandidaten Vjosa Bodo (Mujo) dhe personat e lidhur me të.

I padituri, në funksion të ushtrimit të kompetencave të tij për verifikimin e plotësimit të kushteve dhe kriterëve ligjore të kandidimit, për sa i përket kontrollit të pasurisë, ka kryer veprimet verifikuese të kërkimit nga subjekte publike dhe private, të të dhënave mbi pasuritë, interesat private dhe detyrimet financiare që ekzistojnë në emër dhe për llogari të kandidates Vjosa Bodo (Mujo) dhe personave të lidhur me të.

Lidhur me kushtin e kandidimit të parashikuar nga pika 4 e nenit 125 të Kushtetutës dhe shkronja "a" e pikës 2 të nenit 7/a të ligjit nr. 8577/2000, pra që kandidatët të kenë të paktën 15 vjet përvojë pune si gjyqtarë, prokurorë, avokatë, profesorë ose lektorë të së drejtës, nëpunës të nivelit të lartë në administratën publike, ndryshe nga sa pretendon paditësja ka rezultuar se prej të paditur KED është shqyrtuar dokumentacioni i paraqitur nga vetë kandidatja, përfshirë jetëshkrimin, librezën e punës, si dhe shkresa e vërtetimit të lëshuara nga organet kompetente të emërtesës etj., që janë të administruara në dosjen e kandidimit.

Gjithashtu, për këtë rast kandidimi, ka rezultuar se Këshilli i është drejtuar me kërkesa për informacion disa institucioneve publike dhe subjekte private, pranë të cilave paditësja, kandidatja Vjosa Bodo (Mujo) ka ushtruar funksione publike ose veprimtari private profesionale apo ku gjenden të dhëna lidhur me ushtrimin e detyrave dhe veprimtarinë profesionale të kandidatit si: Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë (shkresa nr. 661 prot., datë 15.10.2019), Departamenti i Administratës Publike (shkresa nr. 657 prot., datë 15.10.2019), Shoqëria SICRED sh.a (shkresa nr. 662 prot., datë 15.10.2019).

Lidhur me të dhënat e kërkuara, Këshilli ka marrë përgjigje me shkrim nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë (shkresa nr. 8931/1 prot., datë 29.10.2019), Departamenti i Administratës Publike (shkresa nr. 6095/1 prot., datë 23.10.2019), Shoqëria SICRED sh.a. (shkresa nr. 2725/1 prot., datë 24.10.2019). Në këtë kuadër relatorët e çështjeve, i kanë kërkuar paditëses të paraqesë shpjegime me shkrim dhe dokumente shtesë në zbatim të nenit 237 të ligjit nr. 115/2016.

Nga aktet që janë të administruara në dosjen e kandidimit, rezulton se kandidatja Vjosa Bodo (Mujo) ka ushtruar veprimtari profesionale si:

- a) Sekretare pranë zv. Ministrit, për periudhën "21.01.2002 – 16.05.2002", pranë Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Tiranë.
- b) Sekretare pranë Sekretarit të Përgjithshëm, për periudhën "16.05.2002 – 16.04.2004", pranë Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Tiranë.
- c) Specialiste, për periudhën "16.04.2004 – 03.Mars 2009", pranë Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Tiranë.
- ç) Juriste pranë Departamentit Juridik dhe Burimeve Njerëzore, për periudhën "12.03.2009 – 10.05.2011", pranë subjektit tregtar SiCRED sh.a.
- d) Drejtor pranë Departamentit Juridik dhe Burimeve Njerëzore, për periudhën "10.05.2011 e në vijim", pranë SiCRED sh.a.

Gjithashtu rezulton se paditëses i është kërkuar shpjegim/informacion në lidhje me pozicionet e punës së deklaruar nga ana e saj, a mundet që të barazohen me atë në kuptim të nenit 7/a i Ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese. Mbi këtë



pyetjë pala paditëse Vjosa Bodo (Mujo) ka paraqitur me shkrim shpjegime dhe dokumente shtesë pranë Këshillit me e-mailin e datës 12.11.2019. Për sa më sipër konkludohet që pala e paditur ka kryer hetim të plotë e të thelluar edhe mbi këtë kriter.

Sa i përket pretendimit se relacioni nuk ka gjetje dhe konkluzion mbi ekzitencën e një kriteri ndalues, kolegji vlerëson se relacionet janë hartuar nga relatorët përkatës konform parashikimeve të ligjit nr. 115/2016 dhe vendimit nr. 4 datë 11.03.2019 “Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë” i ndryshuar. Konkretisht në përfundim të veprimeve dhe procedurave të kontrollit dhe verifikimit, në zbatim të neneve 235, 236 dhe 237 të ligjit nr.115/2016, si edhe të pikave 29, 75 dhe 87 të Vendimit nr. 4 datë 11.03.2019 “Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë” i ndryshuar, anëtarët e Këshillit relator të çështjeve kanë proceduar me përgatitjen e relacionit përkatës mbi gjendjen e faktit dhe të ligjit të zbatueshëm dhe e ka dërguar çështjen për shqyrtim në mbledhjen e Këshillit (sipas parashikimeve nga pika 17-32).

Sa i përket, pretendimit të paditëses se mos bërja prezent e gjetjeve mbi këtë kriter nga ana e këshillit e kanë pamundësuar atë të paraqesë prova dhe argumenta shtesë mbi natyrën e punës, dypunësimin, menyrën e rekrutimit në punë, etj, kolegji vlerëson se ky pretendim është i pabazuar dhe si i tillë duhet rrëzuar. Relatori i çështjes ka detyrë ligjore të realizojnë studimin e rrethanave, ligjit, praktikës gjyqësore, jurisprudencës dhe më tej të hartoj relacionit cili, pavarësisht gjetjeve dhe propozimeve apo jo të mundshme, nuk mund të diktojë një qëndrim të caktuar në anëtarët e Këshillit. Këshilli e ushtron veprimtarinë e tij në mënyrë kolegjiale, sipas rregullave dhe procedurave të parashikuara në ligj dhe aktet nënligjore të dala në zbatim të tij, dhe ai vendos me shumicën e votave në prani të të paktën pesë anëtarëve.

Në lidhje me kriterin e plotësimit të kushtit ligjor të përcaktuar nga pika 4 e nenit 125 të Kushtetutës dhe shkronja ‘a’ e pikës 2 të nenit 7/a të ligjit nr. 8577/2000, që i përket kriterit të mosplotësimit të 15 vjet veprimtari profesionale, ndryshe nga sa pretendon paditësja në gjykim rezulton se gjatë procesit administrativ të kryer nga dy relatorët e çështjeve, këshilli i ka kërkuar kandidatit të paraqesë shpjegime me shkrim dhe dokumente shtesë në zbatim të nenit 237 të ligjit nr. 115/2016 si dhe në zbatim të nenit 7/a të ligjit nr. 8577/2000, i është kërkuar informacion për: “1- Pozicionet e punës së deklaruar nga ana juaj, a mundet që të barazohen me atë në kuptim të nenit 7/a i Ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese"?”

Rezulton se paditësja Vjosa Bodo (Mujo) ka paraqitur me shkrim shpjegime dhe dokumente shtesë pranë Këshillit me e-mailin e datës 12.11.2019. Në përgjigje të informacionit të kërkuar nga Këshilli nëse pozicionet e punës së deklaruar prej saj plotësojnë kërkesën e nenit 7/a të ligjit nr. 8577/2000, paditëses i është dhënë mundësia të jap shpjegime dhe më konkretisht paditësja ka shpjeguar se:

1. Rezulton e provuar se unë kam përfunduar studimet e larta dega Drejtësi në Universitetin Shtetëror të Tiranës dhe jam diplomuar në vitin 2001, duke marrë titullin "Jurist". Jam atashuar pranë studios ligjore të znj. Zana Hasko, dhe më pas kam kryer provimin shtetëror të avokatisë, me të cilin kam marrë titullin "Avokat", licenca nr. 1731 - nëntor 2002. Kjo e drejtë e fituar prej meje, nuk është revokuar asnjëherë dhe si e tillë, vlen dhe ecën për efekt vjetërsie në kuptim të kërkesave të nenit 7/a i ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000.
2. Në vitet e provuara të punës sime pranë Ministrisë së Transporteve, vlej në për efekt vjetërsie periudha e punës nga 16-04-2004 deri në 20-03-2009, periudhë në të cilën kam qenë nëpunës civil. Kjo periudhë është kumuluese sipas kuptimit tim me vjetërsinë në total të viteve të eksperiencës sime në punë dhe në kuptimin që duhet të përfitojë meritat e të qënurit në epitetin kushtetues 'jurist i nivelit të lartë'. Në këtë pozicion, kam pasur si detyrë funksionale identifikimin dhe propozimin e krijimit të akteve ligjore edhe nënligjore, propozimin dhe draftimin e përmirësimit të akteve që rregullojnë dhe normojnë veprimtarinë e transportit ajror, si specialistja e vetme në gjithë organogramën e administratës shtetërore të Republikës së Shqipërisë që mbuloja këtë fushë.
3. Pavarësisht diferencës që ligjvënësi ka vendosur për dikastere të veçanta të administratës qendrore, duke klasifikuar kryesisht, juristët e Kuvendit të Republikës, juristët e Këshillit të Ministrave apo ato të Drejtorisë së Kodifikimit të Ministrisë së Drejtësisë si juristë të një kualiteti të veçantë/të spikatur, për qëllime të këtij komunikimi, më duhet të qartësoj se kontrolli për teknikë legjislative dhe kushtetueshmëri që kryejnë këto hallka mbi tekstin e propozuar ligjor nga ministritë e linjës, nuk mundet apriori të deduktojë që juristët propozues të aktit janë më pak kualitativë se juristët që kanë ndërtuar apo përshtatur aktin, në kuadër të zhvillimit të një politike të një sektori të veçantë.
4. Dua të qartësoj se puna si eksperte në drejtorinë e politikave të transportit ajror më ka spikatur. Duke ju referuar akteve me karakter ligjor apo nënligjor që janë prodhuar në harkun kohor 2004-2009 me propozim të ardhur drejtpërdrejt nga drejtoria e politikave të transportit ajror, nëpërmjet propozimit të ministrit të linjës, Ministrit të Transporteve, ndër të cilat një pjesë e mirë e akteve janë edhe transpozim i "acquis comunaitare", më japin avantazhin e padyshueshëm si jurist i spikatur gati unik në llojin e tij.
5. Nën petkun e juristit kam realizuar punën thelbësore në materializimin e aktit si draft, si një poshtë:
 - a. Ligji nr. 9281, date 23-09-2004, kam qenë pjesë e grupit të punës në ndërtimin e këtij akti ligjor.
 - b. Ligji nr. 9251, datë 08-07-2004, pjesë e grupit të punës për ndërtimin e këtij akti ligjor.
 - c. Ligji nr. 9255, datë 15-07-2004, "Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Konventën "Për unifikimin e disa rregullave për transportin ajror ndërkombëtar".
 - d. Ligji nr. 9312, datë 11.11.2004 që miraton kontratën koncesionare të aeroportit të vetëm ndërkombëtar që operon në RSH.



- e. Anëtare e grupit që ka ndihmuar z. Henrich Hegemann, avokat të përfaqësojë palën shqiptare në arbitrazh, pranë dhomës ndërkombëtare të tregtisë në Paris, lidhur me shoqërinë BEHASE (VKM 143, datë 19-04-2002).
 - f. Ligji që miraton rregullimin e transportit ajror ndërmjet Shtetit Shqiptar dhe Shtetit të Ukrainës, pjesë e grupit negociues në Ukrainë.
 - g. Ligji që miraton rregullimin e transportit ajror ndërmjet Shtetit Shqiptar dhe Shtetit të Izraelit.
 - h. VKM nr. 492, datë 30-06-2005 "Për caktimin e tarifave ajrore".
 - i. VKM nr. 480, datë 23-06-2005 që konfirmon miratimin e projekt-kontratës ndërmjet Qeverisë së Shqipërisë dhe Lockheed Martin Global inc.
 - j. Ligji 9658, datë 18.12.2006 që miraton marrëveshjen shumëpalëshe, pjesë e grupit negociues në Bruksel.
 - k. Kodi Ajror i RSH, (ligji Nr. 10 040, datë 22.12.2008).
 - l. VKM nr. 14, datë 7.1.2009 "Për miratimin e rregullave dhe të procedurave për regjistrimin ndërkombëtar".
 - m. VKM nr. 548 datë 29.08.2007, botuar në fletoren zyrtare 117, datë 10/09/2007.
6. Të gjitha këto angazhime, të cilat kanë konkluduar në prodhimin e akreve konkrete ligjore, ligje, apo vendime qeverie, apo përfaqësime sipas porosisë, reflektojnë më së miri angazhimin dhe eksperiencën time për të kryer në harkun kohor të 5 viteve punë detyrën e lartë të juristit të spikatur në një fushë dhe disiplinë të caktuar të transportit dhe jo vetëm.
 7. Pavarësisht faktit që dispozita kushtetuese kërkon eksperiencën në 15 vite të provuar me dokumente mbështetëse së paku në njërën nga kriteret alternative të cituara, arsyejoj që kriteri i viteve në profesionin e një avokati, nuk mund të minusohet vetëm nga kriteri i viteve për të cilat ka qenë aktiv në regjimin tatimor.
 8. Unë kam provuar me fakte evidente sipas kuptimit të ligjit që në 5 vite (prill/2004 - mars/2009) kam qenë jurist i spikatur i administratës shtetërore, jo vetëm në industrinë e aviacionit civil dhe të drejtës së saj, por edhe në disiplinat e së drejtës detare dhe atë rrugore.
 9. Vitet e punës në sektorin privat nga marsi i vitit 2009 e aktualisht, janë një tjetër sfidë të cilën besoj se e kam fituar me faktin që kam qenë aktive në përmirësimin ligjor. por edhe nëpërmjet formave ligjore kontraktuale të disa industrive të dallueshme e tërësisht të zhvilluara në 10 vitet e fundit, në të drejtën shqiptare.

Në këto kushte kolegji vlerëson se pretendimet e ngritura nga pala paditëse nuk qëndrojnë pasi paditëses i është dhënë mundësia e paraqitjes së provave dhe shpjegimeve konkrete pikërisht për kriterin i cili ka përbërë më pas edhe shkakun e vendimit të ndalimit të kandidimit të saj në vendin vakant të Gjykatës Kushtetuese. Kolegji thekson edhe një herë faktin se kjo gjykatë për shkak të natyrës së veçantë të gjykimit nuk merr në shqyrtim pretendimet që lidhen me faktin se nga ana e këshillit nuk janë vlerësuar drejtë provat në

marrjen e vendimeve me natyrë ndaluese të kandidati për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese.

Në lidhje me pretendimet e palës paditëse mbi mungesën e arsytimit, Kolegji vlerëson se referuar vendimit objekt gjykimi rezulton i arsyetuar sipas përcaktimeve të ligjit nr. 44/2015 i cili parashikon në kreun I, mënyrën e hartimit të aktin administrativ, formën e tij, arsytimin e aktit etj, kështu sipas pikës 5 të nenit 98 parashikohet që aktet e organeve kolegjiale bëhen në formë shkresore si dhe këto akte regjistrohen në një procesverbal, pa të cilin ato nuk sjellin asnjë pasojë juridike, ndërsa sipas nenit 100 parashikohet mënyra e arsytimit të aktit. Neni 100 parashikon që akti administrativ i shkruar në letër ose elektronik, si dhe akti administrativ i konfirmuar, sipas nenit 98, pikat 2 dhe 3, të këtij Kodi, duhet të jetë i arsyetuar. Sipas kësaj dispozite arsytimi i aktit administrativ duhet të jetë i qartë dhe përmban: a) shpjegimin e situatës faktike mbi të cilën është marrë akti; b) shpjegimin e përmbledhur të rezultatit të hetimit administrativ dhe të vlerësimit të provave; c) bazën ligjore të aktit dhe një shpjegim pse kushtet ligjore për zbatimin e tij plotësohen në këtë rast; ç) në rastin e diskrecionit, shpjegimin pse diskrecioni është përdorur në mënyrën e përcaktuar. me që nga pikat 54/55 deri në pikën 59/60 është arsyetuar dhe sqaruar në mënyrë shteruese vendimmarrja e keshillit për ndalimin e kandidimit të palës paditëse, si dhe i është dhënë përgjigje edhe pretendimeve që paditësja ka paraqitur në formën e objeksioneve dhe sqarimeve që një herësh një pjesë e tyre janë ngritur në këtë padi nga pala paditëse, duke arsyetuar qartë faktet, rrethanat dhe provat.

Në rastin objekt gjykimi rezulton se vendimet nr. 17 dhe nr. 18 të datës 17.07.2020 i përmbushin kërkesat e kërkuara nga nenet 98-100 të ligjit nr. 44/2015 për pasojë edhe ky kërkim i paditëses gjendet i pabazuar nga ky kolegji.

Kolegji e gjen të pabazuar pretendimin e palës paditëse se i padituri ka keqinterpretuar apo ka interpretuar gabim ligjin pasi ky pretendim ngrihet në nivel të pavlefshmërisë relative të akteve dhe nuk është objekt shqyrtimi nga ky kolegji pasi sikundër u arsyetua më lart nga ky kolegji në këtë vendim, mund të merren në shqyrtim vetëm shkeljet e rënda të procedurës të kryera prej të paditurit KED.

Ndryshe nga sa pretendon pala paditëse se prej të paditurit ka një sërë shkeljesh në kryerjen e procedurës së verifikimit deri në marrjen e vendimit objekt ankimi, kolegji konkludon se pala e paditurit KED ka ndjekur dhe zbatuar të gjithë fazat procedurale të kërkuar nga ligji nr. 115/2016, vendimi nr. 4 datë 11.03.2019 *“Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”*, i ndryshuar si dhe ligji nr. 44/2015.

Kolegji, vlerëson se pretendimet e paditëses janë të pambështetura në ligj për shkak se nuk u provua në këtë gjykim se pala e paditurit në ushtrimin e veprimtarisë së saj administrative, e cila në bazë të nenit 229 të ligjit nr. 115/2016 e ushtron atë në mënyrë kolegjiale, sipas rregullave të

përcaktuara në pjesën e pestë të ligjit nr. 115/2016 të cilat plotësohen për aq sa është e mundur me ligjin nr. 8480 datë 27.5.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike” (shih përmbajtjen e nenit 229 të ligjit nr. 115/2016) të janë kryer shkelje të rënda procedurale, të tilla që e cenojnë procesin dhe për pasojë sjellin pavlefshmërinë e tij.

Në kushtet kur paditësja kërkon konstatimin e pavlefshmërisë së vendimeve nr. 17 dhe 18, datë 17.07.2020 “Për ndalimin e kandidimit të kandidates Vjosa Bodo (Mujo), në vendin vakant për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese, të shpallura nga Presidenti i Republikës dhe Kuvendi i Republikës së Shqipërisë”, në kuptim të dispozitës nenit 238/1 të ligjit nr.115/2066, shkeljet e procedurës duhet të jenë aq të rënda sa e bëjnë procesin nul. Referuar në nenin 108 të K.Pr.Administrative, Kolegji vlerëson se në rastin konkret nuk jemi përpara asnjë shkelje që të çojë në nulitetin e akteve administrative objekt shqyrtimi gjyqësor.

Në lidhje me pretendimin e paditëses se: *“Më problematik nga pikëpamja e garantimit të një procesi të rregullt ligjor në rastin objekt shqyrtimi, është vendimi nr. 2, datë 17.07.2020 i Zëvendëskryetarit të Këshillit. Më këtë vendim, ky i fundit e ka kufizuar në mënyrë të paarsyeshme dhe në kundërshtim me sa parashikon neni 223 dhe 224 të Ligjit nr. 115/2016, i ndryshuar, pranimin e heqjes dorë të anëtares znj. Fatjona Memçaj, vetëm për subjektin në garë Ardita Buna, duke lejuar pjesëmarrjen e saj në mbledhjet dhe diskutimet për kandidatët e tjerë që garonin me këtë subjekt, për vendet vakante për anëtar të Gjykatës Kushtetuese, të shpallura dhe të rishpallura nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë. Pra në këtë këndvështrim vlen të thesohet fakti se, në një proces garimi, ku kandidatët konkurojnë midis tyre për një ose dy pozicione, si dhe ligjvënësi ka parashikuar se është i nevojshëm pasja e të paktën tre kandidatëve për një pozicion vakant, papajtueshëria e anëtarit të Këshillit me njërin nga subjektet në garë, nuk mënjanohet vetëm me mospjesëmarrjen e tij vetëm tek procedura e vlerësimit për subjektin e lidhur, por duhet të ndalohej edhe tek procedura e vlerësimit edhe për të gjithë subjektet e tjerë, që garojnë me subjektin e lidhur dhe janë konkurentë mes tyre. Nga ana tjetër paditësja konstaton, se kërkesa e anëtares Memçaj, për të mos marrë pjesë në mbledhjen e datës 17.07.2020, në të cilën do të trajtoheshin çështjet për verifikimin dhe vlerësimin e kandidatëve, si dhe procedurat konkrete të shqyrtimit të kandidimeve, ka qenë për të gjithë kandidatët që kishin aplikuar për pozicionet vakante të paraqitura nga Kuvendi i Shqipërisë dhe jo e kufizuar vetëm tek procedurat e vlerësimit për kandidaten Ardita Buna. Ndërsa, vendimi nr.2, datë 17.07.2020 i Zëvendëskryetarit të Këshillit, rezultoi të ketë miratuar heqjen dorë të anëtarit të Këshillit Memçaj, në mënyrë të kufizuar vetëm për subjektin Ardita Buna, dhe jo për të gjithë kandidatët e tjerë në garë me të. Për këtë arsye, kufizimi i kryer në vendimin e Zv/Kryetarit vjen në kundërshtim të hapur me parashikimet e nenit 223 dhe 224 të Ligjit nr. 115/2016, duke mos e shmangur papajtueshmërinë e anëtarës së Këshillit znj. Memçaj edhe për kandidatët e tjerë që garojnë në këtë garë me subjektin A. Buna, për vendet vakante të shpallura dhe rishpallura nga Kuvendi i Shqipërisë”, kolegji vlerëson se ky pretendim nuk gjen mbështetje në ligj.*



Ligji nr. 115/2016 ka parashikuar rastet e konfliktit të interesit të anëtarit të KED, papjtueshmërinë e tij dhe rastet e heqjes dorë nga pjesëmarrja në procesin për verifikimin e kushteve ligjore, vlerësimin e kriterëve profesionale dhe në renditjen e kandidatëve për anëtarë të Gjykatës Kushtetuese ose të kandidatëve për Inspektor të Lartë të Drejtësisë.

Në dispozitat e mëposhtme në mënyrë eksplicite bëhen këto parashikime ligjore për çështjet e cituara më lartë.

Neni 222

Konflikti i interesit

Anëtari i Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, i cili është në dijeni të një konflikti interesi ose të një pengese ligjore për veten ose për një anëtar tjetër të Këshillit lidhur me një çështje, është i detyruar të deklarojë natyrën e interesit ose të pengesës, **të mos marrë pjesë në diskutimin e çështjes përkatëse dhe të mos marrë pjesë në votimin çështjes përkatëse.**

Neni 223

Papajtueshmëria

Anëtari i Këshillit të Emërimeve në Drejtësi nuk mund të marrë pjesë në verifikimin e kushteve ligjore, vlerësimin e kriterëve profesionale dhe në renditjen e kandidatëve për anëtarë të Gjykatës Kushtetuese ose të kandidatëve për Inspektor të Lartë të Drejtësisë, **në qoftë se midis tij dhe kandidatit ekzistojnë marrëdhëniet e mëposhtme:**

- a) marrëdhënie martesore ose bashkëjetese;
- b) marrëdhënie gjinie të afërt, përfshirë persona të paralindur, të paslindur, vëllezër, motra, ungjër, emta, nipër, mbesa, fëmijë të vëllezërve dhe të motrave; ose
- c) marrëdhënie krushqie të afërt, përfshirë vjehërr, vjehërrë, dhëndër, nuse, kunatë, thjeshtër dhe njerë.

Neni 224

Heqja dorë

1. Anëtari i Këshillit të Emërimeve në Drejtësi është i detyruar të heqë dorë nga pjesëmarrja në procesin për verifikimin e kushteve ligjore, vlerësimin e kriterëve profesionale dhe në renditjen e kandidatëve për anëtarë të Gjykatës Kushtetuese ose të kandidatëve për Inspektor të Lartë të Drejtësisë në rastet e mëposhtme:

a) kur ai, bashkëshorti/bashkëjetuesi i tij ose fëmijët e tij janë debitorë ose kreditorë në raport me kandidatin, ose kanë përfaqësuar interesat e tij në të shkuarën;

b) kur ekzistojnë mosmarrëveshje ndërmjet tij, bashkëshortit/bashkëjetuesit të tij ose ndonjë të afërmi të tij me kandidatin.

2. Vendimi për pranimin e dorëheqjes së anëtarit merret nga Kryetari i Këshillit. Kur dorëheqjen e jep Kryetari, vendimi për pranimin e saj merret nga zëvendëskryetari.

Rezulton nga aktet se anëtarja e KED znj. Fajtona Memçaj duke menduar se ndodhet në një prej rasteve të kërkuara më sipër ka paraqitur në datë 17.07.2020, kërkesë për mospjesëmarrjen e saj në mbledhjen ku do të trajtohen çështje që kanë për objekt verifikimin dhe vlerësimin e kandidatëve si dhe në procedurat konkrete të shqyrtimit të kandidimeve për pozicionet vakante të paraqitura nga Kuvendi i Shqipërisë. Kjo kërkesë është marrë në shqyrtim nga Zv. Kryetari i KED i cili në përfundim ka vendosur me vendimin nr. 2 datë 17.07.2020 pranimin e heqjes dorë të anëtares se KED znj. Fatjona Memçaj nga pjesëmarrja dhe mbledhjet e këtij këshilli mbi procedurat e verifikimit dhe vlerësimit të kandidatës Ardita Buna (Alsula) që ka shprehur interes për vendin vakant në Gjykatën Kushtetuese të shpallur nga Kuvendi i Republikës në datën 28.8.2018 dhe rishpallur në datën 21.08.2019.

Pala paditëse nuk provoi se qenia e anëtares Fajtona Memçaj në mbledhjen e datës 17.07.2020 të këtij këshilli mbi procedurat e verifikimit dhe vlerësimit të kandidatës Vjosa Bodo (Mujo) e cila ka shprehur interes për vendin vakant në Gjykatën Kushtetuese të shpallur nga Kuvendi i Republikës në datën 28.8.2018 dhe rishpallur në datën 21.08.2019 dhe Presidenti i Republikës datë 07.02.2018 të rishpallur në datë 27.09.2019 ka cenuar procesin e rregullt ligjor mbi përbërjen e trupës kolegjiale të KED, kjo për faktin se nga analiza e dispozitave të sipër cituara arrihet në përfundimin se ligji ka parashikuar që anëtari i KED të heq dorë nga çështje konkrete ku në shqyrtim është një kandidat me të cilin anëtari i KED ndodhet në kushtet dhe kriteret e

kërkuara nga nenet 222-224 të ligjit nr. 115/2016, një e cila ka ndodhur në rastin konkret pasi anëtarja e KED nuk ka marrë pjesë në shqyrtimin e kërkesës së kandidatës Ardita Buna.

Paditësja në padi ka kërkuar si derivat të kërimit kryesor edhe detyrimin e palës së paditur ta përfshijë në garë për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese. Në lidhje me këtë kërkim ky kolegji vlerëson se ai duhet të rrëzohet për dy arsye, *së pari*: sipas shpjegimeve që parashtron paditësja e ka konceptuar derivat të kërimit kryesor, i cili u gjet i pabazuar nga ky kolegji dhe si tillë u rrëzua, për pasojë edhe ky kërkim duhet të rrëzohet, *së dyti*: Kolegji vlerëson se në kuadër dhe të arsytimit të lartpërmendur është një kërkim i pambështetur në ligj, pasi sikundër u citua sa sipër, kjo Gjykatë shqyrton vetëm shkeljet e rënda të procedurës dhe, nuk ka tagra të lejojë apo moslejojë kandidimin e kandidatit, edhe në rast se gjykata do të kishte disponuar me pranimin e padisë për shfuqizimin e akteve, pasi mbi bazën e ligjit nr. 115/2016, kjo tagër i është dhënë vetëm KED-së.

Për gjithë sa u arsyetua ky kolegji vlerëson se padia është e pa mbështetur në prova e në ligj si e tillë ajo duhet rrëzuar.

Shpenzimet gjyqësore në bazë të nenit 106 të Kodit të Procedurës Civile i ngarkohen palë gjyqumbëse pra palës paditëse.

Në bazë të pikës 2 të nenit 238 të ligjit nr. 115/2016 ky vendim është përfundimtar dhe i formës së prerë.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Administrative e Apelit, në mbështetje të nenit 40, pika 3, të ligjit nr. 49/2012, datë 03.05.2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar, nenit 238 i ligjit nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes të sistemit të drejtësisë”

VENDOSI

- Rrezimin e padise si te pabazuar ne prova e ne ligj.
 - Shpenzimet gjyqësore i ngarkohen pales paditese.
 - Ky vendim eshte i formes se prerë dhe përfundimtar.
- U shpall sot me 10.08.2020 ne Tirane.

GJYQTAR
BARI SHYTI

GJYQTARE
ENKELEJDA METALIAI (SOFTA)

GJYQTARE
ALKELINA GAZIDEDJA

VËRTETOHET NJËSIA
ME ORIGINALIN

